

**PROJEKT
FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT MULTIETNIK NË KOMUNA**

RAPORT
nga hulumtimi
i gjendjes fillestare



**QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR**

**PROJEKT
FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT MULTIETNIK NË KOMUNA**

RAPORT
nga hulumtimi
i gjendjes fillestare

Shkup, dhjetor 2011



**QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR**

**Hulumtimin e realizoi
Qendra Maqedonase
për Edukim Qytetar**

Falënderim për të gjithë bashkëpunëtorët e përfshirë në procesin e realizimit të këtij studimi, veçmas nxënësit, prindërit, arsimtarët dhe drejtorët e shkollave fillore që ishin zgjedhur si ekzemplar, të cilët u përgjigjën në testet dhe pyetësorët e dhënë, që u realizuan si pjesë e këtij hulumtimi.

Mbështetje profesionale nga:



Mbështetje financiare nga:

Pestalozzi Children's Foundation
Education and intercultural competence - worldwide



Autorë:

Mr. Gorica Mickovska
Anica Aleksova
Mr. Ana Mickovska Raleva

Redaktorë profesionalë:

Mr. Vesna Horvatović
Mr. Mitko Çeshlarov

Konsultues gjatë hartimit dhe kontrollimit të testeve

Mr. Anita Angellovska

Hulumtimin në terren e realizuan:

Abdurraman Memedi
Julija Gligorova Trajanova
Olgica Naumoska
Rajmonda Neziri
Zoran Uzunov

Përpunimi i të dhënave:

d-r Beti Llameva

Përkthyes:

Zeqirija Ibrahim

Përgatitja grafike:

Biljana Mihajlovska

Qëndrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk është e patjetërsueshme të përkohjë me mendimet dhe politikën e fondacionit Pestaloci, Byronë për zhvillimin e arsimit dhe QMEQ-në.

PËRMBAJTJA

REZYME PËRMBLEDHËSE	5
QËLLIMI I STUDIMIT	6
ZBATIMI I HULUMTIMIT	6
UDHËZIME THEMELORE NGA HULUMTIMI	7
1. Realizimi i përmbajtjeve për arsim multikulturor dhe multietnik	7
2. Komunikimi dhe integrimi ndëretnik në shkolla	8
3. Iniciativat e komunave që kanë të bëjnë me arsimin multietnik në shkolla	9
REKOMANDIME	10
I. ARSIMI MULTIETNIK	13
1. INFORMACIONET THEMELORE PËR PROJEKTIN	16
2. HULUMTIMET PËR ARSIMIN MULTIETNIK	17
3. KORNIZA KONCEPTUALE E HULUMTIMIT	19
4. METODAT DHE INSTRUMENTET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE	21
5. SHEMBULL	25
5.1. Shkollat	25
5.2. Nxënës dhe prindër	26
5.3. Arsimitarë	27
5.4. Drejtori dhe punëtorët profesionalë	27
5.5. Përfaqësuesit e komunave dhe organizatave joqeveritare	28
6. MBLEDHJA, PËRPUNIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE	29
II. REZULTATET	31
1. REALIZIMI I PËRMBAJTJEVE PËR ARSIM MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK	34
1.1. Aftësimi i arsimtarëve për realizimin e përmbajtjeve	34
1.1.1. Qëndrimet e arsimtarëve për arsimin multietnik dhe multikulturor	34
1.1.2. Përgatitja pedagogjike dhe metodike e arsimtarëve për arsim multietnik	36
1.1.2.1. Përgjigje për reagimet në situata të caktuara me ndjeshmëri etnike	37
1.1.2.2. Vetëvlerësimi i gatishmërisë për punë në mjedis multietnik dhe multikulturor	40
1.1.2.3. Vetëvlerësimi i gatishmërisë për shfrytëzimin e metodave interaktive	42
1.2. Të arriturat e nxënësve nga përmbajtjet mësimore relevante për arsimin multietnik	43
1.2.1. Të arriturat e nxënësve në test – klasa IV	43
1.2.1.1. Përgjigjet e nxënësve në detyra	46
1.2.1.2. Shembuj të detyrave dhe të arriturave të nxënësve	48
1.2.2. Të arriturat e nxënësve në test – klasa VIII	51
1.2.2.1. Përgjigjet e nxënësve për detyra	53
1.2.2.2. Shembuj të detyrave dhe të arriturave të nxënësve	54
1.2.3. Përmbajtjet që i kanë mësuar nxënësit	57
1.3. Mendime për suksesin e realizimit të arsimit multietnik dhe multikulturor	59

1.3.1. Sa mundëson realizimi i mësimit bashkëpunim ndëretnik dhe ndërkulturor	59
1.3.2. Trajnimi i kuadrit edukativo-arsimor për realizimin e arsimit multi-etnik dhe multikulturor	61
2. KOMUNIKIMI DHE INTEGRIMI MULTIETNIK NË SHKOLLA	64
2.1. Organizimi i punës në shkolla dhe mendimi për të	64
2.1.1. Arsimi multi-etnik në programet vjetore për punë në shkolla	64
2.1.2. Mendime për ndërrimet e ndara etnike në shkolla	66
2.1.3. Interesi për mësim në gjuhën e bashkësive të tjera etnike	69
2.2. Perceptimi i faktorëve që ndikojnë në komunikimin multi-etnik	71
2.2.1. Aktivitetet e përbashkëta të arsimtarëve dhe nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore	72
2.2.2. Mendime për mundësitë e krijimit të bashkëpunimit multi-etnik në shkollë	74
2.2.3. Perceptimi për tensionet etnike ndërmjet nxënësve	75
2.2.4. Mendimet e faktorëve që mund të kontribuojnë për marrëdhënie të mira ndëretnike	77
2.2.5. Distanca sociale	79
3. INICIATIVAT E KOMUNAVE QË KANË TË BËJNË ME ARSIMIN MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK NË SHKOLLA	83
3.1. Organizatat joqeveritare	83
3.1.1. Kapacitetet e organizatave	83
3.1.2. Fushat e ekspertizës	84
3.1.3. Inkuadrimi në projekte për bashkëpunim ndëretnik	85
3.1.4. Bashkëpunimi me shkollat dhe pushtetin lokal	85
3.1.5. Qëndrimet në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike midis nxënësve në komunë	86
3.1.6. Qëndrimet ndaj bashkësive të tjera etnike	87
3.2. Pushteti lokal – sektori i arsimit	87
3.2.1. Inkuadrimi në projekte për bashkëpunim ndëretnik	88
3.2.2. Bashkëpunimi me shkollat dhe organizatat joqeveritare në komunë	88
3.2.3. Qëndrimet për gjendjet ndëretnike në komunë	89
3.2.4. Qëndrimet për bashkësitë e tjera etnike	90
III. KONSTATIME DHE REKOMANDIME	91
KONSTATIMET	94
1. Realizimi i përmbajtjeve për arsim multi-etnik dhe multikulturor	94
2. Komunikimi dhe integrimi multi-etnik në shkolla	96
3. Iniciativat e komunave që kanë të bëjnë me arsimin multi-etnik në shkolla	97
REKOMANDIME	98
LITERATURA	101
SHTOJCA	104

REZYME PËRMBLEDHËSE

QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i këtij studimi është që të sigurohen informacione fillestare për bashkëpunimin multietnik në dy shkolla fillore në të cilat mësimi realizohet në më shumë se një gjuhë mësimore, në tre komuna multietnike, dhe kështu të përkufizohen rekomandimet para fillimit të pilot-aktiviteteve në kuadër të projektit *Fuqizimi i bashkëpunimit multietnik në komuna*.

Hulumtimi para së gjithash është i orientuar drejt dhënies së përgjigjeve për këto çështje:

- ◆ Cili është niveli i realizimit të përmbajtjeve të arsimit multikulturor dhe multietnik?
- ◆ Cila është gjendja me bashkëpunimin dhe integrimin multietnik në shkolla?
- ◆ A ka dhe cilat janë nismat në komuna që kanë të bëjnë me arsimin multietnik në shkolla dhe çfarë janë ato iniciativa?

ZBATIMI I HULUMTIMIT

Të dhënat janë mbledhur në ekzemplarët e gjashtë shkollave fillore, nga dy në Shkup (komuna Butel), si dhe në Tetovë e Strumicë. Shkollat janë me nxënës të përzier në baza etnike dhe aty mësimi realizohet në më shumë se një gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip dhe turqisht). Në secilën shkollë janë anketuar drejtorët e shkollave dhe përfaqësuesit e shërbimit profesional, arsimtarët e mësimi klasor që mbajnë mësim në klasën IV, kujdestarët e klasave të klasave VIII, arsimtarët që e mbajnë lëndën Arsimi qytetar, nga 40¹ nxënës të klasës IV dhe të klasës VIII në secilën gjuhë mësimore, si dhe nga një prind/tutor i secilit prej nxënësve të marrë si ekzemplar. Numri i përgjithshëm i të anketuarve në shkolla ishte: 15 drejtorë të shkollave dhe përfaqësues të shërbimit profesional, 64 arsimtarë, 749 nxënës dhe 693 prindër/tutorë.

Po ashtu të dhëna janë mbledhur edhe nga përfaqësuesit e pushtetit lokal (persona përgjegjës për arsimin në komunë), si dhe nga përfaqësuesit e organizatave joqeveritare në komunën përkatëse. Numri i përgjithshëm i të anketuarve ishte: 5 përfaqësues të komunave dhe 7 përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Hulumtimi në terren është realizuar nga këshilltarët e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit në Shkup dhe Tetovë, si dhe nga inspektori i arsimit në Strumicë.

¹ Në shkollat ku numri i nxënësve ishte më i vogël se numri i paraparë me ekzemplarë, të dhënat ishin mbledhur nga të gjithë nxënësit e klasave përkatëse.

UDHËZIME THEMELORE NGA HULUMTIMI

Gjatë shqyrtimit të udhëzimeve që kanë të bëjnë me qëndrimet dhe mendimet e arsimtarëve, duhet të kihet parasysh prirja e të anketuarve për të dalë në dritë sa më të mirë që vërehet në të gjitha hulumtimet e deritanishme që kanë të bëjnë me praktikën mësimore.

1. REALIZIMI I PËRMBAJTJEVE PËR ARSIM MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK

Tiparet e kuadrit edukativo-arsimor dhe qëndrimet e tyre:

- ◇ Shkalla e pranimit të dallimeve në arsim dhe qëndrimi i arsimtarëve ndaj punës në mjedise multietnike **nuk mund** të vlerësohen si bazë e mirë për arsim multietnik.
- ◇ Marrë në përgjithësi, shumica e arsimtarëve vlerësojnë se **janë pjesërisht të aftë** për shfrytëzimin e më shumë metodave që janë adekuate për arsimin multietnik (këtë e dëshmojnë edhe rezultatet e testit në të cilin duhej të zgjidheshin procedurat përkatëse në situata të ndjeshme etnike, në të cilat arsimtarët nuk kanë qenë shumë të suksesshëm).
- ◇ Shumica e arsimtarëve **gjatë studimeve** nuk janë përgatitur ose janë përgatitur vetëm pjesërisht për të punuar në mjedise të përziera etnike. Po ashtu shumica e arsimtarëve **nuk kanë ndjekur trajnime plotësuese në projekte** për bashkëpunim ndëretnik dhe nuk ndjehen sa duhet të përgatitur për të realizuar përmbajtje për bashkëpunim ndëretnik. Diçka më shumë se gjysma e arsimtarëve **janë të interesuar** për trajnime dhe punë në projekte për bashkëpunim ndëretnik.
- ◇ Shikuar nga aspekti i efekteve ndaj nxënësve në shkollat e tyre, pritjet e arsimtarëve **janë mjaft optimiste**: shumica e tyre konsiderojnë se nxënësit e tyre do të jenë tolerantë, të përgatitur për të zgjidhur konflikte etike dhe qytetarë lojalë të shtetit (këto vlerësime në masë të madhe kanë të bëjnë me nxënësit e gjuhës mësimore ku ata mbajnë mësim, ndërsa më pak me nxënësit që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore).
- ◇ Drejtorët dhe punëtorët profesionale të shkollave të përfshira në projekt **kanë ndjekur trajnime dhe kanë përvojë në projekte** për zhvillimin e bashkëpunimit multietnik, ndërsa janë të interesuar që edhe në të ardhmen të punojnë në projekte të tilla.

Të arriturat dhe qëndrimet e nxënësve

- ◇ Nxënësit kanë qenë **mesatarisht të suksesshëm** në zgjedhjen e përgjigjeve adekuate gjatë zgjidhjes së detyrave në testet që kishin të bëjnë me përmbajtje që i kanë mësuar (për shembull: njohja e të tjerëve, zgjidhja e konflikteve, toleranca, të drejtat e fëmijëve, stereotipat, paragjykimet etj.)

- ◆ Shumica e nxënësve e kanë zgjedhur si të drejtë qasjen autoritare në përmirësimin e tolerancës ndëretnike.
- ◆ Ekzistojnë **dallime relevante statistikore** në suksesin e nxënësve në teste sipas gjuhës mësimore në të cilën ata mësojnë.
- ◆ Në përgjithësi, nxënësit tregohen **të hapur për idenë e shkollave multietnike dhe për aktivitete të përbashkëta** ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike.

2. KOMUNIKIMI DHE INTEGRIMI NDËRETNIK NË SHKOLLA

Planifikimi dhe organizimi i punës dhe opinionet për të

- ◆ Në të gjitha shkollat **janë planifikuar** qëllime dhe/ose aktivitete për arsim multietnik, por zakonisht kjo nuk është **e qëndrueshme** dhe nuk i përfshin të gjitha mundësitë për këtë. Në shkolla ekzistojnë **modele të ndryshme të organizimit të mëimit** sipas gjuhëve mësimore (gjendja e tillë është bazë e mirë për zbatimin e qasjeve të ndryshme për arsimin multietnik).
- ◆ **Shumica e nxënësve dëshirojnë** të mësojnë në ndërrim të njëjtë me fëmijë të përkatësisë tjetër etnike dhe dëshirojnë të mësojnë në gjuhën e bashkësive të tjera etnike.
- ◆ **Arsimtarët janë të ndarë** në raport me mbështetjen e të a.q. ndërrimeve etnike, ndërsa shumica e **drejtorëve dhe punëtorëve profesionalë nuk i përkrahin** organizimet në ndërrime të pastra etnike.
- ◆ **Shumica e prindërve e përkrahin** organizimin e mëimit në ndërrime të pastra etnike, por do t'i këshillonin fëmijët e tyre ta mësojnë gjuhën e bashkësisë tjetër etnike.

Aktivitete të përbashkëta të arsimtarëve dhe nxënësve

- ◆ **Mbledhjet dhe trajnimet formale** në shkollat e zgjedhura në projekt rregullisht zhvillohen bashkë, madje shpesh bashkërisht zhvillohen edhe aktivitetet jashtëshkollore dhe jashtëmësimore (sportive, kulturore-artistike dhe ekskursionet), por **aktivitetet mësimore dhe puna në seksione rrallë** organizohet bashkërisht.
- ◆ Shumica e prindërve **nuk e dinë** se në shkollën e tyre ka pasur ngjarje që kanë pasur për qëllim bashkëpunimin ndërmjet nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike.

Marrëdhëniet dhe tensionet ndëretnike në shkolla

- ◆ Sipas njohurive të shumicës së prindërve, fëmijët e tyre kanë **shokë të bashkësive të tjera etnike** në shkollë dhe jashtë saj.

- ◇ Kur e zgjedhin një shok, **për nxënësit më e rëndësishme është që ai të jetë i mirë me ata**, por është i madh edhe numri i nxënësve (30% maqedonas dhe 40% te shqiptarët) të cilët e kanë më të rëndësishme që shoku i tyre të jetë i njëjtë me të për nga feja dhe nacionaliteti.
- ◇ **Distanca sociale e kuadrit mësimor** ndaj pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike **është mjaft e madhe**. Ata pranojnë të jetojnë me pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike dhe eventualisht të shoqërohen në kohën e lirë, por jo edhe ata të jenë shokët më të mirë ose bashkëshort/bashkëshorte të anëtarëve më të afërt të familjes.
- ◇ Numri më i madh i **prindërve kanë miq** të bashkësive të tjera etnike, por në familje nuk kanë martesë të përziera, veçmas te maqedonasit.
- ◇ Tensione të dukshme ndërmjet nxënësve në bazë etnike vërejnë relativisht pak arsimtarë dhe prindër, por **tensione të mbuluara vërejnë rreth gjysma e arsimtarëve dhe rreth 20% e prindërve**. Shumica e nxënësve konsiderojnë se fëmijët e bashkësive të tjera etnike kanë sjellje miqësore, por secili i dhjeti ndjen se ata kanë sjellje armiqësore.
- ◇ Arsimtarët, drejtorët dhe punëtorët profesionalë konsiderojnë se **për zvogëlimin e tensioneve** mund të kontribuojnë më shumë aktivitetet e përbashkëta, por edhe inkuadrimi më i madh i prindërve në aktivitete dhe i nxënësve në planifikimin e tyre.
- ◇ Sipas mendimit të shumë arsimtarëve, drejtorëve dhe punëtorëve profesionalë **për marrëdhënie të mira ndëretnike më së shumti ndikojnë shkolla, prindërit, familja dhe mediat**, ndërsa më pak librat, komuna, partitë politike dhe sektori joqeveritar.

3. INICIATIVAT E KOMUNAVE QË KANË TË BËJNË ME ARSIMIN MULTIETNIK NË SHKOLLA

- ◇ Përfaqësuesit e sektorit joqeveritar dhe të pushtetit lokal konsiderojnë se nxënësit e përkatësive të ndryshme etnike, që mësojnë në gjuhë të ndryshme, **njihën pak mes vete**.
- ◇ Organizatat joqeveritare dhe pushteti lokal shihen si **faktorë të rëndësishëm në përmirësimin e tolerancës ndëretnike**. Megjithatë një pjesë e madhe e komunave nuk kanë vendosur bashkëpunim të suksesshëm me organizatat joqeveritare. Pjesa më e madhe e aktiviteteve për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik ndërmjet nxënësve kanë të bëjnë me aktivitete jashtë shkollës.
- ◇ Një pjesë e madhe e përfaqësuesve të komunave dhe të organizatave joqeveritare shfaqin **një shkallë të caktuar të refuzimit** (distanca sociale) ndaj bashkësive etnike që janë të ndryshme nga ata.
- ◇ Ekziston një përshtypje e përgjithshme se **bashkëpunimi** (aty ku është i pranishëm) ndërmjet organizatave joqeveritare, komunave dhe shkollave

në të shumtën e rasteve është formal dhe nuk përfshin elemente të përkufizimit të përbashkët të përparësive dhe aktiviteteve, si dhe vendimmarrje të përbashkët. Si iniciatorë të bashkëpunimit më shpesh paraqiten organizatat joqeveritare.

REKOMANDIME

- ◆ Gjatë planifikimit të aktiviteteve të projektit, duhet të shfrytëzohen përvojat që janë arritur në aktivitetet mutietnike dhe modelet e ndryshme të organizimit që i kanë shkollat e përfshira në projekt.
- ◆ Në projekt duhet të shfrytëzohet e dhëna se nxënësit janë shumë më të ngarkuar (kjo krahasuar me arsimtarët dhe prindërit) se nxënësve që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore, kjo duke iu referuar motos “krijimi i shkollave mike për nxënës”.
- ◆ Ngjashmëria e qëndrimeve, dituritë pedagogjike dhe trajnimi i arsimtarëve që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme mësimore dhe në qytete të ndryshme mund të shfrytëzohet për planifikimin e trajnimeve të përbashkëta. Gjatë kësaj, duhet të kihet parasysh përgjigje e arsimtarëve për metodat për të cilat njehen më pak të aftë, veçmas duhet të shfrytëzohen dhe të diskutohen situatat reale dhe mënyrat adekuate të reagimit të arsimtarëve në situata të ndjeshme etnike.
- ◆ Nevojitet ndryshim i mënyrës së realizimit të përmbajtjeve në mësimin e rregullt (sipas përgjigjeve të nxënësve për përmbajtjet që i kanë mësuar deri në fund të klasës së tretë, respektivisht të tetë, madje edhe sipas të arriturave të një pjese të detyrave në teste). Inkuadrimi i nxënësve në aktivitetet e vetë orëve (debate, diskutime, mini-projekte) do të ndihmojë në përvetësimin e diturive më afatgjata për nocionet dhe konceptet e mësuara, si dhe për dallimin dhe zbatimin e tyre.
- ◆ Shkollat duhet të kujdesen më shumë për informimin dhe inkuadrimin më të madh të prindërve në aktivitete që i planifikon dhe realizon shkolla. Në projekt duhet të mendohen dhe realizohen aktivitete specifike për prindërit.
- ◆ Një pjesë e faktorëve që mund të shfrytëzohen në arsimin multietnik, siç janë shfrytëzimi kritik i librave shkollorë, angazhimi më i madh i organizatave joqeveritare dhe komunave, nuk janë të njohura për shkollat. Ato duhet të inkurajohen dhe aftësohen që të sigurojnë veprim sinergik, e jo të mbështeten vetëm në fuqitë e tyre.
- ◆ Në projekt duhet të shfrytëzohet fakti se organizatat joqeveritare kanë kapacitete solide për menaxhimin e projekteve, shumica e tyre kanë përvojë në punën me aktivitete për bashkëpunim/tolerancë ndëretnik/e, ndërsa një pjesë e tyre kanë edhe përvojë përkatëse në fushat konkrete që kanë të bëjnë me qëllimet e projektit.

- ◆ Komunitat dhe organizatat joqeveritare janë të interesuara për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik ndërmjet nxënësve. Meqë konsiderojnë se kanë më shumë ndikim dhe liri të veprimit jashtë shkollave, ato propozojnë edhe aktivitete konkrete jashtë shkollës. Këto propozime duhet të shfrytëzohen si bazë e mirë dhe realizimi i tyre duhet të ndihmohet.
- ◆ Gatishmëria e organizatave të anketuara për të punuar me organizata me përbërje dominuese të përzier etnike në organizimin e tyre, do të ndihmonte të merren si bazë e mirë për inkuadrimit dhe rrjetëzimin e organizatave të ndryshme qytetare në aktivitetet e projektit.

Pjesa I

**ARSIMI
MULTIETNIK**

ARSIMI MULTIETNIK

Në këtë pjesë janë paraqitur informacionet themelore për projektin *Fuqizimi i bashkëpunimit multi-etnik në komuna*, qasjet e hulumtimit që kanë të bëjnë me arsimin multi-etnik, në përgjithësi, dhe në Republikën e Maqedonisë, në veçanti, si dhe korniza konceptuale për këtë hulumtim. Këtu janë përshkruar metodat dhe instrumentet për mbledhjen e të dhënave, është dhënë një përshkrim i popullatës dhe ekzemplarit të të intervistuarve, duke përfshirë edhe zgjedhjen e ekzemplarit, si dhe mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave të mbledhura.

1. INFORMACIONET THEMELORE PËR PROJEKTIN

Në shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë, në mjediset multietnike, mësimi i rregullt zhvillohet në gjuhën amtare të nxënësve (maqedonase, shqipe, turke, serbe), ndërsa pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike (romë, vllahë, boshnjakë) kanë mundësi të zgjedhin që në mënyrë fakultative ta mësojnë gjuhën e tyre amtare. Zakonisht edhe aktivitetet më të shpeshta jashtëmësimore të nxënësve realizohen në këtë mënyrë, veçmas në shkollat ku mësimi organizohet në ndërrime “të pastra” etnike. Kjo i kufizon mundësitë për promovimin e multikulturalizmit dhe integritet ndëretnik, si dhe inkuadrimin e nxënësve dhe të arsimtarëve në aktivitete të përbashkëta, me çka do të përmirësohej komunikimi ndëretnik, por do të bëhej edhe promovimi dhe sigurimi i respektit të ndërsjellë, i tolerancës, pranimit dhe bashkëpunimit më të madh.

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (MCGO – QMEQ), përmes Fondacionit të Fëmijëve “Pestaloci” filloi me realizimin e **projektit** për *Fuqizimin e bashkëpunimit multi-etnik në komuna*. Qëllimi kryesor i këtij projekti është që, me mbështetje të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, në komunat ku jetojnë pjesëtarët e grupeve të ndryshme etnike, të planifikohen dhe realizohen aktivitete në shkollat e zgjedhura multietnike, të cilat do të kontribuojnë për fuqizimin e tolerancës dhe bashkëpunimit ndëretnik dhe ndërkulturore, madje këto aktivitete do të ndihmojnë edhe për zhvillimin e komunave multietnike në Maqedoni.

Projekti *Fuqizimi i bashkëpunimit multi-etnik në komuna* do të realizohet në periudhën 2011-2014. Aktivitetet e projektit janë të orientuara drejt fuqizimit të kapaciteteve të komunave për mbështetjen e realizimit të aktiviteteve multietnike në shkolla. Rezultatet e pritura nga realizimi i projektit janë:

- ◆ Dituri më të mëdha të nxënësve për përmbajtjet që mund të kontribuojnë në mirëkuptimin ndëretnik;
- ◆ Dituri dhe shkathtësi më të mëdha të arsimtarëve dhe të punësuarve të tjerë në shkolla, të cilat janë të orientuara drejt rritjes dhe mbështetjes së mirëkuptimit ndëretnik në bashkësi;
- ◆ Përgatitja e aktiviteteve që janë model për nxënësit e shkollave nga grupi qëllimor;
- ◆ Vendosja e bashkëpunimit ndërmjet shkollave, pushtetit lokal dhe organizatave joqeveritare për mbështetjen e shoqërisë multietnike;
- ◆ Inkuadrimi i aktiviteteve për bashkëpunim multi-etnik në programet vjetore të punës së shkollave.

Para fillimit të aktiviteteve me komunat/shkollat e përfshira në projekt, në periudhën qershor 2011 – mars 2012 është zbatuar **hulumtimi i gjendjes fillestare** në tre komunat e para që janë përfshirë në fazën e parë të projektit. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të sigurohen informacione bazë për bashkëpunimin multi-etnik në dy prej shkollave fillore me mësim në më shumë gjuhë mësimore në tre komuna multietnike, si dhe të përkufizohen rekomandimet që do të ndihmojnë në përkufizimin e aktiviteteve të projektit.

2. HULUMTIMET PËR ARSIMIN MULTIETNIK

Arsimi multietnik, në kontekste të zgjeruara më të gjera të marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni, viteve të fundit është studiuar mjaft (Petrovska-Beshka V., Najçevska M., Kening N., Ballazhi S., Tomovska A., 2009, Kërzhallvski A., 2012, Klekovski S., 2011, Connor G. A. 2010, Maleska M., 2012, Nijboer, Y.L., 2011, OSCE). Studimet rëndom janë orientuar drejt analizës së bazës së sistemit (rregullimi ligjor, programet, librat), si dhe hulumtimeve të qëndrimeve të nxënësve. Në shumicën e studimeve është konstatuar se rregullimi ligjor dhe dokumentet konceptuale për arsimin, marrë në përgjithësi, janë një kornizë e mirë për arsimin multikulturor dhe multietnik. Këtu do të përmenden vetëm ato qasje që i kemi konsideruar më relevante për hulumtimin dhe planifikimin e aktiviteteve të projektit.

Arsimtarët individualisht, sipas hulumtimeve të OSBE-së (2010), janë faktori më i rëndësishëm shkollor, i cili ndikon në qëndrimet etnike të nxënësve. Sipas këtij hulumtimi, ndikimi i arsimtarëve shpjegon rreth 40% të qëndrimeve të nxënësve (sipas Yvette Leonie Nijboer (2011, fq. 9). Qëndrimet e të anketuarve ndaj pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike, në shumicën e hulumtimeve dëshmojnë për nivel të pamjaftueshëm të njohjes së ndërsjellë, komunikim të kufizuar ndërmjet vete, ekzistim të paragjyqimeve për të tjerët dhe ndjenjë të diskriminimit në bazë etnike (Kërzhallovski, 2012). Shumica e studimeve përmbajnë rekomandime për tejkalimin e gjendjeve që janë vlerësuar si pakënaqshme, të cilat zhvillohen në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të nivelit të sistemit deri në rekomandimet konkrete për aktivitetet në shkolla.

Në periudhën e kaluar janë hartuar më shumë strategji që kanë të bëjnë me arsimin e integruar etnik (National Strategy of the Republic of Macedonia for the Alliance of Civilizations – Strategjia për arsimin e integruar). Aty është nisur nga nevoja për fuqizimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe nga nevoja e kohezionit shoqëror në Republikën e Maqedonisë).

Duke u prirë nga ky përcaktim, dhjetë viteve të fundit janë realizuar edhe shumë aktivitete me të rinjtë, që po ashtu kanë për qëllim ta zhvillojnë shoqërinë qytetare, t'i respektojnë të drejtat e njeriut, t'i tejkalojnë paragjykimet, ta zvogëlojnë përjashtimin, ta rrisin mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, ta ndihmojnë zgjidhjen e konflikteve pa dhunë etj., duke pritur se kjo do të kontribuojë për integrim më të madh në shoqëri të të gjitha grupeve etnike dhe bashkësive kulturore në Maqedoni. Thuaja të gjitha projektet janë realizuar nga organizatat joqeveritare, kanë pasur miratimin dhe/ose mbështetjen e pushteteve qendrore ose lokale, ndërsa janë realizuar me mjete të donatorëve. Shumica e projekteve bëjnë vetevaluimin e rezultateve, ndërsa ndonjëherë edhe të efekteve, por nuk ekziston evaluim sistematik nga ana e shtetit, i cili do të mund të shërbejë për të ndërmarrë aktivitete që janë të bazuara në rezultate (Anger J, Von't Rood R.A., Gestakovska Z.. Duke i pasur parasysh gjendjet në shoqëri në aspekt të jetës multietnike dhe multikulturore, mund të përfundohet se, edhe përkundër suksesit të projekteve derisa ato zhvillohen, nuk janë krijuar mekanizma për qëndrueshmërinë e tyre, ndërsa efektet më të gjera të të gjitha aktiviteteve të ndërmarra janë të vogla dhe çështja e integritimit në arsim është aktuale dhe e hapur për të kërkuar modele efektive.

Qasjet psikologjike dhe pedagogjike në arsimin që synon drejt mirëkuptimit të ndërsjellë të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike dhe kulturore, si dhe zhvillimi i shoqërive më tolerante dhe më mirë të integruara, nisen nga “kontakt-hipoteza” e Ollport-it (Allport, 1954) se kontaktet sociale i zvogëlojnë paragjykimet etnike, që u bë e vërtetë thuaja e pranuar gjerësisht. Ajo është hipoteza më e hulumtuar dhe hipoteza më e konfirmuar në hulumtime. Por, hulumtimet nuk janë të njëtrajtshme. Hulumtimet më të reja janë në drejtim të gjetjes së kushteve në të cilat kontaktet janë mënyrë efektive për tejkalimin paragjykimëve dhe për integrim social. (Dixon, 2010, fq. 402). Ndodhë edhe Ollport-i i kishte parasysh kushtet në të cilat zhvillohet integrimi, megjithatë Bradok-u (Braddock, 1980) si kushte të volitshme për kontakt të suksesshëm i ka theksuar këto: 1. statusin e barabartë ndërmjet personave që janë në kontakt; 2. këmbimin e qëllimit të përbashkët; 3. interaksionin që paraqet bashkëpunim dhe 4. mbështetjen nga mjedisi.

Kontakt-hipoteza i ka edhe kritikët e saj. Për shembull, Pauers-i dhe Elison-i (Powers D, C. Ellison, 1995) thonë se natyra e kontaktit në fakt është e kushtëzuar nga pikëpamja dominuese paraprake. Në këtë mënyrë, ata që janë më tolerantë, janë më të hapur edhe për bashkëpunim, hyjnë në kontakte më të shpeshta dhe më produktive. Ata e kanë quajtur atë “fenomen të selektivitetit” (1995, fq. 206).

Xhekman-i dhe Krein-i (Jackman M, M. Crane, 1986) e konsiderojnë teorinë e kontaktit për shumë neutrale në aspekt politik dhe shumë optimiste. Ata mendojnë se mostoleranca etnike dhe racore para së gjithash është konstruktiv politik, ndërsa shumë më pak ato janë tipare të individit. Ata konsiderojnë se politikanët shpesh dëshirojnë t'i ruajnë “privilegjet racore” (1986, fq. 484).

Në hulumtimet e realizuara për arsimin multikulturor Banks-i (Banks, J.A. & Banks, C.A.M. (Eds). (1993) *Multicultural education: Issues and perspectives* (2nd ed.) Boston: Allyn and Bacon and Banks, J.A. (1994) sipas Pei Jian Zhou, 2002, fq. 2 i ka përcaktuar këto dimensione që mund të ndihmojnë në realizimin dhe vlerësimin e arsimit multietnik: 1) interaksioni përmes përmbajtjeve mësimore, 2) përvetësimi i diturive, 3) zvogëlimi i paragjykimëve, 4) qasja pedagogjike çka është e drejtë dhe 5) përmirësimi i klimës shkollore. Ai konsideron se arsimit multietnik kërkon ndryshimin e gjithë shkollës, duke përfshirë edhe politikën shkollore, mësimin, materialet për mësim dhe materialet e tjera, aktivitetet jashtëmësimore, përmbajtjet dhe marrëdhëniet zyrtare dhe jozyrtare, shpërblimin, udhëheqjen, këshillimin dhe rregullat e sjelljes në shkollë.

Arsimi multietnik, sipas tij, është proces, ai është mënyrë e të menduarit, mënyrës e marrjes së vendimeve dhe mënyrë e vazhdueshme e sjelljes në mjedisin arsimor. Të ngjashme janë edhe bazat mbi të cilat zhvillohet Strategjia për arsim të integruar në Republikën e Maqedonisë MASH, 2005) o.

3. KORNIZA KONCEPTUALE E HULUMTIMIT

Duke i pasur parasysh njohuritë teorike, hulumtimet ne vende të tjera dhe në Maqedoni, si dhe faktin se organizimi i punës në shkollë në ndërrime sipas gjuhës mësimore e kufizon mundësinë e kuadrit, nxënësve dhe prindërve të bashkësive të ndryshme etnike për kontakte të ndërsjella në hulumtimin e gjendjes fillestare, projekti *Fuqizimi i bashkëpunimit multietnik në komuna* theks të veçantë i ka kushtuar përcaktimit të këtyre pikave:

- a) **Realizimi i përmbajtjeve për arsim multikulturor dhe multietnik** (që para së gjithash janë në lëndët mësimore Njohja e mjedisit, Arsimi qytetar dhe Shkathtësitë jetësore), me ç'rast hulumtohen:
- ◇ Dituritë e këtyre përmbajtjeve të nxënësve të klasës së tretë dhe të tetë (këto janë klasat në të cilat këto përmbajtje janë më shumë të përfaqësuara);
 - ◇ Realizimi i përmbajtjeve që kanë të bëjnë me arsimin multietnik;
 - ◇ Sa janë të përgatitur arsimtarët që t'i pranojnë dallimet, që të reagojnë në situata të ndryshme etnike, sa janë të gatshëm të realizojnë përmbajtje nga fusha e arsimit multietnik dhe multikulturor, si dhe të përdorin metoda përkatëse për realizimin e tij.
 - ◇ Cila është praktika dhe mendimet e arsimtarëve dhe drejtorëve në lidhje me arsimin multietnik dhe multikulturor.
- b) **Komunikimi multietnik dhe integrimi në shkollë**, me ç'rast hulumtohet:
- ◇ Mendimi i arsimtarëve, drejtorëve dhe punëtorëve profesionalë për ndikimin e faktorëve të ndryshëm ndaj marrëdhënieve ndëretnike, si dhe përgatitja e tyre profesionale për pranimin e pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike;
 - ◇ Perceptimi i nxënësve për marrëdhëniet ndërmjet nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, për shoqërimin me nxënës të nacionalitetit tjetër, për gatishmërinë e tyre që ta mësojnë gjuhën e të tjerëve dhe për pranimin e pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike.
 - ◇ Mendimet e prindërve për arsimin multietnik në shkollë dhe për shoqërimin e fëmijës së tyre me fëmijë të përkatësisë së ndryshme etnike, si dhe për pranimin e pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike.

c) **Iniciativat në komuna që kanë të bëjnë me arsimin multietnik në shkolla, me ç'rast hulumtohet:**

- ◆ Perceptimi i komunikimit ndëretnik në shkolla nga ana e përfaqësuesve të komunave dhe organizatave joqeveritare;
- ◆ Iniciativat dhe përfshirja e komunave dhe organizatave joqeveritare me arsim multietnik në shkolla, gatishmëria e tyre personale që të punojnë në aktivitete të tilla dhe pranimi i tyre për pjesëtarët e bashkësive të ndryshme etnike.
- ◆ Perceptimi i bashkëpunimit të ndërsjellë të organizatave joqeveritare dhe komunave për çështje që kanë të bëjnë me arsimin multietnik.

4. METODAT DHE INSTRUMENTET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Në pajtim me kornizën konceptuale, në këtë hulumtim janë shfrytëzuar burime dhe metoda për mbledhjen e të dhënave në gjashtë nivele, si: arsimtarë, nxënës, drejtorë dhe përfaqësues të shërbimeve profesionale, prindër, përgjegjës të arsimit në komuna dhe organizata joqeveritare. Enkas për nevojat e këtij hulumtimi janë përgatitur: shkallë të qëndrimeve, test-detyra, situata mësimore, pyetësorë, përkujtues për intervistë, shkallë të distancës sociale dhe tabela me të dhëna për shkollën. Po ashtu janë marrë në konsideratë edhe programet vjetor për punën e 6 shkollave të përfshira në hulumtim.

Të dhënat e mbledhura janë sasiore dhe cilësore.

◆ Hulumtimi me arsimtarë

Nga arsimtarët janë mbledhur të dhëna për marrëdhëniet ndëretnik në shkolla dhe mendimet e tyre për praktikën e realizimit të aktiviteteve të integruara etnike; pranimi i dallimeve, përgatitja për punë në mjedis multikulturor; aftësia e arsimtarëve për sjellje të drejtë në situata të ndjeshme ndëretnike, shkalla e distancës sociale dhe të dhëna për arsimin, moshën dhe lëndët mësimore që i mban arsimtari. Shkallët, testi (situatat mësimore) dhe pyetësorët (në aspekt teknik) ishin vendosur në një instrument – *Pyetësori për arsimtarë* – koha e nevojshme për t'u përgjigjur në të pyetësor ishte rreth 20 minuta.

◆ Hulumtimi me nxënës

Me testet të përgatitura enkas dhe me realizimin e tyre në fillim të klasës së katërt dhe në fund të klasës së tetë, ishin mbledhur të dhëna për: njohjen dhe kuptimin e pyetjeve që kishin të bëjnë me përmbajtjet e mësuara; qëndrimet dhe sjelljet e nxënësve në situata të multietnicitetit dhe multikulturës; njohja dhe pranimi i dallimeve; shkalla e distancës sociale dhe pyetje që kanë të bëjnë me përkatësinë sociale dhe nacionale të nxënësit. Test-detyrat, pyetësorët dhe shkallët ishin vendosur në *Pyetësorin për nxënësin e klasës IV*, respektivisht në *Pyetësorin për nxënësit e klasës VIII*, ndërsa koha e nevojshme për t'u përgjigjur në të ishte rreth 40 minuta.

◆ Hulumtimi me drejtorë dhe përfaqësues të shërbimit profesional

Të dhënat për gjendjet në mësim, që kanë të bëjnë me bashkëpunimin multietnik në shkollë dhe në bashkësinë më të gjerë, informacionet për përvojën në projekte dhe trajnime multietnike, si dhe interesi për to, por edhe të dhënat demografike për të anketuarit ishin mbledhur në *Pyetësorin për drejtor/shërbim profesional*. Koha e nevojshme për t'u përgjigjur në këtë pyetësor ishte rreth 20 minuta. Me një formular të veçantë ishin mbledhur të dhënat për shkollat: për madhësinë e shkollës dhe strukturën arsimore të prindërve.

◆ Hulumtimi me prindër

Me *Pyetësozin për prindër* ishin mbledhur të dhëna për arsimin multietnik në shkollën në të cilën mëson fëmija i tyre, për shoqërimin e fëmijës së tyre me fëmijë të përkatësisë së ndryshme etnike, si dhe për nivelin e pranimin të prindërve për fëmijët e përkatësive të ndryshme etnike. Ky pyetësor ishte shpërndarë te prindërit përmes nxënësve (fëmijëve të tyre) dhe për plotësimin e tij nevojiteshin 5-10 minuta.

◆ Hulumtimi me përfaqësues të organizatave joqeveritare

Përfaqësuesit e OJQ-ve ishin anketuar duke përdorë pyetësor gjysmë të strukturuar. Me këtë rast ishin mbledhur të dhëna për perceptimet e tyre të marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet nxënësve në komunat e tyre, për bashkëpunimin me pushtetin lokal dhe shkollat në komunë, si dhe për distancën sociale ndaj pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike. Po ashtu ishin mbledhur informacione edhe për kapacitetet e organizimit të tyre në punën me projekte që kanë të bëjnë me arsimin multietnik. Koha e nevojshme për t'u përgjigjur në këtë pyetësor ishte 15-20 minuta.

◆ Hulumtimi me përfaqësues të pushtetit lokal

Përmes anketës, duke përdorë pyetësor gjysmë të strukturuar, ishin mbledhur të dhëna nga përfaqësuesit e komunave që janë përgjegjës në sektorin e arsimit. Me këtë rast ishin mbledhur informacione për inkuadrimin e komunës në projekte për promovimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, si dhe për qëndrimet për praninë e tensioneve etnike ndërmjet nxënësve, për shkallën e bashkëpunimit me shkollën dhe organizatat joqeveritare në komunë, si dhe për qëndrimet e tyre ndaj bashkësive të tjera etnike. Koha e nevojshme për t'u përgjigjur në këtë pyetësor ishte 15-20 minuta.

Në tabelën 1 është dhënë përshkrimi i secilit instrument të përdorur në hulumtim.

Tabela 1: Përshkrimi i instrumenteve të përdorura në hulumtim

Instrumenti	Përshkrim i shkurtër
Pyetësi për arsimtarë	<p>Pyetësi për arsimtarë përbëhet nga 3 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Pjesën e parë e përbënin: (1) pyetjet që kishin të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike në shkollë dhe opinionet për praktikën e realizmit të aktiviteteve të integruara etnike, (2) 4 shkallë për pranimin e dallimeve (shkalla e qëndrimeve të tipit të Likertit), e cila i mat pranimet e dallimeve etnike dhe kulturore, duke dhënë 30 pohime, ndërsa për secilin prej tyre kërkonte të shënohet shkalla e pajtueshmërisë; (në përpunim ishin marrë parasysh 26 pohime – 4 pohime ranë për shkak të dallueshmërisë së ulët) dhe (3) pyetje për gatishmërinë për punë në mjedis multietnik dhe multikulturor. ◆ Pjesën e dytë e përbënin 5 vinjeta (situata mësimore) me të cilat hulumtoheshin tiparet e arsimtarëve për sjelljen përkatëse në situatën e ndjeshme ndëretnike. Njëra nga detyrat ishte ajo me klasterë me 5 pyetje. ◆ Pjesë e tretë të pyetjeve e përbënte shkalla e distancës sociale në të cilën janë vendosur 6 lloje të marrëdhënieve me maqedonas, shqiptarë, turq dhe romë. ◆ 7 pyetjet e fundit në instrument kishin të bëjnë me të dhëna për arsimin, moshën dhe lëndët mësimore që i ligjëron i anketuari.
Pyetësi për nxënës	<p>Pyetësi për nxënës të klasës IV përbëhet nga 4 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Pjesën e parë e përbënin 14 pyetje që kishin të bëjnë me dituritë dhe kuptimet e përmbajtjeve të mësuara në mësimin e rregullt (në përpunimin e të cilit përdorëshin 11 pyetje – 3 ranë për shkak të dallueshmërisë së ulët). ◆ Pjesën e dytë e përbënin 11 pyetje për dituritë dhe qëndrimet për veten, për familjen e tij dhe për mjedisin e afërt. ◆ Në pjesën e tretë ishin vendosur 7 pyetje që kishin të bëjnë me shkollën në të cilën mëson nxënësi. ◆ Pjesa e katërt është shkalla e distancës sociale në të cilën gjenden 6 lloje të ndryshme të marrëdhënieve me maqedonas, shqiptarë, turq dhe romë. <p>Pyetësi për nxënës të klasës VIII përbëhet nga 4 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Pjesën e parë e përbënin 33 pyetje që kishin të bëjnë me dituritë dhe kuptimet e përmbajtjeve të mësuara në mësimin e rregullt (në përpunim u përdorën 24 pyetje). ◆ Pjesën e dytë e përbënin 8 pyetje për dituritë dhe qëndrimet për veten, për familjen dhe për mjedisin e afërt. ◆ Në pjesën e tretë ishin vendosur 8 pyetje që kishin të bëjnë me shkollën në të cilën mëson nxënësi. ◆ Pjesa e katërt është shkalla e distancës sociale në të cilën gjenden 6 lloje të ndryshme të marrëdhënieve me maqedonas, shqiptarë, turq dhe romë.
Pyetësi për drejtorin dhe shërbimin profesional	<p>Ky instrument përbëhet nga 2 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Pjesa e parë përbëhet nga 15 pyetje që kishin të bëjnë me (1) organizimin e punës edukativo-arsimorë nga aspekti i mundësive për komunikim dhe integrim; (2) tensionet ndërmjet nxënësve në baza etnike dhe mënyrat e zvogëlimit të tyre; (3) trajnimet dhe projektet në të cilat shkolla ka qenë/është e përfshirë, ndërsa kanë të bëjnë me multietnicitetin dhe multikulturën. ◆ Në pjesën e dytë, përveç shkallës së distancës sociale, janë vendosur edhe 6 pyetje që kanë të bëjnë me të dhënat demografike për të anketuarin.
Pyetësi për prindër	<p>Pyetësi për prindër përbëhet nga 2 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Me 10 pyetjet e pjesës së parë u mblodhën të dhëna për (1) inkuadrimin prindërvë në aktivitete/marrje të vendimeve në shkollë; (2) qëndrimet dhe opinionet e tyre për ndërrimet në shkollë; (3) mësimin gjuhës së “të tjerëve”; (4) aktivitetet në shkollë, njoftimin dhe shoqërimin me fëmijët e përkatësive të tjera etnike; (5) tensionet ndërmjet nxënësve dhe mënyrat për tejkalimin e tyre. ◆ Në pjesën e dytë ishte vendosur shkalla e distancës sociale dhe tre pyetje demografike për të anketuarin.

Instrumenti	Përshkrim i shkurtër
Pyetësi për OJQ	<p>Të dhënat për organizatat joqeveritare ishin mbledhur përmes pyetësorit gjysmë të strukturuar (udhërrëfyes) për intervistë në 3 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Në pjesën e parë ishin mbledhur të dhëna për inkuadrimin e përfaqësuesve të organizatave në projekte për bashkëpunimin ndëretnik; më tej përmes pyetjeve të hapura hulumtoheshin qëndrimet e tyre në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet sektorit joqeveritar, shkollave dhe administratës së komunës dhe, në fund, hulumtoheshin qëndrimet për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në komunën e tyre. ◆ Në pjesën e dytë ishte vendosur shkalla e distancës sociale ◆ Në pjesën e tretë ishin mbledhur të dhëna për (1) kapacitetet e organizatës; (2) fushat e ekspertizës; (3) përvojën në fushat përkatëse dhe me grupet qëllimore që janë relevante për projektin. Në këtë pjesë ishin mbledhur edhe të dhëna për të anketuarin, gjegjësisht për funksionin e tij/saj në organizatë, si dhe informacione për përbërjen etnike dhe gjinore të organizatës.
Pyetësi për pushtetin lokal	<p>Pyetësi gjysmë i strukturuar (udhërrëfyesi) për intervistë na siguroi të dhëna nga përgjegjësit e arsimit, të cilat mund të grupohen në 3 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Në pjesën e parë, me 13 pyetje, u mblodhën informacione për (1) inkuadrimin e komunës në projekte për promovimin e bashkëpunimit ndëretnik; (2) shkollën e bashkëpunimit me shkollën dhe organizatat joqeveritare që janë aktive në komunë dhe (3) qëndrimet e përfaqësuesve për gjendjet ndëretnike ndërmjet nxënësve në komunë ◆ Në pjesën e dytë ishte vendosur shkalla e distancës sociale dhe ◆ Në pjesën e tretë ishin mbledhur të dhëna për të anketuarin dhe për përbërjen etnike dhe gjinore të administratës komunale.
Çek-lista për programet vjetore	<p>Programet vjetore të shkollave ishin analizuar në mënyrë kualitative në aspekt të përcaktimeve strategjike dhe aktiviteteve të planifikuara që janë të orientuara drejt fuqizimit të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkulturor në shkollë dhe drejt promovimit të multitietnicitetit.</p>
Formulari	<p>Me formular nga secila shkollë ishin mbledhur të dhëna për madhësinë e tij dhe për strukturën demografike, veçmas në klasat IV dhe VIII, si dhe të dhëna për arsimin e prindërve/tutorëve të nxënësve.</p>

Para së të përgatitet versioni final i instrumenteve me të cilat janë mbledhur të dhëna nga nxënësit dhe arsimtarët, ato ishin testuar me nxënës dhe arsimtarë në një shkollë multitietnike, e cila nuk ishte përfshirë në hulumtim. Në bazë të njohurive të fituara u bënë edhe adaptimet përkatëse të instrumenteve.

5. SHEMBULL

5.1. SHKOLLAT

Në pajtim me kornizën e aktiviteteve të planifikuara për të ardhmen në projektin *Fuqizimi i bashkëpunimit multietnik në komuna*, gjashtë shkollat e inkuadruara në këtë hulumtim paraqesin popullatë. Bëhet fjalë për nga dy shkolla në Shkup – në komunë e Butelit (në tekstin e mëtejme Shkup), Tetovë dhe Strumicë – një shkollë në komunën e Strumicës dhe një shkollë në komunën Murtino (në tekstin e mëtejme Strumicë). Në këto shkolla janë përfaqësuar më shumë bashkësi etnike (maqedonase, shqiptare, rome e të tjera), mësimi realizohet në më shumë gjuhë mësimore dhe me to QMEQ-ja do të punojë në tre vitet e ardhshme. Këto shkolla nuk janë rezprentuese të të gjitha shkollave në Republikën e Maqedonisë. Prandaj qasjet, përfundimet dhe rekomandimet u referohen konkretisht këtyre gjashtë shkollave.

Karakteristikat e shkollave që janë të përfshira në hulumtim janë dhënë në tabelat 2 dhe 3.

Tabela 2: Numri i shkollave sipas gjuhës mësimore dhe vendbanimit

Gjuha mësimore	Qytet (numri)	Fshat (numri)	Gjithsej (numri)
Maqedonisht-shqip	2	/	2
Maqedonisht-shqip-turqisht	2	/	2
Maqedonisht-turqisht	1	1	2
Gjithsej	5	1	6

Tabela 3: Numri i përgjithshëm i paraleleve dhe nxënësve në shkolla

	Gjuha mësimore maqedonase			
	Paralele		Nxënës	
	mësimi klasor	mësimi lëndor	mësimi klasor	mësimi lëndor
Shkup	12	11	189	219
Tetovë	4	3	90	64
Strumicë	38	25	429	590
Gjithsej	54	39	708	873
	Gjuha mësimore shqipe			
	Paralele		Nxënës	
	mësimi klasor	mësimi lëndor	mësimi klasor	mësimi lëndor
Shkup	16	14	361	359
Tetovë	6	6	132	170
Strumicë	0	0	0	0
Gjithsej	22	20	493	529
	Gjuha mësimore turke			
	Paralele		Nxënës	
	mësimi klasor	mësimi lëndor	mësimi klasor	mësimi lëndor
Shkup	1	1	14	17
Tetovë	1	0	4	0
Strumicë	17	0	381	0
Gjithsej	19	1	399	17

5.2. NXËNËS DHE PRINDËR

Përmes një zgjedhjeje të rastësishme, në shkolla u zgjedhën 40 nxënës të klasës IV dhe VIII nga secila gjuhë mësimore në të cilën realizohet mësimi në shkollë. Në shkollat ku mësimi në njërin nga gjuhët mësimore ndiqej nga më pak se 40 nxënës, të dhënat janë mbledhur nga të gjithë nxënësit. Nxënësit e zgjedhur i zgjidhnin testet e dikturisë dhe përgjigjeshin në pyetësor. Hulumtimi është realizuar me gjithsej 387 nxënës të klasës IV dhe 362 nxënës të klasës VIII. Ekzemplari i nxënësve është reprezentues për nxënësit e klasës IV dhe VIII në shkollat përkatëse. Në tabelën 4 është dhënë numri i nxënësve që ishin të inkuadruar në hulumtim, i klasifikuar për klasa dhe për gjuhë mësimore.

Tabela 4: Numri i nxënësve në ekzemplar

Gjuhë mësimore maqedonase		Gjuhë mësimore shqipe		Gjuhë mësimore turke	
IV	VIII	IV	VIII	IV	VIII
163	192	157	155	67	15

Të dhënat ishin mbledhur edhe nga një prind/tutor i secilit nxënës në ekzemplar. Pyetësorët u ishin dorëzuar atyre përmes fëmijëve të tyre. Pyetësorët e plotësuar ishin mbledhur nga gjithsej 363 prindër të nxënësve të klasës IV dhe 330 prindër të nxënësve të klasës VIII. Duke pasur parasysh se vetëm 57 prindër nuk i kthyen pyetësorët, respektivisht 92% prej tyre u përgjigjën, mund të konstatohet se edhe ekzemplari i prindërve është reprezentues.

Në tabelat 5 dhe 6 janë dhënë të dhënat për arsimin e prindërve të nxënësve të ekzemplarit, kjo sipas përgjigjeve (në këtë pyetje janë përgjigjur 92% e nxënësve) dhe popullatës për klasën IV dhe VIII (të dhënat janë mbledhur edhe nga shkollat për të gjithë nxënësit e klasave IV dhe VIII – nga shërbimi profesional i shkollës – tabela është dhënë në Shtojcën 1, në fund të këtij raporti).

Tabela 5: Arsimi i baballarëve të nxënësve për gjuhë mësimore

Arsimi i babait	Maqedonase		Shqipe		Turke	
	No.	%	No.	%	No.	%
Më pak se klasa IV	2	0,6	3	1	9	13,6
Klasa IV	0	0	2	0,7	23	34,8
Arsim fillor	54	16	50	18,6	10	15,2
Arsim të mesëm	181	53,8	116	43,3	24	36,4
Fakultet	99	29,5	97	36,2	0	0

Tabela 6: Arsimi i nënave të nxënësve për gjuhë mësimore

Arsimi i nënës	Maqedonase		Shqipe		Turke	
	No.	%	No.	%	No.	%
Më pak se klasa IV	2	0,6	6	2,2	14	19,2
Klasa IV	1	0,3	4	1,5	28	38,3
Arsim fillor	55	16,3	91	33,2	17	23,3
Arsim të mesëm	182	54	84	30,6	12	16,4
Fakultet	97	28,8	89	32,3	2	2,7

Sipas përgjigjeve të nxënësve, rreth 2/3 e prindërve kanë përfunduar shkollë të mesme dhe fakultet. Arsimi i prindërve të nxënësve me mësim në gjuhën mësimore turke është dukshëm më i vogël se i prindërve në shkollat me mësim në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe.

5.3. ARSIMTARË

Grupi qëllimor i arsimtarëve ishin arsimtarë për të cilët konsiderohet se kanë më së shumti mundësi që përmes mëimit të rregullt të ndikojnë në arsimin multietnik: mësuesit dhe kujdestarët e klasave që realizojnë përmbajtje në lëndën e *Shkathtësive jetësore*, të cilët kanë mundësi që edhe përmes aktiviteteve të tjera me gjithë paralelen të ndikojnë në bashkëpunimin ndëretnik, dhe arsimtarët e lëndës Arsimi qytetar, një lëndë mësimore në të cilën ka më shumë përmbajtje që kanë të bëjnë me multietnicitetin dhe multikulturën.

Në secilën shkollë me një zgjedhje të rastësishme janë zgjedhë nga: 5 arsimtarë të mëimit klasor që realizojnë mësim në secilën nga gjuhët mësimore të klasës së katërt, nga 5 kujdestarë klasash të klasës së tetë nga mësimi që realizohet në secilën nga gjuhët mësimore dhe arsimtarët që mbajnë lëndën Arsimi qytetar. Nëse numri i përgjithshëm i paraleleve në lëndët përkatëse është më i vogël se 5, ekzemplari i përfshinte të gjithë arsimtarët.

Të dhënat janë mbledhur nga gjithsej 64 arsimtarë nga gjashtë shkolla. Sipas përkatësisë etnike, 27 arsimtarë janë deklaruar si maqedonas, 26 – shqiptarë, 7 arsimtarë janë deklaruar turq dhe 4 arsimtarë nuk janë përgjigjur në pyetje.

Thuaja 2/3 e të anketuarve (40) janë femra, 20 janë meshkuj, ndërsa 4 arsimtarë nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Kjo pabarazi gjinore është e pritur, sidomos duke pasur parasysh se shumica dërrmuese e arsimtarëve të arsimit fillor janë të gjinisë femërore.

Në pikëpamje të arsimit, shumica e arsimtarëve (36) kanë mbaruar arsim sipëror, 22 arsimtarë janë me shkollë të lartë, 1 është me magjistraturë, ndërsa 5 prej tyre nuk janë përgjigjur.

Deri në 10 vjet përvojë pune kanë 20 arsimtarë, me 11-20 vjet përvojë janë 11 arsimtarë, 20 arsimtarë kanë përvojë punë prej 21-30 vjetësh, ndërsa 12 prej tyre kanë përvojë më shumë se 30 vjet. 47 arsimtarë ose 73.4% e të anketuarve tashmë e kanë realizuar programin *Shkathtësitë jetësore*.

5.4. DREJTORI DHE PUNËTORËT PROFESIONALË

Drejtori dhe njëri nga punëtorët profesional (pedagogu ose psikologu) e përbëjnë ekzemplarin e ekipit udhëheqës të shkollës. Në pyetësor u përgjigjën 15 të anketuar. Prej tyre 5 ishin drejtorë, 1 ndihmësdrejtor, 6 pedagogë dhe 3 psikologë të shkollës.

Shumica e të anketuarve:

- kanë përvojë pune ndërmjet 11 dhe 20 vjet (8 të anketuar);
- janë të moshës ndërmjet 31-40 vjeç (7);
- janë me arsim të lartë (10);
- janë femra (12);
- për nga përkatësia etnike 9 janë maqedonas, 3 janë shqiptarë, 1 turk/e dhe 2 të anketuar janë përgjigjur me “tjetër”.

5.5. PËRFAQËSUESIT E KOMUNAVE DHE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE

Të dhënat ishin mbledhur nga gjithsej 5 përfaqësues të pushtetit lokal, që janë përgjegjës të arsimit dhe 7 përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Struktura e të anketuarve të organizatave joqeveritare, sipas funksionit të tyre në organizatë, është:

- 3 koordinatorë programesh
- 1 sekretar gjeneral
- 1 anëtar i Këshillit Drejtues
- 1 nënkryetar².

Struktura, sipas përkatësisë etnike, është: 4 maqedonas, 1 boshnjak, 1 shqiptar, ndërsa për një të anketuar nuk kishte të dhëna.

Nga përfaqësuesit e pushtetit lokal, dy prej tyre janë këshilltarë për arsim, njëri është udhëheqës i sektorit të arsimit, njëri është inspektor i arsimit dhe njëri është këshilltar për marrëdhënie me opinionin. Të gjithë të anketuarit, për nga përkatësia e tyre etnike, janë maqedonas.

² Nuk ka të dhëna për funksionin e përfaqësuesve.

6. MBLEDHJA, PËRPUNIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Mbledhja e të dhënave ishte realizuar nga këshilltarët e zgjedhur të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe nga një përfaqësues i pushtetit lokal, i cili ka përvojë të këtij lloji të hulumtimit. Për to ishte organizuar trajnim njëditor dhe ishin përcaktuar afatet e dhënies së testeve e pyetësorëve për nxënës, pyetësorëve për prindër, për arsimtarë, si dhe për drejtorin dhe punëtorët profesionalë. Po ashtu ishte përcaktuar edhe mënyra e komunikimit dhe e realizimit të intervistës me përfaqësues të pushtetit lokal dhe organizatave joqeveritare.

Mbledhja e të dhënave është realizuar në periudhën 12-30 dhjetor. Pyetjet e hapura në testet për nxënës i kanë kontrolluar kontrollues të trajnuar (këshilltarë të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit), të cilët kishin përvojë në kontrollimin e këtyre testeve.

Pas mbledhjes së të dhënave, ishte bërë kodimi i instrumenteve të plotësuar dhe ishte bërë inkuadrimi i të dhënave. Të dhënat janë inkuadruar në programin Excel, ndërsa për përpunimin e tyre janë përdorë:

- ◆ Programi TIA plus – për testet dhe shkallët për arsimtarë dhe teste për nxënës, me çka janë kontrolluar karakteristikat psikometrike të testeve dhe shkallët qëndrimeve, janë llogaritur rezultatet e testeve dhe shkallët e qëndrimeve, ndërsa është bërë edhe krahasim ndërmjet shkollave sipas qyteteve dhe gjuhës mësimore.
- ◆ Programit SPSS, i cili përdoret për përpunimin e përgjigjeve të pyetjeve, si dhe për krahasimin dhe kryqëzimin e tyre.
- ◆ Të dhënat e intervistave dhe programeve vjetore për punën e shkollave janë analizuar në aspekt kualitativ, duke përdorë analizën tematike të përmbajtjes.

Pjesa II

REZULTATET

REZULTATET

Në pjesën e dytë janë paraqitur të dhënat e mbledhura nga hulumtimi. Ato janë paraqitur sipas fushave të hulumtimit të përkufizuara në kornizën konceptuale. Të dhënat paraqesin prerje të gjendjes së faktorëve relevantë që janë të nevojshëm për planifikimin e programit të aktiviteteve për fuqizimin e bashkëpunimit multietnik në komuna. Të dhënat mund të shërbejnë edhe për përcjellje të mëtejme longitudinale. Ato janë tregues të gjendjes fillestare vetëm për shkollat dhe komunat e hulumtuara dhe nuk mund të përgjithësohen për gjithë popullatën.

1. REALIZIMI I PËRMBAJTJEVE PËR ARSIM MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK

1.1. AFTËSIMI I ARSIMITARËVE PËR REALIZIMIN E PËRMBAJTJEVE

Hulumtimet³ dëshmojnë se arsimtarët janë faktori më i rëndësishëm shkollor për arsim të suksesshëm multi-etnik. Si faktorë për suksesin e tyre veçohen qëndrimet e tyre personale në lidhje me bashkëpunimin dhe tolerancën ndëretnike, si dhe aftësimi metodik për realizimin përkatës të përmbajtjeve. Këta faktorë ishin hulumtuar me ndihmën e katër instrumenteve. Për secilin prej tyre më poshtë është dhënë një përshkrim i shkurtër dhe janë paraqitur rezultatet e fituara në hulumtim.

1.1.1. Qëndrimet e arsimtarëve për arsimin multi-etnik dhe multi-kulturor

Mënyrat e matjes

Qëndrimet e arsimtarëve ishin matur me shkallën e tipit të Likertit, e cila përbëhej nga gjithsej 26 pohime që kishin të bëjnë me punën në shkollat multi-etnike. Një pjesë e pohimeve janë adaptuar me Shkallën e dallimeve të zhvilluar nga Folio dhe Vigins (E. Folio, B. Wiggins, 1999).

Pohimet janë formuluar ashtu që të shprehin qëndrim ndaj arsimit multi-etnik dhe multi-kulturor në përgjithësi, ndaj punës në shkollat multi-etnike dhe ndaj nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike.

Të anketuarit duhej ta shënonin shkallën e pajtueshmërisë me secilin pohim të shkallës katërnivelëshe (nga 1 – nuk pajtohem aspak deri në 4 – pajtohem plotësisht).

Shkalla kishte reliabilitet të lartë – koeficienti Kronbah alfa = 0,79

Rezultatet janë paraqitur përmes mesatareve aritmetike të shkallës së pranimit të pohimeve të gjithë arsimtarët dhe është llogaritur rëndësia statistikore e dallimeve ndërmjet arsimtarëve të mësimin në gjuhë të ndryshme mësimore (maqedonisht, shqip dhe turqisht) dhe nga Shkupi, Tetova dhe Strumica. Veçanërisht janë komentuar pohimet në të cilat në shkallë me të madhe ose më të vogël janë pranuar në raport me pohimet e tjera⁴.

- ◆ Marrë në përgjithësi, arsimtarët e anketuar kanë shfaqur prirje për qëndrim pozitiv ndaj arsimit multi-etnik dhe multi-kulturor. Për gjithë ekzemplarin e ar-

³ Shih pjesën 2 të kapitullin I.

⁴ Gjithkund në tekstin e mëtejme ku përmenden dallimet, kjo nënkupton se dallimi i llogaritur është me rëndësi statistikore së paku 0,05.

simtarëve mesi aritmetik (MA) është 69,94, që është dukshëm më i lartë se mesi teorik $MA = 65$, i cili mund të interpretohet si qëndrim i papërcaktuar.

- ◆ Shkalla mesatare e pranimit të numrit më të madh të pohimeve (15) është në ose mbi mesataren teorike (2,5 bë shkallë 1-4). Si për ilustrim, në shkallën më të lartë (mesatarja mbi 3,5) janë pranuar pohimet: *Arsimtari duhet t'i ketë parasysh dallimet kulturore dhe etnike ndërmjet nxënësve në shkollë gjatë punës me fëmijë të ndryshëm; Unë besoj se, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, secili fëmijë mund të mësojë dhe nuk kam kurrfarë problemi të diskutoj për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni. Por, nga ana tjetër, në shkollë dukshëm të madhe janë pranuar edhe pohime të këtilla: Ndonjëherë mendoj se çështja e tolerancës ndëretnike po sforcohet shumë; Programi mësimor është shumë i ngarkuar dhe nuk kemi hapësirë të merremi edhe me bashkëpunimin ndëretnik (ndërkulturor); Nuk është detyrë e arsimtarit që ta fuqizojë krenarinë për kulturën e pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike, që nuk shfaqin për gatishmëri për punë në arsimin multietnik dhe multikulturor.*
- ◆ Arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme mësimore nuk kanë dallim të veçantë në pranimin e dallimeve në arsim dhe në gatishmërinë për punë në mjedis multietnik.
- ◆ Arsimtarët e shkollave në Shkup kanë qëndrim paksa më pozitiv⁵ ndaj pranimit të dallimeve në arsim në raport me shkollat në Strumicë dhe Tetovë. Meset aritmetike të shkallës janë këto: Shkup – 72,90, Strumicë – 66,71 dhe Tetovë – 68,00.

Përfundim

- ◆ Duke e pasur parasysh se në përgjigjet e arsimtarëve në masë të madhe ka ndikuar prirja e tyre që të ata të paraqiten në dritë të mirë, sepse në Maqedoni deklarativisht promovohet arsimi multietnik, ndërsa arsimtarët e intervistuar punojnë në shkolla të përziera, treguesit e fituar për qëndrimet e tyre për pranimin e dallimeve në arsim dhe në punën në mjedise multietnike nuk mund të vlerësohen si bazë shumë e mirë për arsimin multietnik.
- ◆ Qëndrimi ndaj pranimit të dallimeve në mjedis më heterogjen etnik dhe kulturor, siç është Shkupi, është më pozitiv. Kjo shkon në favor të hipotezës se kontaktet ndikojnë në pranimin e dallimeve etnike dhe kulturore.

⁵ The difference in the arithmetic means between Skopje and Strumica, as well as Skopje and Tetovo, is significant at the 0.05 level. Between Strumica and Tetovo there is no difference.

1.1.2. Përgatitja pedagogjike dhe metodike e arsimtarëve për arsim multietnik


Arsimi i suksesshëm multietnik, sipas hulumtimeve dhe përvojave, nënkupton gatishmërinë përkatëse të realizuesve, para së gjithash të arsimtarëve. Përgatitja ka të bëjë si me qëndrimet personale në lidhje me multietnicitetin, ashtu edhe me kompetencën për përdorimin e metodave dhe qasjeve efektive metodike.

Mënyrat e matjes

Përgatitjet pedagogjike dhe metodike të arsimtarëve për arsim multietnik janë matur me tre instrumente:

1. *Testi për arsimtarët*, të cilin e përbëjnë 5 situata mësimore (vinjeta). Ato i përshkruajnë situatat e ndjeshme etnike në shkollë, në të cilat arsimtari mund të sillet në mënyrë të duhur ose të gabuar ndaj qasjes së dëshiruar në shkollë multietnike. Në një situatë kërkohet që arsimtari ta vlerësojë secilën nga 5 procedurat e ofruara se a është ajo adekuatë (për secilën janë dhënë alternativa: po, jo dhe nuk jam i sigurt), ndërsa për katër situatat e tjera kërkohet që nga reaksionet e ofruara arsimtari ta zgjedhë atë që është më e qëlluar. Testi ishte shumë i shkurtër (vetëm 9 ajtemë) dhe për këtë arsye kishte edhe reliabilitet të ulët – koeficient alfa = 0,49, por vlera e matur, nëse do të kishte 40 ajtemë me karakteristika të ngjashme, do të ishte 0,81.
2. *Shkalla e vetëvlerësimit për përgatitjen për punë në mjedis multietnik dhe multikulturor*. Shkalla i përmban 12 ajtemë që kanë të bëjnë me dituritë dhe shkathtësitë që duhet t'i kenë arsimtarët për punë të suksesshme në mjedis multikulturor dhe multietnik. Të intervistuarit e vlerësojnë aftësimin në shkallë me tre nivele: 3 – mjaft i/e përgatitur; 2 – pjesërisht i/e përgatitur dhe 1 – thuajse i/e papërgatitur.
3. *Shkalla e vetëvlerësimit për gatishmërinë e përdorimit të metodave interaktive për realizimin e përmbajtjeve me karakter multietnik*. Shkalla i përmban 9 pika që kanë të bëjnë me dituritë dhe shkathtësitë që duhet t'i kenë arsimtarët për punë të suksesshme në mjedis multikulturor dhe multietnik. Të anketuarit e vlerësojnë aftësimin në shkallë me tre nivele: 3 – mjaft i/e përgatitur; 2 – pjesërisht i/e përgatitur dhe 1 – thuajse i/e papërgatitur.
4. *Pyetësori për realizimin e arsimit multietnik dhe multikulturor*. Pyetësori përbëhet nga 8 pyetje të tipit të mbyllur, të cilat ishin pjesë përbërëse e pyetësorit për arsimtarë.

Në testin e diturive metodike dhe pedagogjike numri maksimal i pikëve ishte 9. Rezultati mesatar i testit nga **të gjithë arsimtarët** është 5,66 pikë, përkatësisht përqindja e zgjidhjeve është 63%. Rezultati më i ulët i testit është 1 pikë, ndërsa rezultati më i lartë është 9 pikë – i arritur vetëm nga tre arsimtarë. Shumica e arsimtarëve të anketuar (59%), janë përgjigjur saktë (gjegjësisht e kanë zgjedhur atë opsion që flet për reagimin përkatës në situatën e përshkruar të ndjeshme multietnike) në 5-7 ajtemë.



Grafiku 1: Rezultatet e të gjithë arsimtarëve në testin e diturive metodike dhe pedagogjike

- ◆ Rezultatet mesatare të testit **të arsimtarëve që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme mësimore** nuk dallohen mes vete.
- ◆ Rezultatet mesatare të testit **të arsimtarëve të Shkupit, Tetovës dhe Strumicës** nuk dallohen mes vete.

1.1.2.1. Përgjigje për reagimet në situata të caktuara me ndjeshmëri etnike


Që të fitohet pasqyrë më e mirë për dituritë që hulumtohen dhe për përgjigjet e arsimtarëve, më poshtë janë dhënë përshkrimet e kërkesave në situata të ndjeshme etnike dhe përgjigjet e arsimtarëve në ato.

Në tabelën 7 numri i ajtemëve është adekuat ndaj numrit të kërkesave të grafikut 1.

Tabela 7: Ndërlidhja e kërkesave të Testit të diturive pedagogjike me principet

Situata mësimore	Ajtem	Përshkrimi i kërkesës
1	1 - 5	Çka duhet të bëjë arsimtari që e dëgjon bisedën në të cilën një nxënese i tregon një nxëneseje tjetër se nuk dëshiron të udhëtojë me autobusin në të cilin udhëtojnë romë, sepse ata bëjnë probleme. - Janë ofruar 5 reagime të mundshme dhe për secilin jepet mundësi për të dhënë përgjigje PO, JO dhe NUK JAM I SIGURT. 4 prej tyre janë adekuate – vetëm njëra është joadekuate.
2	6	Çka duhet të bëjë arsimtari nëse prindërit dëshirojnë t'i zhvendosin fëmijët në shkollë tjetër, sepse në paralele ka fëmijë romë që mësojnë dobët dhe nuk janë të disiplinuar. - Janë ofruar 4 reagime të mundshme
3	7	Reagimi i drejtorit në situatën kur një arsimtar shpreh mospajtim për shkak të ndjenjës së diskriminimit në baza etnike. - Janë ofruar 4 reagime të mundshme
4	8	Reagimi i arsimtarit në klasë në situatë kur ekziston mospranim i ndonjë nxënësi nga një grup tjetër etnik. - Janë ofruar 6 reagime të mundshme.
5	9	Kuptimi i konceptit tolerancë - Janë ofruar 4 reagime të mundshme

Në grafikun vijues është paraqitur përqindja e përgjigjeve të sakta për secilin ajtem, përkatësisht zgjedhje të procedurës përkatëse.

**Grafiku 2:** Përqindja e zgjedhjes së procedurës përkatëse

Reagimet adekuate i kanë zgjedhur 28% deri në 88% të arsimtarëve. Arsimtarët e anketuar e kishin më lehtë ta njohin adekuatshmërinë e procedurës 1 të dhënë në situatën 1. Më shumë vështirësi kanë pasur në zgjedhjen e reagimit përkatës në situatën 4. Sa për ilustrim, më poshtë janë dhënë të dyja situatat dhe përqindja e përgjigjeve të zgjedhura.

◆ Situata 1 – Reagimi kur kuptojmë se ekzistojnë paragjyqime

Më poshtë është dhënë detyra dhe përqindja e arsimtarëve që e kanë zgjedhur secilin nga opsionet e mundshme. Me numra të errësuar janë shënuar përgjigjet metodike. Shuma e përqindjes është më e vogël se 100, kjo për shkak të përqindjes së pyetjeve të papërgjigjura, që nuk janë vendosur në tabelë. Gjatë llogaritjes së rezultatit të përgjithshëm të testit, detyrat e papërgjigjura janë vlerësuar si përgjigje të pasakta.

Gjatë kohës së pushimit një nxënëse i tregon një nxënëses tjetër se ajo nuk dëshiron të udhëtojë me autobusin që kalon kah lagja e romëve, sepse nxënësit romë gjithnjë bëjnë ndonjë problem në autobus.

Çka nga kjo që është dhënë më poshtë duhet të bëjë arsimtari që e dëgjon këtë bisedë?

	Po %	Jo %	Nuk jam i/e sigurt %
1) Të inkuadrohet në bisedë dhe të flasë për tolerancën dhe paragjykimet.	88	3	5
2) Të mos u përzihet në bisedë.	9	61	13
3) T'i tregojë drejtorit dhe shërbimit profesional se ekzistojnë paragjyqime.	55	17	14
4) Të bisedojë me prindërit e nxënëses që ka paragjyqime.	78	3	9
5) Të bisedojë me fëmijët e nacionalitetit rom për problemet në autobus.	78	8	11

◆ Situata 4 – Reagimi i arsimtarit në klasë në situatë kur ekziston mospranim i ndonjë nxënësi të ndonjë grupi tjetër etnik

Më poshtë është dhënë detyra dhe përqindja e arsimtarëve që e kanë zgjedhë secilin nga opsionet e mundshme. Me numrat e errësuar janë shënuar përgjigjet e sakta. Shuma e përqindjeve është më e vogël se 100, kjo për shkak të përqindjes së pyetjeve të papërgjigjura, e cila nuk është vendosur në tabelë. Gjatë llogaritjes së rezultatit të përgjithshëm të testit, detyrat e papërgjigjura janë vlerësuar si përgjigje të pasakta.

Arsimtarja e ka ulur Marinë në bankë me Elvirën, e cila është romë. Madje, asaj ia ka shpjeguar se Elvirës i duhet ndihmë në mësim dhe, nëse ajo ulet afër saj, ajo do të mësojë më mirë. Marija nuk dëshiron të ulet me të. Elvira ka qarë, sepse ajo e do shumë Marinë.

Çka nga kjo që është dhënë më poshtë duhet të bëjë arsimtarja?

1) Ta ulë Elvirën me ndonjë nxënëse tjetër të mirë.	0%
2) Të bisedojë me prindërit e Marisë.	13%
3) T'ia shpjegojë Marisë vetëm se sjellja e saj nuk është në rregull.	8%
4) T'i tregojë Elvirës se çfarë është Marija dhe se ajo nuk duhet të shoqërohet me të.	0%
5) Ta ftojë Elvirën dhe Marinë dhe të përipiqet t'i shoqërojë.	28%
6) Të bisedojë me gjithë paralelen për shoqërinë dhe ndihmën e ndërsjellë.	28%

Përfundim


- ◇ Arsimtarët nuk ishin shumë të suksesshëm në zgjedhjen e procedurave adekuate në situata të ndjeshme etnike. Në trajnime do të ishte mirë të diskutohen situatat reale dhe mënyrat adekuate të reagimit të arsimtarëve.
- ◇ Nuk ka dallime në suksesin e arsimtarëve në këtë test, kjo duke pasur parasysh gjuhën mësimore ose qytetin në të cilin punojnë. Kjo flet se një pjesë e trajnimeve mund të jenë identike.

1.1.2.2. Vetëvlerësimi i gatishmërisë për punë në mjedis multietnik dhe multikulturor

Me qëllim që të hulumtojmë se sa ndjehen arsimtarët të përgatitur për t'i realizuar përcaktimet e arsimit multietnik dhe multikulturor, që janë skicuar në *Koncepcionin e arsimit fillor nëntëvjeçar*, ata vetë kanë bërë vetëvlerësimin e aftësisë së tyre për të realizuar aktivitete që janë në frymën e principeve dhe qëllimeve të arsimit fillor. Sipas *Koncepcionit – Principi i kuptimit të tjerëve dhe multikulturaliteti* nxit që në jetën e përditshme dhe në punën në shkollë “të promovohet zhvillimi i vlerave të nxënësit për jetë të përbashkët, respektimi i dallimeve ndërmjet njerëzve dhe respektimi i kulturës, gjuhës dhe traditave të tyre.... për zhvillimin e vetëdijes së nxënësve për prejardhjen e tyre kulturore, por edhe për nxitjen e interesit për njohjen e trashëgimisë kulturore të bashkësive të tjera” (fq. 74). *Principi i demokracisë* angazhohet për zhvillimin e vlerave themelore njerëzore që janë të pacenueshme, si jeta, liria individuale, integriteti, dinjiteti dhe të drejtat e barabarta, ndërsa *Principi i mosdiskriminimit* angazhohet për arsim pa çfarëdo qoftë diskriminimi, duke përfshirë në mënyrë eksplicite edhe mosdiskriminimin në baza etnike. (fq. 69-70). Si mjet përmes të cilit arrihet kjo, jepet edhe njohja e të kaluarës dhe traditave kulturore të popullit maqedonas dhe të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, promovimi i principeve të barazisë ndërmjet njerëzve; promovimi i rëndësisë së sjelljes tolerante, solidaritetit dhe aftësisë për zgjidhje të padhunshme të konflikteve. (fq. 78).

Duke u nisur nga kjo, në pyetësonin për arsimtarë ishte vendosur një shkallë përmes së cilës ata bënin vetëvlerësimin e aftësisë për t'i mësuar nxënësit për: të drejtat e njeriut, për zgjidhjen e konflikteve, për tejkalimin e stereotipave dhe paragjykimëve etnike, për njohjen e kulturës së bashkësive të tjera, si dhe për të punuar në mjedise të përziera etnike dhe kulturore. Sipas përgjigjeve të arsimtarëve, shumica e tyre ndjehen plotësisht të gatshëm për njohjen dhe ballafaqimin me paragjykimet etnike, për zgjidhjen e konflikteve dhe për mësimin e të drejtave të fëmijëve.

Numri më i madh i arsimtarëve kanë vlerësuar se janë pjesërisht të përgatitur për punën me fëmijë që në mënyrë të ndryshme e njohin gjuhën në të cilën zhvillohet aktiviteti, për t'u ballafaquar me stereotipat dhe paragjykimet e prindërve, që t'i njohin stereotipat në tekste shkollore, t'i përshtatin materialet mësimore për punën me nxënës të përkatësive të ndryshme etnike dhe t'i mësojnë nxënësit për ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe kulturore në Maqedoni.



Grafiku 3: Vetëvlerësimi i arsimtarëve për përmbajtjet dhe aktivitetet e realizuara që kanë të bëjnë me arsimin multietnik dhe multikulturor


Arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhën mësimore maqedonase, në krahasim me arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhën mësimore shqipe, ndjehen më të përgatitur për realizimin e shumicës së aktiviteteve. Veçmas janë më të përgatitur që t'i mësojnë nxënësit për: ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet grupeve etnike dhe kulturore në Maqedoni, t'i njohin dhe t'i tejkalojnë stereotipat etnike dhe ta fuqizojnë vetëbesimin e nxënësve të bashkësive të marginalizuara.

- ◆ Nuk ka ndonjë dallim të madh në vetëvlerësimin e gatishmërisë së përmbajtjeve dhe aktiviteteve të dhëna te arsimtarët e qyteteve të ndryshme.

1.1.2.3. Vetëvlerësimi i gatishmërisë për shfrytëzimin e metodave interaktive

Arsimi multi-etnik dhe multikulturor më shumë se mësimi në “lëndët tradicionale intelektuale” presupozon realizim përmes metodave interaktive. Duke e pasur parasysh praktikën dominuese të mësimi tradicional në shkollat tona, planifikimin e pamjaftueshëm dhe shfrytëzimin e aktiviteteve të projektit, është shumë me rëndësi që arsimtarët të aftësohen për shfrytëzimin e metodave adekuate interaktive.

Në pyetësor prej tyre kërkohet që ta vlerësojnë se sa janë të aftë për përdorimin e një pjese të metodave inetraktive që duhet të shfrytëzohen. Vlerësimin e bënin në shkallën prej tre niveleve: mjaft i/e përgatitur, pjesërisht i/e përgatitur dhe thuajse i/e papërgatitur.



Grafiku 4: Vetëvlerësimi i arsimtarëve për aftësinë e shfrytëzimit të metoda interaktive

Një e treta deri në gjysmën e arsimtarëve mendojnë se janë mjaft të aftësuar për shfrytëzimin e metodave që pritet të përdoren gjatë realizimit të përmbajtjeve të natyrës multi-etnike. Po aq mendojnë se nuk janë sa duhet të aftësuar. Numri i arsimtarëve që kanë vlerësuar se janë thuajse të paaftë është më i vogël për 10 për qind. Shumica e arsimtarëve vlerësojnë se janë të aftë për përdorimin e ushtrimeve për zhvillimin e vetëdijes për veten. Kjo si duket buron nga fakti se arsimtarët e mësimi klasor realizojnë përmbajtje të tilla në programin e *Njohjes së natyrës*. Është pak befesues fakti se më pak të përgatitur ndjehen në përdorimin e mediave dhe shfrytëzimin e pushtetit lokal.

Përfundim

- ◆ Marrë në përgjithësi, shumica e arsimtarëve vlerësojnë se janë **pjesërisht të aftësuar** për shfrytëzimin e më shumë metodave që janë adekuate për arsimin multietnik.
- ◆ Përgjigjet e tyre për atë se për cilat metoda ndjehen më pak të aftë, duhet të kihet parasysh gjatë planifikimit të trajnimeve.

1.2. TË ARRITURAT E NXËNËSVE NGA PËRMBAJTJET MËSIMORE RELEVANTE PËR ARSIMIN MULTITETNIK

Në hulumtimin e nxënësve në aspekt të mësimin të përmbajtjeve që janë relevante për arsimin multietnik dhe të arriturat e nxënësve kemi matur:

- ◆ Te **nxënësit e klasës së katërt** – dituritë nga lënda mësimore *Njohja e mjedisit* dhe *Shkathtësitë jetësore* që i kanë mësuar në klasën e tretë;
- ◆ Te **nxënësit e klasës së tetë** – dituritë nga lënda mësimore *Arsimi qytetar* dhe *Shkathtësitë jetësore* që i kanë mësuar deri atëherë;
- ◆ Njohjen e fushave që pritet të jenë pjesë e mësimin, ndërsa kanë të bëjnë me arsimin multietnik dhe multikulturor.

Ndonëse të dhënat janë mbledhur në nëntor/dhjetor te nxënësit e klasës së katërt, respektivisht të klasës së tetë, detyrat e testeve të diturive kishin të bëjnë me përmbajtje që mësohen deri në fund të klasës së tretë, respektivisht të shtatë.

1.2.1. Të arriturat e nxënësve në test – klasa IV

Vlerësimin e të arriturave të nxënësve e bazojmë në shkallët e arritura të nxënësve gjatë zgjidhjes së test-detyrave që i matin dituritë e njësive të parashikuara me programin mësimor të lëndës *Njohja e mjedisit*, një lëndë që nxënësit e kanë mësuar në klasën e tretë dhe *Shkathtësitë jetësore*, që nxënësit e kanë mësuar nga klasa e parë deri në tretën.

Mënyrat e matjes

Testi për nxënës të klasës së katërt përbëhet nga 11 detyra (dy me përgjigje të shkurtra, ndërsa nëntë me zgjedhjen dhe rrethimin e përgjigjes më adekuate/më të saktë nga tre përgjigjet/reagimet e ofruara prej gjashtë gjithsej). Shkalla maksimale e testit është 11.

Detyrat e testit kishin të bëjnë me:

- ◇ Dituritë për traditën dhe kulturën e bashkësisë tënde dhe të bashkësive të tjera;
- ◇ Njohjen e të drejtave të fëmijëve dhe
- ◇ Pranimin dhe respektimin e dallimeve, si dhe me tolerancën.


Një numër i vogël i detyrave në test për secilin nga qëllimet e dhëna nuk lejojnë përgjithësim, andaj edhe përfundimet do t'u referohen diturive dhe aftësive që në mënyrë eksplicite janë matur me detyrat dhe kanë të bëjnë me nxënësit e shkollave në të cilat është zhvilluar hulumtimi.

Testi ishte shumë i shkurtër dhe për këtë arsye kishte realibilitet të ulët – koeficienti alfa = 0,44, por vlera e vlerësuar, nëse do të kishte 40 ajtemë me karakteristika të ngjashme, do të ishte 0,74.

Shkalla e arritur mesatare për nxënës (për të gjithë nxënësit) e testit është 6,02; gjegjësisht përqindja mesatare e zgjidhjes është 54,71%.

- ◇ Rezultatet mesatare në test të **nxënësve të Shkupit, Tetovës dhe Strumicës** dallohen dhe ato dallime të të arriturave në aspekt statistikor janë të rëndësishme ndërmjet tre qyteteve.

Në grafikun e mëposhtëm janë dhënë rezultatet mesatare sipas qyteteve.




Grafiku 5: Rezultatet e të gjithë nxënësve dhe rezultatet sipas qyteteve në gjithë testin.

Rezultate më të larta janë ato të nxënësve të shkollave të Strumicës (shkalla mesatare është 6,71, gjegjësisht 61,02 për qind); pastaj vijnë nxënësit e shkollave të Tetovës (shkalla mesatare është 5,98, gjegjësisht 54,32 për qind), ndërsa të arriturat më të dobëta janë të nxënësve të Shkupit (shkalla mesatare është 5,41, gjegjësisht 49,17 për qind).

- ◆ Rezultatet mesatare të nxënësve sipas gjuhës mësimore po ashtu dallohen. Dallimet në të arritura në aspekt statistikor janë të rëndësishme ndërmjet tre gjuhëve mësimore (maqedonisht, shqip dhe turqisht).

Në grafikun më poshtë janë dhënë rezultatet mesatare të nxënësve sipas gjuhëve mësimore.



Grafiku 6: Rezultatet e të gjithë nxënësve dhe rezultatet sipas gjuhëve mësimore në gjithë testin

Rezultatet më të larta janë ato të nxënësve me mësim në gjuhën maqedonase (shkalla mesatare është 6,93, gjegjësisht 63,02 për qind); pastaj vijnë nxënësit që ndjekin mësim në gjuhën turke (shkalla mesatare është 6,04, gjegjësisht 54,95 për qind), ndërsa më të dobëta janë të arriturat e nxënësve të gjuhës mësimore shqipe (shkalla mesatare është 5,06, gjegjësisht 45,98 për qind).


1.2.1.1. Përgjigjet e nxënësve në detyra

Në tabelën më poshtë është dhënë një përshkrim i shkurtër i kërkesave të secilës detyrë të testit.

Tabela 8: Përshkrim i detyrave të testit

Detyra	Përshkrimi i kërkesës
1.	Cili desert karakteristik është i lidhur me një festë myslimane? - Janë ofruar 4 përgjigje.
2.	Të shkruhet një shenjë specifike për një festë të krishterë.
3.	Njohja e flamurit të Republikës së Maqedonisë - Janë ofruar 6 përgjigje (vizatime të flamurëve).
4.	Kuptimi i asaj se rregullat shkollore duhet të jenë "fer"/të barabarta për të gjithë fëmijët. - Janë ofruar 4 përgjigje, prej të cilave njëra orienton në diskriminim gjinor.
5.	Çka duhet të bëjë drejtori i një shkolle multietnike që të sigurojë që fëmijët të shoqërohen më mirë? - Janë ofruar 3 reagime të mundshme.
6.	Njohja e mënyrave me të cilat mund të thyhen të drejtat e fëmijëve. - Janë ofruar 4 fotografi, nga të cilat në njërin është paraqitur thyerja e të drejtave të fëmijëve.
7.	Njohja e të drejtave të fëmijëve. - Janë ofruar përgjigje të 4 nxënësve, nga të cilat njëra është e saktë.
8.	Mendimi i nxënësve në lidhje me diskutimet e shpeshta ndërmjet fëmijëve në një shkolle multietnike. - Janë ofruar 4 përgjigje të mundshme, nga të cilat njëra është e saktë.
9.	Reagimi i një nxënësi në situatë kur duhet t'i ndihmohet në mësim një nxënësi të grupit tjetër etnik.
10	Njohja e karakteristikave përmes të cilave mund të njihet kultura e një populli. - Janë ofruar 4 përgjigje të mundshme, nga të cilat njëra është e saktë.
11.	Kuptimi i nocionit tolerancë – njohja e tolerancës - Janë ofruar 4 përshkrime të sjelljeve të mundshme


Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur përqindja e përgjigjeve të sakta ose zgjedhja e reagimit përkatës nga **të gjithë nxënësit e testuar** për secilën detyrë.



Grafiku 7: Rezultatet për detyra të të gjithë nxënësve në test

Përgjigje adekuate/të saktë të detyrave kanë zgjedhë ndërmjet 22% e 91% nga **të gjitha** nxënësit e testuar. Shumica e nxënësve (91%) kanë zgjedhë përgjigje të saktë të detyrës 1, pastaj të detyrës 3 (84%) dhe të detyrës 9 (81%). Përqindja më e vogël e nxënësve kanë përgjigje të saktë në detyrën 11 (22%)


Nëse shikohen në aspekt **të qyteteve**, rezultatet për detyra të caktuara në test janë të ngjashme me rezultatet e detyrave **të të gjithë** nxënësve. Në grafikun më poshtë është paraqitur përqindja e zgjidhjeve të detyrave të nxënësve në secilin prej tre qyteteve.



Grafiku 8: Rezultati në detyra i të gjithë nxënësve dhe rezultati për qytete

Edhe për qytete detyrat me zgjidhje më të suksesshme janë detyrat 1, 3 dhe 9, ndërsa zgjidhje më të dobët ka detyra 11. Nëse për detyra me zgjidhje më të suksesshme i konsiderojmë ato ku ka përqindje të të lartë të zgjidhjes se 70%, në këtë kategori mund të vihen edhe detyrat 6 dhe 10 – por, vetëm për nxënësit e shkollave në Strumicë.

Për nga gjuhët mësimore, rezultatet për detyra janë po ashtu **të ngjashme me rezultatet e përgjithshme**. Në grafikun më poshtë është paraqitur përqindja e zgjidhjeve për secilën detyrë të nxënësve për secilën nga tre gjuhët mësimore.



Grafiku 9: Rezultati i të gjithë nxënësve dhe rezultati për gjuhë mësimore në detyra

Për secilën gjuhë mësimore më mirë janë zgjidhur detyrat 1, 3 dhe 9, ndërsa më dobët është zgjidhur detyra 11. Në kategorinë e detyrave të zgjidhura mirë (përqindje më të lartë se 70%) mund të vendosen edhe detyrat 6 dhe 7, kjo për nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase.

1.2.1.2. Shembuj të detyrave dhe të arriturave të nxënësve

Për ilustrim, më poshtë janë dhënë tre detyra që kanë **zgjidhje më të dobët**, me përqindje të nxënësve që e kanë zgjedhur secilën nga përgjigjet e mundshme, **për qytete dhe për gjuhë mësimore** (detyrat **4, 5** dhe **11**). Më shkronja të errësuara është përgjigja e saktë. Shuma e përqindjeve është më e vogël se 100, kjo për shkak të përqindjes së nxënësve që nuk janë përgjigjur në pyetje.

Detyra 4: Rregullat shkollore duhet të jenë “fer”/të barabarta

Rregullat shkollore duhet të jenë fer (të barabarta) për të gjithë fëmijët.
Cila nga këto rregulla nuk është fer ndaj ndonjë fëmije?

	Shkup	Tetovë	Strumicë
1) Vetëm meshkujt mund të luajnë basket për shkollën.	23	34	48
2) Vetëm 20 minuta është pauza për mensë.	6	14	23
3) Nxënësit duhet ta rregullojnë klasën para se të dalin prej saj.	39	20	23
4) Detyra e shtëpisë nuk jepet të premtën.	9	11	5
	Maqedonisht	Shqip	Turqisht
1) Vetëm meshkujt mund të luajnë basket për shkollën.	40	24	48
2) Vetëm 20 minuta është pauza për mensë.	14	13	19
3) Nxënësit duhet ta rregullojnë klasën para se të dalin prej saj.	28	27	22
4) Detyra e shtëpisë nuk jepet të premtën.	6	11	9

- ◆ Diskriminimin gjinor, si një “rregull” që nuk është e njëjtë për të gjithë fëmijët, e kanë dalluar thuaja gjysma e nxënësve të Strumicës dhe gjysma e nxënësve me mësim në gjuhën mësimore turke.
- ◆ Përqindja më e madhe e nxënësve të Shkupit (39) për rregull që nuk është fer e konsiderojnë përgjigjen e tretë (rregullimin e klasës), me çka pajtohen edhe 22% deri në 28% të nxënësve me mësim në gjuhën maqedonase, shqipe, respektivisht turke.

Detyra 5: Si mund të sigurojë drejtori i një shkollë multietnike që fëmijët të shoqërohen më mirë

Në një shkollë mësojnë fëmijë që janë shqiptarë, romë, turq, maqedonas e të tjerë.
Çka duhet të bëjë drejtori që fëmijët të shoqërohen më mirë?

	Shkup	Tetovë	Strumicë
1) T'u urdhërojë t'i mësojnë të gjitha gjuhët që fliten në shkollë.	30	19	29
2) Të sjellë rregulla për atë sesi të respektohen ata mes vete.	25	45	30
3) Të organizojë ngjarje dhe shfaqje të ndryshme, ku do të marrin pjesë të gjithë.	30	28	32
	Maqedonisht	Shqip	Turqisht
1) T'u urdhërojë t'i mësojnë të gjitha gjuhët që fliten në shkollë.	18	28	36
2) Të sjellë rregulla për atë sesi të respektohen ata mes vete.	32	43	24
3) Të organizojë ngjarje dhe shfaqje të ndryshme, ku do të marrin pjesë të gjithë.	40	16	37

- ◆ Në këtë pyetje vetëm 32% e nxënësve në Strumicë, 40% e nxënësve me mësim në gjuhën maqedonase dhe 37% e nxënësve me mësim në gjuhën turke janë përgjigjur saktë. Nxënësit në Tetovë dhe në Shkup dhe nxënësit me mësim në gjuhën shqipe kanë rezultate më të dobëta.
- ◆ Në të tria qytetet më shumë se 2/3 e nxënësve e kanë zgjedhur si të drejtë qasjen autoritare në sjellje (“urdhër” ose “marrje të vendimit”), ndërsa sipas gjuhës mësimore përqindja e zgjedhjes së qasjes autoritare është më e lartë te fëmijët me mësim në gjuhën shqipe (71%). Ka shumë mundësi që kjo përgjigje ta pasqyrojë praktikën reale në shkolla dhe mënyrën në të cilën zgjidhen situatat në shkollë.
- ◆ Nga ana tjetër, edhe nëse nuk e pranojmë si përgjigje më të qëlluar, përqindja e nxënësve që e kanë zgjedhur procedurën 1 (“urdhër për t'u mësuar të gjitha gjuhët”), kjo flet për një nivel të caktuar të vetëdijes për nevojën që të dihet gjuha “e tjetrit”. Kjo veçmas vihet re te nxënësit e Shkupit dhe të Strumicës (shikuar për qytete) dhe të nxënësit me mësim në gjuhën shqipe, respektivisht turke (ndoshta për shkak se këta fëmijë që nga klasa e tretë fillojnë ta mësojnë gjuhën maqedonase – ndjejnë se mund të komunikojnë më mirë).

Detyra 11. Kuptimi i nocionit tolerancë**Çka do të thotë të jesh tolerant?**

	Shkup	Tetovë	Strumicë
1) T'i lëshojmë pe dikujt vetëm për arsye se ne jemi më të mençur.	32	14	41
2) Ta respektojmë të drejtën e të tjerëve që të jenë të ndryshëm nga ne.	26	18	25
3) Të mos u pengojmë të tjerëve dhe ata mos të na pengojnë.	20	35	19
4) Ta durojmë sjelljen e dikujt që është më i fortë se ne.	9	13	6
	Maqedonisht	Shqip	Turqisht
1) T'i lëshojmë pe dikujt vetëm për arsye se ne jemi më të mençur.	33	22	24
2) Ta respektojmë të drejtën e të tjerëve që të jenë të ndryshëm nga ne.	25	15	36
3) Të mos u pengojmë të tjerëve dhe ata mos të na pengojnë.	28	26	21
4) Ta durojmë sjelljen e dikujt që është më i fortë se ne.	4	15	10

- ◆ Vetëm 26% e nxënësve të Shkupit dhe 36% e nxënësve me mësim në gjuhën turke kanë përgjigje të saktë. Në qytetet e tjera, si dhe te nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase dhe shqipe, ka përqindje të vogël të përgjigjeve të sakta.
- ◆ Është e lartë përqindja e atyre që mendojnë se toleranca është “lëshim pe” (përqindja më e lartë e nxënësve është nga Strumica 41% dhe nxënës me mësim në gjuhën maqedonase – 33%).

Kjo detyrë në një situatë përkatëse ishte dhënë edhe në testin e sjelljes në situata të ndjeshme etnike. Edhe pse 55% e arsimtarëve e kanë zgjedhur reagimin përkatës dhe si duket ata ua shpjegojnë drejt nocionin e tolerancës nxënësve të tyre, 19% e arsimtarëve pajtohen me atë se toleranca është njësoj si “lëshimi pe” ndaj të tjerëve.

Përfundim

- ◆ Nxënësit kanë qenë mesatarisht të suksesshëm në zgjedhjen e përgjigjeve përkatëse, respektivisht në pyetjet e parashtruara. Në pyetjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me nocione që mësohen në kasën e tretë (për shembull, toleranca, të drejtat e fëmijëve) kishte rezultate të pritura më të larta.
- ◆ Ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në suksesin e nxënësve në këtë test si për nga gjuha mësimore, ashtu edhe për nga qyteti në të cilin jetojnë/mësojnë. Kjo tregon se gjatë planifikimit dhe realizimit të trajnimeve, duke qenë në lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet që duhet të zbatohen me nxënës, duhet të ketë pjesë që do të jenë specifike për gjuhën e ndryshme mësimore, përkatësisht për qytetet e ndryshme.
- ◆ Shumica e nxënësve e zgjedhin si të drejtë qasjen autoritare në përmirësimin e tolerancës etnike mbase për shkak se janë të mësuar me këtë mënyrë të zgjidhjes së mospajtimeve etnike në shkollë.

1.2.2. Të arriturat e nxënësve në test – klasa VIII

Vlerësimin për të arriturat e nxënësve në klasën e tetë e bazojmë në rezultatet e arritura të nxënësve gjatë zgjidhjes së test-detyrave që i matin dituritë e parashikuara në programet mësimore në lëndët *Arsimi qytetar në klasën e shtatë* dhe *Arsimi për shkathtësi jetësore* për nxënës të klasës së gjashtë deri në të nëntën.

Mënyrat e matjes

Testi për nxënës, në të cilin janë matur arritjet e qëllimeve të temave të dhëna më poshtë, përbëhej nga 24 detyra: pesë me përgjigje të shkurtra, shtatëmbëdhjetë me zgjedhje dhe rrethim të përgjigjes adekuate/të saktë nga përgjigjet/reagimet e ofruara dhe dy pyetje me klasterë që kanë nga 5, respektivisht 6 kërkesa (gjithsej 33 pika). Pikët maksimale të testit janë 34.

Detyrat e testit kishin të bëjnë me temat:


- ◆ Të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut,
- ◆ Demokracia dhe shoqëria qytetarë dhe
- ◆ Unë dhe të tjerët (marrëdhëniet shoqërore).

Përfundimet janë bazuar në rezultate, kanë të bëjnë me dituritë dhe aftësitë që në mënyrë eksplicite janë matur me detyrat e testit dhe u referohen nxënësve të shkollave në të cilat realizohet hulumtimi.

Testi kishte karakteristika të mira matëse, alfa koeficient = 0,80, që është afër vlerës së vlerësuar, nëse do të kishte 40 test-detyra me karakteristika të njëjta (reliabiliteti do të ishte 0,83).

- ◆ Rezultati mesatar i arritur për nxënës (për të gjithë nxënësit) në test është 19,38, përkatësisht përqindja mesatare e zgjidhjes është 57%.
- ◆ Të arriturat mesatare të testit të **nxënësit e të tre qyteteve** në aspekt statistikor **nuk kanë ndonjë dallim të theksuar**.

Në grafikun më poshtë janë dhënë rezultatet mesatare për qytete.




Grafiku 10: Rezultatet e të gjithë nxënësve dhe rezultatet e nxënësve për qytete

Rezultatet mesatare të nxënësve të shkollave të Strumicës (rezultati mesatar 19,82 pikë, respektivisht 58,29 për qind) janë fare pak më të larta se rezultatet e nxënësve të Tetovës dhe Shkupit (nxënësit e shkollave të Tetovës kanë rezultat mesatar 19,35, respektivisht 56,90 për qind zgjidhje, ndërsa nxënësit e Shkupit kanë rezultat mesatar 19,25, ndërsa përqindja e zgjidhjes është 56,80).

Rezultatet mesatare të testit, sipas gjuhës mësimore, **kanë dallim të theksuar statistikor** ndërmjet të arriturave të nxënësve **me mësim në gjuhën mësimore maqedonase dhe mësim në gjuhën mësimore shqipe**, si dhe mes nxënësve me mësim në **gjuhën mësimore maqedonase dhe gjuhën mësimore turke**.

Në grafikun e mëposhtëm janë dhënë rezultatet mesatare të nxënësve për gjuhë mësimore.



Grafiku 11: Rezultatet e të gjithë nxënësve dhe rezultate e nxënësve për gjuhë mësimore

Rezultatet më të larta janë ato të nxënësve me mësim në gjuhën mësimore maqedonase (rezultati mesatar është 21,35, respektivisht 62,79 për qind), e pastaj vijojnë nxënësit që ndjekin mësim në gjuhën mësimore shqipe (rezultati mesatar është 17,15, respektivisht 50,46 për qind) dhe nxënësit e gjuhës mësimore turke (rezultati mesatar është 17,13, respektivisht 50,39 për qind).


1.2.2.1. Përgjigjet e nxënësve për detyra

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një përshkrim i shkurtër i kërkesave të secilës detyrë të testit.

Tabela 9: Përshkrimi i qëllimeve të matura me detyrat e testit

Numri i detyrës në test	Përshkrimi i qëllimit
1, 8, 14	Njohja e karakteristikave të kulturës dhe respekti ndaj dallimeve kulturore.
10, 15, 16	Respektimi i të drejtave për kulturën, religjionin dhe traditën tënde.
5, 6, 22, 24	Njohja e nocionit diskriminim, njohja e sjelljes diskriminuese dhe qëndrimet ndaj diskriminimit.
7, 11, 13, 18	Njohja dhe sjellja në situata ku ka stereotipa dhe paragjykime.
17, 19, 20, 21, 23	Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e njeriut.
2, 3, 4, 9, 12	Njohja, kuptimi dhe respektimi i dallimeve ndërmjet njerëzve (fetare, gjinore, sociale, kulturore) dhe njohja e kuptimi të tolerancës.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur përqindja e përgjigjeve të sakta, gjegjësisht zgjedhja e reagimit adekuat për secilën detyrë nga **të gjithë** nxënësit e testuar.



Grafiku 12: Rezultati i të gjithë nxënësve në testin e paraqitur për detyra

Përgjigje adekuate/të sakta të detyrave kanë zgjedhur 19% deri në 87% të nxënësve të testuar. Shumica e nxënësve (87%) e kanë ditur përgjigjen e detyrës 6, pastaj

të detyrës 7 (82% dhe të detyrës 24 (80%). Më së paku nxënës kanë dhënë përgjigje të saktë në detyrat 9 dhe 13 (rreth 25%) dhe në detyrën 17 (19%).

- ◆ Nëse analizohen për qytete, rezultatet për detyra të caktuara në test nuk dallohen ndjeshëm. E vetmja për rreth 10% përqindje më të lartë të zgjidhjes ka Strumica dhe kjo për detyrat 1, 3, 8, 11 dhe 14, por dallimi i të arriturave nuk vihet re në aspekt statistikor.
- ◆ Ka dallim në të arritura të nxënësve sipas gjuhës mësimore dhe kjo duket kështu:
 - Nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase janë dukshëm më të suksesshëm në detyrat 3, 8, 9, 14 dhe 23 në krahasim me nxënësit me mësim në gjuhën shqipe; dhe
 - Nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase janë dukshëm më të suksesshëm se nxënësit me mësim në gjuhën turke në detyrat 8, 10, 13, 19 dhe 22.

Në detyrat 13 dhe 22 nuk është përgjigjur drejt asnjë nxënës që ndjek mësim në gjuhën turke.

1.2.2.2. Shembuj të detyrave dhe të arriturave të nxënësve

Për ilustrim më poshtë janë dhënë tre detyra që kanë **zgjidhje më të paktë**, me përqindje të nxënësve që e kanë zgjedhur secilën nga përgjigjet e ofruara, kjo e shprehur **për qytete dhe për gjuhë mësimore** (detyrat 9, 13 dhe 17). Me shkronja të errësuara është përgjigjja e saktë. Shuma e përqindjeve është më e vogël se 100, kjo për shkak të përqindjes së nxënësve që nuk janë përgjigjur në pyetje. Sa për ilustrim është dhënë edhe detyra 4, e cila është karakteristike sipas përgjigjeve të nxënësve.

Detyra 9: Kuptimi i nocionit tolerancë

Çka do të thotë të jesh tolerant?	Shkup	Tetovë	Strumicë
1) T'i lëshojmë pe dikujt vetëm për arsye se ne jemi më të mençur.	29	18	33
2) Ta respektojmë të drejtën e të tjerëve që të jenë të ndryshëm nga ne.	28	26	20
3) Të mos u pengojmë të tjerëve dhe ata mos të na pengojnë.	25	29	34
4) Ta durojmë sjelljen e dikujt që është më i fortë se ne.	16	20	10
	Maqedonisht	Shqip	Turqisht
1) T'i lëshojmë pe dikujt vetëm për arsye se ne jemi më të mençur.	26	22	53
2) Ta respektojmë të drejtën e të tjerëve që të jenë të ndryshëm nga ne.	33	17	27
3) Të mos u pengojmë të tjerëve dhe ata mos të na pengojnë.	27	32	0
4) Ta durojmë sjelljen e dikujt që është më i fortë se ne.	13	21	20

- ◆ Në të gjitha nëngrupet (edhe për qytete edhe për gjuhë mësimore) më pak se 1/3 e nxënësve kanë dëshmuar se e dinë se çka është toleranca (përqindja më e lartë është e nxënësve me mësim në gjuhën maqedonase që janë përgjigjur drejt – 33%)
- ◆ Me mendimin se toleranca është “lëshim pe” pajtohen më shumë fëmijët e Strumicës – 33%, si dhe fëmijët me mësim në gjuhët turke – 53%.
- ◆ “Mospengesën” e ndërsjellë si përshkrim të nocionit tolerancë e kanë zgjedhur 34% nga nxënësit e Strumicës dhe 32% nga nxënësit me mësim në gjuhën shqipe. Është karakteristike se asnjë nxënës me mësim në gjuhën turke nuk e ka zgjedhur këtë përgjigje si adekuate (0%).

Detyra 13: Njohja e stereotipave

Një grup i fëmijëve flasin për njerëz të ndryshëm:

Ana: Myslimanët kanë nga dy e më shumë gra.

Bashkim: Romët janë muzikalë.

Emir: Të rinjtë janë agresivë.

Gjylistana: Maqedonasiti kanë histori të gjatë.

Cili fëmijë ka stereotipa? Përgjigjja – Gjylistana

Komuna/gjuha mësimore	Përqindja e përgjigjeve të sakta
Shkup	25
Tetovë	28
Strumicë	20
Gjuhë maqedonase	37
Gjuhë shqipe	13
Gjuhë turke	0

- ◆ Në secilin nëngrup më pak se një e treta e nxënësve vërejnë pohim në të cilin nuk ka (respektivisht ka) stereotipa. Ekziston mundësi e madhe që nxënësit të mos e kuptojnë këtë koncept.
- ◆ Për qytete – përgjigje të saktë kanë dhënë më së paku nxënësit e Strumicës, ndërsa për gjuhës mësimore – asnjëri nga pesëmbëdhjetë nxënësit e klasës së tetë, të cilët janë testuar në gjuhën mësimore turke nuk ka dhënë përgjigje të saktë.

Detyra 17. Kuptimi i lidhshmërisë së të drejtave dhe detyrimeve

Të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, kanë të dejtë të arsimit, por kanë edhe detyrim që të jenë të rregullt në shkollë dhe t'i respektojnë arsimtarët e tyre.

Çka mund të përfundohet nga ky pohim?

	Shkup	Tetovë	Strumicë
1) Ekziston lidhshmëri ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve.	15	19	33
2) Ekzistojnë rregulla në komunitet.	18	18	18
3) Arsimi është i detyrueshëm.	56	48	43
4) Ai që nuk i përmbush detyrimet nuk duhet të ketë të drejta.	6	8	5
	Maqedonisht	Shqip	Turqisht
1) Ekziston lidhshmëri ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve.	26	11	20
2) Ekzistojnë rregulla në komunitet.	19	17	20
3) Arsimi është i detyrueshëm.	45	59	33
4) Ai që nuk i përmbush detyrimet nuk duhet të ketë të drejta.	5	8	27

- ❖ Edhe në këtë pyetje më pak se 1/3 e të anketuarve, nga secili grup, kanë dhënë përgjigje të saktë.
- ❖ Përgjigjja më shumë e zgjedhur në secilin nëngrup është se “arsimi është i detyrueshëm” – që aspak nuk mund të nxirret si përfundim nga pohimi fillestar.

Detyra 4.

Detyra që është dhënë më poshtë është njëra nga detyrat e zgjedhura me më shumë sukses, në të cilën janë vërejtur shumë mënyra interesante të të menduarit të nxënësve të klasës së tetë. Ajo është detyrë me klasterë, me pesë pika dhe tri mundësi për zgjedhjen e secilës prej tyre. Për secilën pikë përqindja e mendimeve/qëndrimeve të zgjedhura, për të cilat konsiderojmë se janë adekuate, është më e lartë se 60%.

Një komunë ka nga 20 përqind të banorëve të cilët janë Maqedonas, Shqiptarë, Turq, Rom dhe Serb. Në komunën ka më shumë shkolla fillore, por asnjë nga shkollat nuk janë të përziera. **Në çfarë mënyre fëmijët nga kjo komunë do të been më të afërt dhe do të shoqërohen?**

	Po	Jo	Nuk e di
1) Të gjitha shkollat të bëhen multietnike dhe multikulturore (të përziera).	67	14	14
2) Të ketë shkolla të veçanta për Maqedonasit, kurse për të tjerët shkollat të jenë të përziera.	13	69	8
3) Të ketë shkolla të veçanta për Shqiptarët, kurse për të tjerët shkollat të jenë të përziera.	14	71	9
4) Të ketë festime të përbashkëta të të gjitha festive nacionale dhe fetare.	61	17	14
5) Të shpërngulen banorët e katër grupeve etnike, komuna të jetë vetëm me banorë të një etnikumi.	8	63	22

Thuaja 2/3 e nxënësve (edhe për qytete edhe për gjuhë mësimore) konsiderojnë se fëmijët në komunë multietnike më shumë do të afrohen mes vete nëse: të gjitha shkollat janë “të përziera”; nuk ka shkolla të veçanta për maqedonasit, respektivisht për shqiptarët, ndërsa për të tjerët të jenë të përziera; ka festime të përbashkëta të të gjitha festave nacionale dhe fetare; dhe nuk ka “shndërrim” të komunës multietnike në komunë të vetëm një etniteti.

- ◆ Përgjigjet e kësaj pyetje dëshmojnë se shumica e nxënësve janë të hapur për pranimin e “të tjerëve”.
- ◆ Nuk duhet të anashkalohet përqindja e nxënësve (ndërmjet 8% dhe 17%) që janë përcaktuar për qasje “izoluese” ndaj zgjidhjes së çështjes së afrimit multietnik.

Përfundim


- ◆ Nxënësit kanë qenë mesatarisht më të suksesshëm në zgjedhjen e përgjigjeve adekuata, respektivisht reagimeve ndaj pyetjeve të parashtruara. Në pyetjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me nocionet që mësohen deri në fund të klasës së shtatë, si për shembull: toleranca, të drejtat dhe detyrimet e njeriut, stereotipat, paragjykimet e të ngjashme, kjo e shprehur në disa raste, rezultatet – ashtu siç pritej – ishin dukshëm më të larta. Ndoshta mënyra e mësimin ndikon në nivelin e të kuptuarit të nxënësit.
- ◆ Ekzistojnë dallime të theksuara statistikore të suksesit të nxënësve në këto teste dhe sipas gjuhës mësimore. Kjo nënkupton që gjatë planifikimit dhe realizimit të trajnimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet që duhet të zbatohen me nxënësit, duhet të ketë pjesë të cilat do të jenë specifike për gjuhët e ndryshme mësimore.
- ◆ Marrë në përgjithësi, nxënësit shprehin se janë të hapur ndaj idesë për shkolla multietnike dhe aktivitete të përbashkëta ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike.

1.2.3. Content covered by the students

Detyrat e testeve përfshinin tema që janë përfshirë në lëndët e detyrueshme mësimore, me supozimin se nxënësit i kanë mësuar ato në mësimin e rregullt.

Në pyetësorin për nxënës me një pyetje e kemi kontrolluar se në cilën masë janë mësuar përmbajtjet që kanë të bëjnë me multikulturën, multietnicitetin, mosdiskriminimin e të ngjashme.

Në grafikun 13 janë paraqitur rezultatet e përgjigjeve të nxënësve të të dyja klasave.



Grafiku 13: Përmbajtje të mësuara deri në fund të klasës së tretë dhe deri në fund të klasës së shtatë

Përqindja më e madhe e nxënësve (edhe në klasën IV edhe në klasën VIII) kanë deklaruar se në shkollë kanë mësuar për të drejtat e fëmijëve (83%, respektivisht 75%). Po ashtu ka pasur përfaqësim edhe të përmbajtjeve që kanë të bëjnë me: ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet njerëzve, kulturën dhe traditat e grupeve të tjera etnike në Maqedoni, të drejtat e njeriut në Maqedoni, si dhe toleranca dhe bashkëjetesa (20% deri në 40%). Një përqindje e vogël e nxënësve (2%, përkatësisht 3%) pohojnë se nuk e kanë mësuar asnjë nga përmbajtjet në fjalë.

Këto përgjigje dëshmojnë se nxënësit nuk mund të kujtohen në përmbajtjet që janë mësuar – nuk kanë përvetësuar dituri më afatgjate ose nuk i kanë pranuar si përmbajtje që kanë të bëjnë me temat përkatëse. Sigurisht ndaj gjendjes së këtillë ka ndikim mënyra në të cilën nxënësit kanë mësuar dhe aktivitetet në të cilat ata kanë qenë të përfshirë.

Përfundim

- ◇ Sipas përgjigjeve të nxënësve për përmbajtjet që i kanë mësuar, madje edhe sipas të arriturave në disa detyra, mund të konstatohet se nevojitet ndryshim në mënyrën e realizimit të përmbajtjeve. Inkuadrimi i nxënësve në aktivitete, si: debate, diskutime, mini-projekte, do të ndihmojë për përvetësimin e diturive më afatgjata për nocionet dhe konceptet e mësuara, për njohjen dhe zbatimin e tyre.
- ◇ Për këtë nevojitet trajnim i arsimtarëve, duke pasur parasysh se shumica e tyre ndjehen pjesërisht të përgatitur për realizimin e përmbajtjeve të dhëna dhe për përdorimin e metodave përkatëse aktive.

1.3. MENDIME PËR SUKSESIN E REALIZIMIT TË ARSIMIT MULTIETNIK DHE MULTIKULTUROR

Njohuritë për atë se me çfarë sukcesi në shkolla realizohen aktivitete dhe përm-bajtje që janë relevante për arsimin multietnik dhe multikulturor, kemi mbledhur nga arsimtarët, drejtorët dhe punëtorët profesionalë.

Mënyrat e matjes

Mendimet e arsimtarëve për realizimin e arsimit multietnik dhe multikulturor janë hulumtuar përmes 8 pyetjeve të tipit të mbyllur, të cilat kishin të bëjnë me: 1. mendimet për mundësinë e zhvillimit të diturive dhe shkathtësive të nxënësve për bashkëpunimin ndëretnik dhe ndërkulturor përmes mësimit që ata e realizojnë (2 pyetje); 2. mendime për atë se sa do të jenë tolerantë nxënësit e shkollës së tyre për dallimet dhe sa do të jenë qytetarë lojalë (2 pyetje); 3. gatishmëria për punë dhe trajnim për arsim multietnik dhe multikulturor (4 pyetje).

Informacionet për përvojën në projekte dhe trajnime multietnike, si dhe interesi për to te drejtori/personat profesionalë janë hulumtuar me 2 pyetje të pyetësorit.

1.3.1. Sa mundëson realizimi i mësimit bashkëpunim ndëretnik dhe ndërkulturor

Arsimtarët e shprehin mendimin tyre për atë se sa u mundësohet atyre që përmes mësimit që e realizojnë në lëndën mësimore që e mbajnë ose duke qenë kujdestarë klasash, që te nxënësit të zhvillojnë qëndrime dhe dituri për bashkëpunimin ndëretnik dhe ndërkulturor.

Rreth një e treta e tyre mendojnë se atë mund ta bëjnë në masë të madhe edhe në lëndën mësimore që e mbajnë, por edhe si kujdestarë klasash, ndërsa më shumë se gjysma shprehin se në masë të konsiderueshme mund ta arrijnë atë. Relativisht i vogël është numri i arsimtarëve që mendojnë se janë të pakta gjasat ose nuk ekziston fare mundësi për zhvillimin e qëndrimeve dhe diturive për bashkëpunimin ndëretnik përmes mësimit. Kjo është e pritur kur kemi parasysh se arsimtarët që janë anketuar mbajnë mësim në lëndën *Arsimi qytetar* ose janë kujdestarë klasash dhe shumica e tyre tashmë kanë realizuar përmbytje të *Arsimit për shkathtësi jetësore*, të cilat në masë të madhe janë përmbytje për të drejtat, kuptimin e tjetrit e për zgjidhjen e konflikteve.

Tabela 10: Sa mundëson mësimi që e realizojnë zhvillim të diturive dhe shkathtësitë për bashkëpunimin ndëretnik dhe ndërkulturor


	Në lëndën mësimore		Kujdestar klase	
	Numri	%	Numri	%
Në masë të madhe	22	34.4	21	32.8
Në masë të konsiderueshme	33	51.6	36	56.3
Në masë të vogël	6	9.4	5	7.8
Nuk ka mundësi	2	3.1	0	0.0
Nuk janë përgjigjur	1	1.6	2	3.1
Gjithsej	64	100.0	64	100.0

- ◆ Nuk vërehen dallime të mëdha statistikore në përgjigjet e arsimtarëve që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme mësimore, si dhe mes arsimtarëve të komunave të ndryshme.

Perceptimi i arsimtarëve për atë se sa mendojnë ata se i arrijnë qëllimet themelore të arsimit ndëretnik dhe ndërkulturor, si: toleranca për njerëzit e përkatësisë tjetër kulturore dhe etnike, përgatitja për zgjidhjen e problemeve ndëretnike ndërmjet moshatarëve dhe lojaliteti qytetar e njohja e ndërsjellë, është hulumtuar përmes dy pyetjeve. Njëra kishte të bënte me nxënësit e gjuhës mësimore në të cilën ata mbajnë mësim, ndërsa tjetra kishte të bënte me nxënësit që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore.

Arsimtarët vlerësonin se sa arrihen qëllimet e dhëna të nxënësit që mësojnë në gjuhën mësimore që ata e ligjërojnë dhe të nxënësit që mësojnë në gjuhë të tjera mësimore.

Në grafikun më poshtë janë dhënë përgjigjet e tyre. Aty vërehet se arsimtarët konsiderojnë se shumica e qëllimeve do të jenë në masë të madhe ose kryesisht të arritura të nxënësit e tyre deri në fund të shkollës fillore. Përveç kësaj, ekziston edhe një prirje që të vlerësohet se a do të jenë tolerantë ndaj të tjerëve nxënësit që mësojnë në gjuhën mësimore në të cilën ata mbajnë mësim, pra a do të jenë më të përgatitur që t'i zgjidhin problemet ndëretnike dhe në masë më madhe patriotë dhe qytetarë lojalë, si dhe fakti që një numër i madh i arsimtarëve nuk kanë mundur të vlerësojnë se sa nxënësit që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore do të jenë tolerantë dhe lojalë. Kjo mund të jetë si pasojë e njohjes së pamjaftueshme të asaj që ndodhë në mësimin e gjuhëve të tjera mësimore ose për shkak të shmangies së përgjigjes. Këto përgjigje mund të jenë shenjë edhe për ekzistimin e dyshimeve në lidhje me efektet e arsimit multietnik të tjerët.



Grafiku 14: Sa do të jenë tolerantë ndaj dallimeve dhe sa do të jenë qytetarë lojalë nxënësit që mësojnë në gjuhën e tyre mësimore dhe ata që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore

Marrë në përgjithësi, një numër i madh i arsimtarëve që mbajnë mësim në gjuhën mësimore shqipe në raport me ata që mbajnë mësim në gjuhën maqedonase, konsiderojnë se edhe nxënësit të cilëve ata u mbajnë mësim, por edhe nxënësit e gjuhëve të tjera mësimore, do t'i arrijnë qëllimet e parashtruara.


1.3.2. Trajnimi i kuadrit edukativo-arsimor për realizimin e arsimit multietnik dhe multikulturor

Që të mblidhen të dhëna për atë se sa ndjehen arsimtarët, drejtorët dhe punëtorët profesionalë të shkollave të përfshira në projekt të gatshëm për punë në mjedise të përziera etnike dhe a kanë ndjekur dhe, nëse po, çfarë trajnimesh kanë ndjekur për zhvillimin e bashkëpunimit ndëretnik, atyre u ishin parashtruar pyetje në lidhje me këtë problematikë.

Diçka më shumë se një e katërta e të anketuarve janë përgjigjur se gjatë studimeve ata kanë qenë të gatshëm për punë në mjedise të përziera etnike. Po ashtu po aq arsimtarë janë përgjigjur se pjesërisht kanë qenë të përgatitur. Secili arsimtar i tretë në arsimin në deridiplomik nuk është i gatshëm për punë në mjedise të përziera etnike. Arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhën mësimore shqipe dhe turke dukshëm më shumë se arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhën maqedonase konsiderojnë se studimet i kanë përgatitur për punë në mjedise të përziera etnike.

- ◆ Nuk ka dallime në përgjigjet e arsimtarëve të komunave të ndryshme.

Në grafikun 15 janë prezantuar të dhënat e përgatitjes së arsimtarëve që të punojnë në mjedise multietnike.



Grafiku 15: A janë përgatitur gjatë studimeve për punë në mjedise të përziera etnike arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme mësimore


Shkollat e projektit janë etnikisht të përziera, ndërsa në shumicën e tyre edhe më parë janë realizuar projekte dhe arsimtarët kanë qenë të përfshirë në trajnime për punë në mjedise të tilla. Megjithatë, sipas përgjigjeve të arsimtarëve të ekzemplarit, është dëshmuar se vetëm rreth një e treta kanë ndjekur trajnime dhe kanë përvojë në projekte për bashkëpunim ndëretnik. Nuk ka dallime në përgjigjet e kësaj pyetje të arsimtarëve të gjuhëve të ndryshme mësimore dhe në komunat e ndryshme.

Tabela 11: A kanë ndjekur trajnime për zhvillimin e bashkëpunimit ndëretnik

Pjesëmarrja	Numri	%
Po	23	35.9
Jo	38	59.4
Nuk janë përgjigjur	3	4.7
Gjithsej	64	100.0

Duke i pasur parasysh përgjigjet e pyetjeve të mëparshme, që flasin se numri më i madh i arsimtarëve të anketuar formalisht (në fakultet ose nëpër trajnime të thelluara) nuk janë përgatitur për arsim multietnik, është interesante se në pyetjen: “Marrë në përgjithësi, a ndjeheni ju personalisht të përgatitur për të realizuar përmbajtje për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik?”, thuajse të gjithë janë përgjigjur se ndjehen të përgatitur ose pjesërisht të përgatitur – shih grafikun më poshtë).

Me këtë rast shumica e arsimtarëve që realizojnë mësim në gjuhën maqedonase ndjehen të përgatitur. Përgjigjet e këtilla mund të jenë si pasojë e përvojës që e kanë në punën e shkollave të përziera etnike.



Grafiku 16: A ndjehen të përgatitur arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme mësimore që të realizojnë përmbajtje për bashkëpunim ndëretnik

Arsimtarët ishin pyetur edhe për interesin e tyre për praninë e trajnimeve dhe pjesëmarrjen e tyre në projekte për bashkëpunim ndëretnik. Pak më shumë se gjysma e arsimtarëve janë të interesuar edhe për trajnime edhe për pjesëmarrje në projekte për bashkëpunim ndëretnik, ndërsa një e treta do të vendosnin për atë varësisht nga përmbajtjet. Arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhën mësimore maqedonase në masë të madhe pa asnjë kusht janë të interesuar për trajnime dhe projekte, ndërsa arsimtarët që mbajnë mësim në gjuhën shqipe më shumë do të përcaktoheshin varësisht nga përmbajtjet.

- ◇ Nuk vërehen dallime në interesin e pjesëmarrjes në trajnime të arsimtarëve të qyteteve të ndryshme.

Tabela 12: Interesi i arsimtarëve për pjesëmarrje në trajnime dhe projekte

Interesi për pjesëmarrje	Numri	%
Po	33	51,6
Jo	7	10,9
Varësisht nga përmbajtjet	21	32,8
Nuk janë përgjigjur	3	4,7
Gjithsej	64	100,0

Thuajse të gjithë (13 nga 15) drejtorët dhe bashkëpunëtorë profesionalë deri tash kanë ndjekur trajnime ose kanë marrë pjesë në projekte për zhvillimin e bashkëpunim ndëretnik dhe janë të interesuar për të ndjekur trajnime dhe për të punuar në projekte të tilla (14 nga 15 të anketuar).

Përfundim

- ◇ Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollave të përfshira në projekt kanë ndjekur trajnime dhe përvojë me projekte për zhvillimin e bashkëpunimit multietnik dhe janë të interesuar edhe në të ardhmen të punojnë në projekte të tilla.
- ◇ Pjesa më e madhe e arsimtarëve gjatë studimeve nuk janë përgatitur fare ose janë përgatitur vetëm pjesërisht për punë në mjedise të përziera etnike. Po ashtu shumica e tyre nuk kanë ndjekur trajnime plotësuese e as nuk kanë marrë pjesë në projekte për bashkëpunim ndëretnik. Gjysma e arsimtarëve ndjehen të papërgatitur ose pjesërisht të përgatitur për të realizuar përmbajtje për bashkëpunimin ndëretnik dhe diçka më shumë se gjysma janë të interesuar për trajnime dhe punë në projekte për bashkëpunim ndëretnik. Kjo flet për nevojën dhe interesin e arsimtarëve për këso lloj trajnimesh dhe projektesh.
- ◇ Nga ana tjetër, arsimtarët janë mjaft optimistë në efektet e pritura ndaj nxënësve të shkollave të tyre. Shumica e tyre konsiderojnë se nxënësit e tyre do të jetë tolerantë, të gatshëm për të zgjidhur konflikte etnike dhe qytetarë lokalë të shtetit. Ato vlerësime në masë të madhe kanë të bëjnë me nxënësit e gjuhës mësimore në të cilën ata mbajnë mësim, ndërsa më pak për ata që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore. Ky “optimizëm pedagogjik” është i pritur dhe duhet të mbahet llogari që të shfrytëzohet në planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.

2. KOMUNIKIMI DHE INTEGRIMI MULTIETNIK NË SHKOLLA

Për planifikimin e aktiviteteve të projektit e rëndësishme konsiderohej ajo se si është e organizuar tash puna në aspekt të mundësisë për arsim multietnik dhe si të gjithë që janë të përfshirë në procesin edukativo-arsimor e perceptojnë komunikimin dhe integrimin ndëretnik në shkollat e tyre. Për këtë qëllimin janë analizuar programet e punës së shkollave të përfshira në projekt për vitin 2011/2012 dhe në pyetësorët për drejtorë dhe bashkëpunëtorë profesionale, arsimtarë, nxënës dhe prindër dhe aty janë përfshirë pyetje që kanë të bëjnë me këtë perceptim.

2.1. ORGANIZIMI I PUNËS NË SHKOLLA DHE MENDIMI PËR TË

2.1.1. Arsimi multietnik në programet vjetore për punë në shkolla

Programet vjetore për punë janë dokumente zyrtare që i përcaktojnë përparësitë dhe organizimin e punës së shkollës. Për këtë janë analizuar programet e punës së shkollave të përfshira në projekt gjatë vitit shkollor 2012/2012.

◆ Politika shkollore për arsimin multietnik

Të gjitha 6 shkollat kanë mësim në dy ose tre gjuhë mësimore, por vetëm në misionin e një shkolle të Strumicës është i shprehur qartë përcaktimi për multietnicitet, si “...kultivohet mirëkuptimi dhe respekti multientik i kulturave të më shumë bashkësive që janë të pranishme në shkollë”.

Në të gjitha shkollat janë planifikuar aktivitete të caktuara për arsim multietnik:

- ◆ Në tre shkolla edhe në vitin e kaluar janë realizuar projekte që kanë të bëjnë me arsimin multietnik, siç janë *Shkolla mike për fëmijë*, në kuadër të së cilës janë zhvilluar edhe punëtori për multikulturë, dhe *Arsimi dygjuhësor i integruar*, ndërsa është planifikuar që ato të vazhdojnë edhe në vitin vijues.
- ◆ Në programin e një shkolle një nga përparësitë është “... kultivimi dhe përparimi i multikulturalizmit në shkollë”.
- ◆ Në programin e një shkolle tjetër është planifikuar: “*inicimi i aktiviteteve për zhvillimin komunikimit cilësor ndëretnik të të gjitha subjekteve në procesin edukativo-arsimor*”, ndërsa në pjesën e Klimës shkollore planifikohet zhvillimi i: “*respektit dhe besimit të ndërsjellë; zgjidhje konstruktive e konflikteve; hapje dhe komunikim shumëpalësh; aktivitete të përbashkëta ndërmjet arsimtarëve dhe nxënësve që mësojnë në gjuhë mësimore maqedonase dhe shqipe për përmirësimin e komunikimit dhe tolerancës ndëretnike; marrëdhënie demokratike ndërmjet arsimtarëve, nxënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë*”.

- ◆ Në programin e një shkolle janë planifikuar aktivitete për fuqizimin e punës me nxënës dhe prindër për rritjen e përfshirjes dhe përfundimin e shkollës fillore të pjesëtarëve të bashkësisë turke, por në mënyrë eksplicite nuk janë theksuar aktivitetet që do të nënkuptojnë edhe fuqizimin e integritetit etnik.

Në të gjitha shkollat në pjesën e Kujdesit për shëndetin në pjesën Përparimi i shëndetit mendor qëndron se do të punohet në: zhvillimin e vetëbesimit; vetërespektit; komunikimit dhe **mirëkuptimit e pranimit të të tjerëve**. Por, duke e pasur parasysh se ajo që është punuar nuk mund të shihet gjithnjë përmes programeve të detajuara të punës së drejtorëve, bashkëpunëtorëve profesionale, aktivëve, aktiviteteve të lira të nxënësve etj. duket se te një pjesë e shkollave kjo është marrë formalisht nga dokumentet programore në nivel shtetëror, ndërsa në një shkollë kjo është vendosur me besnikëri në pjesët përkatëse të programit.

◆ Mësimi

Në 4 prej 6 shkollave mësimi në të gjitha gjuhët mësimore është i organizuar në dy ndërrime që nuk janë ndarë në bazë të gjuhëve mësimore, por për nga moshë e nxënësve (mësim klasor dhe lëndor). Organizimi i tillë mundëson komunikim të të gjithë nxënësve të moshave të caktuara. Në shkollën “Marshall Tito” të Murtinos nxënësit e mësimit klasor në gjuhën turke dhe në gjuhën maqedonase në shkollën periferike në f. Bansko mësojnë në ndërrime të ndara, ndërsa në mësimin lëndor të gjithë nxënësit vazhdojnë në gjuhën maqedonase, që do të thotë se ekziston mundësi për arsim multietnik në kuadër të paraleleve të njëjta, por nuk është siguruar e drejta e nxënësve për mësim në gjuhën amtare. Shkaku i kësaj është numri i paktë i nxënësve. Në shkollën “Bratsvo Migjeni” në Tetovë, ku mësimi zhvillohet në tre gjuhë mësimore, nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase janë të ndarë në ndërtesë të veçantë, ndërsa mësimi në dy gjuhët e tjera mësimore zhvillohet në ndërrime të përziera etnike.

Gjendja e këtillë në fakt mundëson që të provohen modelet e ndryshme të arsimit multietnik, që është një rrethanë lehtësuese për zhvillimin e mëtejshëm të projektit.

Nga programet mund të shihet se si planifikohet që përmes mësimit të realizohen përcaktimet për arsim multietnik dhe multikulturor (mbase edhe për shkak se nuk janë dorëzuar të gjitha aneks-programet – nëse janë përgatitur). Aty nuk është planifikuar mësimi zgjedhor ose fakultativ për mësimin e gjuhës së bashkësive të tjera etnike, përveç në shkollën “Bratsvo Migjeni” në Tetovë, ku për nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase të klasës VIII planifikohet mësimi i gjuhës shqipe.

Në shkollën “Zhivko Brajkovski” në pjesën Inovacione është planifikuar *“Realizim i orëve të përbashkëta të hapura me nxënës të bashkësive të ndryshme etnike...”*

◆ Aktivitetet jashtëmësimore

Në pjesën e programeve vjetore për aktivitete jashtëmësimore (aktivitete të lira në nxënësve, festa, shfaqje, ekskursionet) zakonisht nuk mund të vërehet se sa mbahet

llogari për integrimin multietnik. Në disa programe te festat religjioze janë përmendur vetëm festat ortodokse, ndërsa në programet e ekskursioneve rëndom nuk përmenden vendet e kulturës islame. Por, ka edhe shembuj të mirë, si p.sh.: ndërlidhja e festave religjioze ortodokse dhe myslimane në mësimin klasor në një shkollë: “*krijimi i ndjenjës së patriotizmit, tolerancës, bashkëjetesës dhe zhvillimit të marrëdhënies pozitive ndaj vlerave nacionale, kulturore dhe estetike*” ose përmes “*ekskursioneve të përbashkëta*” ose në “*krijimin e kulturës së promovimit të pasurisë folklorike...*” në aktivitetet jashtëmësimore në dy shkolla të tjera.

2.1.2. Mendime për ndërrimet e ndara etnike në shkolla

Në lidhje me mundësinë për rritjen e komunikimit dhe integrimin multietnik, kemi mbledhur mendime për organizimin e punës në të a.q. ndërrime etnike.


◆ **Mendimet e arsimtarëve, drejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë**

Arsimtarë janë të ndarë në raport me mbështetjen e praktikës që nxënësit të mësojnë në ndërrime të ndara etnike (45% plotësisht ose pjesërisht i mbështesin, ndërsa 47% pjesërisht ose aspak nuk i mbështesin). Argumentet më të shpeshta të atyre që e mbështesin mësimin në ndërrime të ndara etnike është se ashtu pakësohen incidentet ndërmjet nxënësve dhe ata mund të shoqërohen me nxënës të ngjashëm me vetë ata. Kjo flet për krijimin e linjës së rezistencës më të vogël në pengimin e incidenteve potenciale dhe mbylljen në kuadër të bashkësisë etnike.

Shumica e drejtorëve/bashkëpunëtorëve, 10 nga gjithsej 15, aspak nuk e mbështesin këtë praktikë, dy e mbështesin plotësisht, dy pjesërisht, ndërsa njëri nuk ka qëndrim. Shkak për atë qëndrim, ashtu si te arsimtarët, është se “me atë pakësohen incidentet ndërmjet nxënësve”.


Mbështetja e madhe e kuadrit edukativo-arsimor në ndarjen e nxënësve në gjuhë mësimore në fakt janë rrethanat e pavoritshme për zhvillimin e arsimit multietnik.

Arsimtarët e Shkupit, në krahasim me arsimtarët e Tetovës dhe Strumicës, dukshëm më pak **nuk e mbështesin** praktikën për organizimin në ndërrime sipas gjuhëve mësimore.



Grafiku 17: Sa i mbështesin arsimtarët e qyteteve të ndryshme ndërrimet etnike në shkolla

Arsimtarët me mësim në gjuhën mësimore maqedonase, në krahasim me arsimtarët me mësim në gjuhë mësimore shqipe dhe turke, dukshëm më shumë **nuk e mbështesin** mësimin në ndërrime të ndara etnike.




Grafiku 18: Sa i mbështesin arsimtarët e gjuhëve të ndryshme mësimore ndërrimet etnike në shkolla

Arsimtarët dhe drejtorët që nuk e mbështesin ndarjen në ndërrime të pastra etnike ishin pyetur në lidhje me mënyrën e shfrytëzimit të klasave. Gjysma edhe e njërit edhe e grupit tjetër konsiderojnë se në klasa të njëjta në të dyja ndërrimet duhet të mësojnë nxënës të një gjuhe mësimore. Pikëpamja e tillë po ashtu e pakëson mundësinë për interaksion me të tjerët përmes materialeve të ekspozuara, kujdesit të përbashkët për klasën etj.

◆ **Mendimet e prindërve dhe nxënësve**

Prindërit në masë të madhe e mbështesin organizimin e mësimit në ndërrime të pastra etnike (67% e mbështesin plotësisht ose pjesërisht). Prindërit, fëmijët e të cilëve mësojnë në gjuhën turke, e mbështesin mësimin në ndërrime të pastra etnike shumë më tepër se prindërit e fëmijëve që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe shqipe.



Grafiku 19: Sa i mbështesin prindërit e gjuhëve të ndryshme mësimore ndërrimet etnike në shkolla

Përgjigjet e prindërve të fëmijëve që mësojnë në shkolla të ndryshme dukshëm dallohen në shkallën e mbështetjes së mësimin në ndërrime të ndara etnike.


Shkaku më i shpeshtë i mbështetjes së mësimin të ndarë etnik është se ashtu pakësohen incidentet ndërmjet nxënësve (40% nga prindërit). Një numër më i vogël tyre si shkak e përmendin mundësinë e fëmijëve që të shoqërohen me të ngjashëm si ata (29% prindër) dhe mundësinë që të kuptohen më mirë, për shkak se e flasin gjuhën e njëjtë (24% prindër).

◆ Mendimet e nxënësve

Në pyetjen se në çfarë ndërrimi do të kishin dashur të mësojnë nxënësit që ndjekin mësim në gjuhë tjetër mësimore, nxënësit janë përgjigjur se:

- ◆ E kam njësoj – 44% e nxënësve të klasës së katërt dhe 54% të nxënësve të klasës së tetë;
- ◆ Dëshiroj të mësoj në ndërrim të njëjtë – 28% e nxënësve të klasës së katërt dhe 23% e nxënësve të klasës së tetë; dhe
- ◆ Dëshiroj të mësoj në ndërrim të ndryshëm – 22% e fëmijëve të klasës së katërt dhe 19% e nxënësve të klasës së tetë.

Nëse merren parasysh përqindjet e nxënësve që deklarojnë se e kanë njësoj dhe ata që do të dëshironin të mësojnë në ndërrim të njëjtë, mund të konstatohet se **më shumë se 70% e nxënësve kanë qëndrim pozitiv** ndaj ndjekjes së përbashkët të mësimin në shkollë.



Grafiku 20: Përgjigjet e nxënësve për mënyrën e organizimit të mësimin

2.1.3. Interesi për mësim në gjuhën e bashkësive të tjera etnike

Njëra nga vështirësitë për integrim më të mirë etnik në Maqedoni është edhe njohja e pamjaftueshme e gjuhës, si e gjuhës maqedonase nga bashkësitë e tjera etnike, ashtu edhe e gjuhëve të bashkësive të tjera etnike nga pjesëtarët e bashkësisë etnike maqedonase.

Sipas zgjidhjeve konceptuale dhe planeve mësimore, nxënësit me mësim në gjuhë mësimore të ndryshme nga gjuha maqedonase kanë mundësi ta mësojnë gjuhën maqedonase në klasën IV. Ashtu është edhe në praktikë – asnjë shkollë nuk mundëson që mësimi i gjuhës tjetër të fillojë më herët. Nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase, serbe dhe turke mund ta zgjedhin ta mësojnë gjuhën shqipe që nga klasa VI, por kjo mundësi praktikisht shumë rrallë shfrytëzohet.


Nxënësit, prindërit dhe arsimtarët ishin pyetur edhe në lidhje me interesin për mësimin e gjuhëve të bashkësive të tjera etnike.

◆ **Interesi i nxënësve për mësimin e gjuhës së bashkësisë tjetër etnike**

Rreth 57% e nxënësve të klasës së katërt dhe 58% të nxënësve të klasës së tetë do të dëshironin që në shkollë të mësojnë në gjuhë tjetër nga gjuha amtare. Përqindja më e madhe e nxënësve do të dëshironin që edhe në klasën e katërt edhe në tetën ta mësojnë gjuhën turke.

Se nuk dëshirojnë të mësojnë gjuhë tjetër që dallohet nga gjuha amtare, që gjendet në mjedisin lokal, janë përgjigjur 12% nxënës të klasës së katërt dhe 9% të klasës së tetë, ndërsa nxënësit e tjerë janë përgjigjur me “nuk e di”.

Nga kjo mund të konstatohet se **numri më i madh i nxënësve kanë qëndrim pozitiv ndaj mësimin të gjuhës tjetër nga gjuha amtare dhe ai numër rritet me moshë.**




Grafiku 21: Interesi⁶ i nxënësve për mësimin e gjuhës tjetër nga gjuha amtare

◆ **Interesi prindërve që fëmija i tyre të mësojë gjuhë të bashkësive tjetër etnike**

Diçka më pak se gjysma e prindërve (44%) kanë deklaruar se janë të informuar nga shkolla për mundësinë që fëmija i tyre ta mësojë gjuhën e bashkësive të tjera etnike që jetojnë në Maqedoni.

Një e katërta e prindërve sigurisht do ta këshillonin fëmijën e tyre të mësojë gjuhë të bashkësive tjetër etnike – nëse ekziston një mundësi e tillë në shkollë, gjysma mbase do ta kishin këshilluar të veprojnë ashtu, ndërsa të tjerët nuk do ta këshillonin.

⁶ Pyetja për atë se cilën gjuhë do të kishit dashur ta mësoni ishte e hapur dhe prandaj një pjesë e nxënësve që mësojnë në gjuhë të tjerë mësimore e kanë shënuar gjuhën maqedonase, të cilën në fakt e kanë lëndë të detyrueshme.



Grafiku 22: Qëndrimi i prindërve për mësimin e gjuhës së ndryshme nga gjuha amtare

Shumica e prindërve (40%) do ta këshillonin fëmijën e tyre që ta mësojnë gjuhën turke, ndërsa pak më i vogël është numri (29%) i atyre që do ta këshillonin ta mësojë gjuhën shqipe. Të tjerët do ta këshillonin ta mësojë ndonjë gjuhë tjetër.

Shumica e prindërve, që nuk do ta këshillonin fëmijën e tyre të mësojë gjuhën e ndonjë bashkësie tjetër etnike, konsiderojnë se kjo do ta ngarkonte fëmijën e tyre ose se fëmija i tyre nuk do të dëshirojë të mësojë gjuhë tjetër.

Sipas përgjigjeve të prindërve, mund të përfundohet se ata kanë qëndrim më pozitiv ndaj mëimit të gjuhëve të bashkësive të tjera etnike dhe do t'i këshillonin fëmijët e tyre ta mësojnë ndonjërin prej tyre.

◆ **Vlerësimi i arsimtarëve për interesin e mëimit të gjuhës shqipe**

Duke pasur parasysh faktin se, sipas dokumenteve konceptuale, nxënësve me mësim në gjuhë të tjera mësimore u mundësohet vetëm mësimi i gjuhës shqipe, i lutëm arsimtarët të vlerësojnë se sa do të ishte përqindja e arsimtarëve dhe e nxënësve që do të dëshironin të mësojnë në gjuhën shqipe – nëse në shkollën e tyre do të kishte mundësi për mësim falas të kësaj gjuhe.

Nga gjithsej 64 të anketuar, 50 arsimtarët janë përgjigjur në këtë pyetje: 10 prej tyre mendojnë se përqindja e nxënësve të interesuar do të ishte nën 10%, por 22 arsimtarët mendojnë se ai numër do të ishte 50% të nxënësve ose edhe më shumë.

Kur bëhet fjalë për vlerësimet për interesin e arsimtarëve për mësimin e gjuhës shqipe, nga gjithsej 64 të anketuar, u përgjigjën 48 sosh. Me këtë rast 14 prej tyre mendojnë se 10% ose më pak arsimtarë do të dëshironin ta mësojnë gjuhën shqipe, por 23% vlerësuan se gjysma ose më shumë se ai numër i kolegëve të tyre do të dëshironin ta mësojnë gjuhën shqipe.

Arsimtarët po ashtu vlerësuan se, nëse ekziston, mundësi e volitshme, një numër i madh i tyre dhe i nxënësve të tyre do të dëshironin ta mësojnë gjuhën shqipe.

Përfundim

- ◊ Në të gjitha shkollat e përfshira në projekt janë planifikuar angazhime dhe/ose aktivitete për arsimin multietnik, por kjo zakonisht nuk mjafton dhe nuk i përfshin të gjitha mundësitë për realizimin e tij. Në shkolla ekzistojnë modele të ndryshme të organizimit të mësimit sipas gjuhëve mësimore. Gjendja e tillë është një bazë e mirë për zbatimin e qasjeve të ndryshme për arsimin multietnik.
- ◊ Shumica e nxënësve janë të hapur për të mësuar në ndërrim të njëjtë me fëmijë të përkatësisë tjetër etnike (ose dëshirojnë të mësojnë me të tjerë ose e kanë krejt njësoj), si edhe për të mësuar gjuhën e bashkësive të tjera etnike.
- ◊ Arsimitarët janë të ndarë në aspekt të mbështetjes së ekzistimit të të a.q. ndërrime etnike, ndërsa shumica e drejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë nuk e mbështesin organizimin në ndërrime të pastra etnike.
- ◊ Pjesa më e madhe e prindërve e mbështesin organizimin e mësimit në ndërrime të pastra etnike, por do t'i këshillonin fëmijët e tyre që ta mësojnë gjuhën e bashkësisë tjetër etnike.
- ◊ E dhëna se nxënësit janë shumë të ngarkuar në krahasim me arsimtarët dhe prindërit ndaj nxënësve që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore është një tregues i mirë i cili duhet të shfrytëzohet në projekt duke iu referuar motos për “krijimin e shkollës mike për fëmijë”.

2.2. PERCEPTIMI I FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË KOMUNIKIMIN MULTIETNIK

Praktika e komunikimit multietnik në shkolla dhe mendimet e arsimtarëve, drejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë për ndikimin e faktorëve të ndryshëm ndaj marrëdhënieve ndëretnike, duhet të jetë një bazë e mirë për planifikimin e aktiviteteve të projektit. Prandaj ato çështje ishin pjesë e këtij hulumtimi.

Mënyrat e matjes


Në pyetësin për arsimtarë kishte 10 pyetje, ndërsa në pyetësin për drejtorë dhe bashkëpunëtorë profesionalë kishte 8 pyetje për organizimin e punës edukativo-arsimore në aspekt të mundësive për komunikim dhe integrim.

Pyetjet kishin të bëjnë me praktikën e organizimit të aktiviteteve në grupe të përziera etnike, me mendimet e faktorëve për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe për mundësinë e përmirësimit të tyre.

2.2.1. Aktivitetet e përbashkëta të arsimtarëve dhe nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore

Aktivitetet e përbashkëta të arsimtarëve janë hapi i parë drejt arsimit të integruar.

Sipas përgjigjeve të shumicës së arsimtarëve, aktivitetet formale (mbledhjet e këshillit të arsimtarëve, të aktivëve profesionalë dhe trajnimet e shkollës) zhvillohen bashkërisht, ndërsa vetëm gjysma e arsimtarëve janë përgjigjur se punojnë bashkërisht me seksione. Ndonëse pritet që pyetja të ketë lidhje me gjendjen faktike, megjithatë ka dallime në përgjigjet e arsimtarëve të shkollës së njëjtë. Ato janë shumë të shpeshta në shkollat në të cilat numri i nxënësve me mësim në gjuhën shqipe është më i madh. Megjithatë, përgjigjet nuk varen nga gjuha mësimore në të cilën mbahet mësimi. Kjo flet edhe praktikën jokonsistente të punës së përbashkët të arsimtarëve: disa arsimtarë praktikën e bashkëpunimit të përkohshëm ose të rrallë e kanë shënuar si diçka që nuk ekziston në shkollë, ndërsa disa të tjerë konsiderojnë se ato janë paraqitje incidentale, e jo një praktikë e rregullt.



Grafiku 23: Aktivitetet e arsimtarëve që zhvillohen në grupe të përziera etnike

Praktika e këtillë i pakëson mundësitë e arsimtarëve që t'i njohin kolegët që mbanjnë mësim në gjuhë të tjera mësimore, edhe pse 70% e arsimtarëve janë përgjigjur se i njohin mirë shumicën e kolegëve që mbajnë mësim në gjuhë të tjera mësimore.

Drejtorët dhe, deri diku, edhe bashkëpunëtorët profesionalë, e organizojnë punën e organeve dhe trupave profesionale, ndërsa në masë të madhe ndikojnë edhe në organizimin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe jashtëshkollore. Prandaj prej tyre ishte kërkuar mendim për atë se a mund të kontribuojnë aktivitetet e sipërpërmendura për marrëdhënie më të mira ndëretnike. Të gjithë 15 drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë mendojnë se mbledhjet e këshillave të arsimtarëve, aktivëve profesionalë dhe shfaqjet e festat, mund të kontribuojnë, 14 mendojnë se garat, trajnimet shkollore dhe udhëtimet e përbashkëta të arsimtarëve mund të kontribuojnë, ndërsa 12 prej tyre mendojnë se edhe puna me seksione mund të kontribuojë për bashkëpunimin ndëretnik.

Duke i pasur parasysh përgjigjet e këtilla, duhet të kërkojmë shkaqe konkrete se pse në praktikë këto aktivitete nuk zhvillohen bashkë me arsimtarët e të gjitha gjuhëve mësimore.

Aktivitetet e përbashkëta të nxënësve janë hapi i patjetërsueshëm në sigurimin e kushteve për arsim të integruar ndëretnik. Drejtorët, bashkëpunëtorët profesionalë dhe arsimtarët kanë dhënë përgjigje jokonsistente në pyetjen: *Cilat aktivitete me nxënës në shkollë zhvillohen bashkërisht për nxënësit që ndjekin mësim në gjuhë të ndryshme mësimore?* Jokonsistenca e përgjigjeve mund të jetë për arsye ose të dëshirës së disa të anketuarve që ta paraqesin si më pozitive praktikën e shkollës ose ndoshta nga prirja që disa praktika incidentale të vlerësohen si diçka që ekziston në shkollë, ndërsa disa si diçka që nuk ekziston.

Në bazë të përgjigjeve, si dhe në bazë të analizës së programeve vjetore për punën në vitin 2011/2012, me siguri të madhe mund të përfundohet se në të gjitha shkollat realizohen aktivitete jashtëshkollore (ekskursione, mësim në natyrë, aktivitete shoqërore) dhe aktivitete sportive. Në gjysmën e shkollave organizohen bashkë edhe aktivitete kulturore-artistike. Nga programet e punës së shkollave, shihet se në disa prej tyre kjo **nuk është** praktikë e rregullt.


Aktivitetet mësimore (zgjedhore, shtuese dhe plotësuese) vetëm në disa shkolla, madje edhe aty rrallë, zhvillohen në grupe të përziera etnike. Kjo është e kuptueshme edhe për shkakun se është më vështirë të organizohen dhe realizohen, por duke e pasur parasysh se bëhet fjalë për shkolla që kanë dëshirë të punojnë në arsimin multietnik dhe tashmë kanë pasur iniciativë, pritjet që shumica e aktiviteteve të nxënësve të zhvillohen në grupe të përziera etnike.

Më shumë se gjysma e prindërve janë përgjigjur se në shkolla ose nuk ka ose nuk e dinë se ka aktivitete të përbashkëta për fëmijët me përkatësi të ndryshme etnike.

2.2.2. Mendime për mundësitë e krijimit të bashkëpunimit multietnik në shkollë

Përkundër praktikës vijuese në të cilën nuk ka shumë aktivitete të përbashkëta të nxënësve, arsimtarët, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë kanë pikëpamje shumë më optimiste për mundësitë e ndërtimit të bashkëpunimit ndëretnik përmes aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore në shkollë.


Mes 70% e 90% të arsimtarëve konsiderojnë se të gjitha aktivitetet mësimore, jashtëmësimore dhe jashtëshkollore japin mundësi të plotë ose të pjesshme në ndërtimin e bashkëpunimit ndëretnik. Më shumë mundësi shohin në aktivitetet jashtëmësimore dhe jashtëshkollore sesa në aktivitetet mësimore. Trendi i përgjigjeve të drejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë po ashtu është i ngjashëm, me faktin se ata për secilin aktivitet janë “më optimistë”, madje në masë të madhe, për dallim prej arsimtarëve që shohin në to mundësi të sigurt për të kontribuar në marrëdhëniet ndëretnike.



Grafiku 24: Sa mund të kontribuojnë aktivitetet e ndryshme për marrëdhënie të mira ndëretnike

Njëra nga çështjet që shpesh parashtrohet në lidhje me organizimin e hapësirës kur nxënësit me mësim në gjuhë të ndryshme mësimore mësojnë në ndërrim të njëjtë është sesi të organizohet shfrytëzimi i klasave kur mësohet në dy ndërrime: mësonjë-tore të njëjta të shfrytëzojnë nxënësit e të dyja gjuhëve mësimore ose të gjuhës së njëjtë mësimore. Mendimet e arsimtarëve në lidhje me këtë janë të ndara.

Gjysma e prindërve mendojnë se fëmija i tyre vetëm pjesërisht e njej traditën dhe kulturën e bashkësive të tjera etnike në Maqedoni, ndërsa 15% e tyre mendojnë se ai nuk i njej. Shkaqet për këtë pohim duhet të kërkohen në shkollën, si dhe në mjedisin në të cilin ata jetojnë.




Grafiku 25: Perceptimet prindërve për njohjen e pamjaftueshme të ndërsjellë të të tjerëve

2.2.3. Perceptimi për tensionet etnike ndërmjet nxënësve

◆ Perceptimet e kuadrit edukativo-arsimor dhe perceptimet e prindërve

Arsimtarët, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë ishin pyetur edhe për atë se a ka në shkollën e tyre tensione ndërmjet nxënësve në baza etnike. Se ka tensione të fshehura etnike u përgjigjën 55% të arsimtarëve, ndërsa 10% u përgjigjën se ka tensione të dukshme. Nuk vërehet dallim në përgjigjet e arsimtarëve që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme mësimore dhe në qytete të ndryshme.



Grafiku 26: Teachers' perceptions on the ethnic tensions among the students

Prindërit, por më pak edhe arsimtarët, janë të vetëdijshëm për tensionet e fshehta, ndërsa shumica e tyre nuk e dinë se a ka tensione. Kjo edhe është e pritur, sepse fëmijët në shtëpi rëndom tregojnë për tensionet e dukshme ndëretnike.


Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionale të 3 shkollave konsiderojnë se ka tensione të fshehta etnike, ndërsa këta faktorë të 3 shkollave të tjera thonë se nuk ka tensione të tilla.

◆ Perceptimet e nxënësve

Perceptimi i nxënësve ishte hulumtuar përmes pyetjes: Si sillen mes vete nxënësit që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore? (për nxënësit e klasës IV dhe VIII) dhe përmes 2 pyetjeve për sjelljen e dhunshme të nxënësit të klasës VIII.

Rreth 2/3 e të anketuarve u përgjigjën se nxënësit që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore mes vete kanë sjellje miqësore. Diçka më pak se 10% konsiderojnë se shpesh ose çdoherë kanë sjellje armiçësore. Kjo përqindje është përafërsisht e njëjtë me përqindjen e armiçësive të dukshme që i kanë zbuluar prindërit dhe arsimtarët.


Nuk ka dallime në perceptimet e nxënësve me mësim në gjuhë të ndryshme mësimore.



Grafiku 27: Perceptimet e nxënësve për sjelljen e nxënësve me mësim në gjuhë të ndryshme mësimore

Pasqyra më e qartë e sjelljes jotolerante të nxënësve në bazë fetare dhe nacionale është nxjerrë nga nxënësit e klasës VIII, kjo në bazë të pyetjeve për atë se sa shpesh kanë sjellje jotolerante ndaj fëmijëve të tjerë dhe sa shpesh durojnë sjellje jotolerante.

Rreth 20% e nxënësve ndonjëherë i thumbojnë/përqeshin fëmijët e tjerë ose qëllimisht i shmangin. Këtë shpesh e bëjnë 2-3%. Megjithatë, për shkak të nacionalitetit ose fesë këtë e bëjnë 5-6% të nxënësve.



Grafiku 28: Sjellja jotolerante e nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore

Nxënësit që mësojnë në gjuhën shqipe dukshëm më shumë se të tjerët (8,5%) e përqeshin dikë për shkak të besimit fetar, por edhe vetë shpesh (10% e tyre) janë përqeshur për shkak të kësaj. 16% e nxënësve që mësojnë në gjuhë mësimore shqipe dhe 15% e nxënësve që mësojnë në gjuhë mësimore turke janë përgjigjur se ndonjëherë janë përqeshur për shkak të nacionalitetit. Përqindja e nxënësve me mësim në gjuhën maqedonase që kanë pasur përvoja të tillë është shumë më e vogël (rreth 5%).

◆ **Mendime për atë se si mund të pakësohen tensionet**

Në pyetjen se si mund të pakësohen tensionet, nga lista e 9 aktiviteteve të ofruara që kanë të bëjnë me shkollën prindërit dhe aktivitetet e faktorëve jashtëshkollorë (mediat, organizatat joqeveritare, komuna), të anketuarit kishin mundësi të zgjedhin 3 prej tyre. Shumica e arsimtarëve dhe drejtorëve/bashkëpunëtorëve profesionalë janë përcaktuar për:


	arsimtarë	drejtorë/ bashk. prof.	prindër	
			klasa IV	klasa VIII
Më shumë aktivitete të përbashkëta në shkollë	62%	47%	54%	64%
Inkuadrim më të madh i prindërve në aktivitetet për bashkëpunim ndëretnik.	36%	33%	26%	24%
Punë me prindërit për tejkalimin e paragjytimeve dhe stereotipave të tyre.	38%	27%		
Me inkuadrim më të madh të nxënësve në përkufizimin e aktiviteteve për bashkëpunim ndëretnik.	30%	6%	32%	35%

Për aktivitetet e organizatave joqeveritare, mediave dhe komunave, si dhe agjentëve potencialë për tejkalimin e tensioneve në shkolla, janë përcaktuar më pak se 20% e të gjitha kategorive të të anketuarve.

2.2.4. Mendimet e faktorëve që mund të kontribuojnë për marrëdhënie të mira ndëretnike

Sipas teorisë, për një arsim të suksesshëm multietnik, përveç shkollës, nevojitet edhe ndikimi i sinkronizuar i faktorëve të tjerë të mjedisit. Në këtë hulumtim arsimtarët, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë e kanë shprehur pikëpamjen e tyre ndaj mundësisë për të ndikuar në një pjesë të atyre faktorëve. Sipas mendimeve të tyre, më shumë mund të ndikojnë prindërit dhe familja, mediat dhe arsimtarët.

Sipas mendimit të arsimtarëve, nxënësit liderë, komuna dhe partitë politike kanë më pak ndikim se faktorët e tjerë; ndërkaq, sipas mendimeve të drejtorëve, më së shumti mund të ndikojnë arsimtarët, prindërit dhe familja, mediat dhe komuna.



Grafiku 29: Mendimet e arsimtarëve për kontributin e mundshëm të faktorëve të ndryshëm për marrëdhënie të mira ndëretnike

Përfundim

- ◆ Në shkollat e përfshira në projekt takimet dhe trajnimet formale rregullisht zhvillohen bashkërisht, madje shpesh edhe aktivitetet që kanë të bëjnë me aktivitetet jashtëmësimore dhe jashtëshkollore janë të përbashkëta, por aktivitetet mësimore dhe puna me seksione rrallë organizohet bashkë. Kjo praktikë është në pajtim me perceptimet e kuadrit edukativo-arsimor për potencialet e aktiviteteve të caktuara mësimore dhe jashtëmësimore për zhvillimin e marrëdhënieve ndëretnike.
- ◆ Shumica e prindërve nuk e dinë se në shkollën e tyre ka pasur ngjarje që kanë pasur për qëllim bashkëpunimin ndërmjet nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike.
- ◆ Tensione të dukshme ndërmjet nxënësve në baza etnike vërehen relativisht të pak arsimtarët dhe prindër, por tensione të fshehta vërejnë rreth gjysma e arsimtarëve dhe rreth 20% e prindërve.
- ◆ Shumica e nxënësve konsiderojnë se fëmijët e bashkësive të tjera etnike ndaj tyre kanë sjellje miqësore, por secili i dhjeti ndjen se ata kanë sjellje armiqësore.
- ◆ Arsimtarët, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë konsiderojnë se më shumë aktivitete të përbashkëta do të kontribuojnë në pakësimin e tensioneve në baza etnike, por në këtë ndihmon edhe inkuadrimi më i madh i prindërve në aktivitete dhe i nxënësve në planifikimin e tyre.
- ◆ Përveç shkollës, sipas mendimit të një numri të madh të arsimtarëve, drejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, për marrëdhënie të mira ndëretnike më së shumti mund të kontribuojnë prindërit, familja dhe mediat, ndërsa më pak tekstet shkollore, partitë politike dhe sektori joqeveritar.

2.2.5. Distanca sociale

Perceptimi i të tjerëve dhe përgatitja për (mos)pranimin e tyre është një faktor që duhet të kihet parasysh gjatë planifikimit të aktiviteteve për arsim multietnik dhe multikulturor. Që të kontrollohet kjo, ishte hulumtuar distanca sociale⁷ te arsimtarët, te drejtorët/bashkëpunëtorët profesionalë, te nxënësit dhe te prindërit e tyre.

Mënyrat e matjes

Distanca sociale ishte matur me dy lloje instrumentesh:

1. Shkalla e distancës sociale e tipit të Bogardus-it. Me këtë rast ishin përgatitur tre variante të shkallës. Të gjitha kishin një varg të pikëve të radhitura në mënyrë hierarkike të pranimit në raport me pjesëtarët e këtyre popujve që jetojnë me shumicë në Maqedoni: maqedonas, shqiptarë, turq dhe romë.

- ◆ Shkalla e të moshuarve (arsimtarë, drejtorë/bashkëpunëtorë profesionalë, prindër) i kishte 6 pika (të jetoj në fqinjësi, të jem në aktiv të njëjtë (të punoj), të shoqërohem në kohën e lirë, të kem mikun/miken më të mirë, të jetë bashkëshort/e e një farefisi të afërt dhe unë ose fëmija im të martohet për).
- ◆ Shkalla e nxënësve i kishte 7 pika (të jetoj në qytetin/fshatin e njëjtë, të jetoj në fqinjësi, të mësoj në paralelen e njëjtë, të luaj në kohën e lirë, të ulem në bankën e njëjtë, ta kem mikun/miken më të mirë, ta kem simpati).

Nxënësit duhej ta shënonin secilën pikë që për ata ishte e pranuar në raport me secilin popull. Distanca sociale është shprehur si numër i pohimeve të pranuar, lëviz nga 0 deri në 6 te shkallët e të moshuarve dhe nga 0 deri në 7 në shkallën e nxënësve. Vlera më e madhe shpreh distancë më të vogël sociale.

2. Pyetje në pyetësor


- ◆ për nxënës (2 pyetje) dhe në pyetësor
- ◆ për prindër (2 pyetje)

Ashtu si në shumë hulumtime të tjera, pjesëtarët e të gjithë popujve i pranojnë interaksionet më të afërta me pjesëtarët e popullit përkatës sesa me pjesëtarët e popujve të tjerë.

Në këtë hulumtim është simptomatik niveli relativisht i ulët i pranimit të të gjithë popujve, përveç popullit të cilit i përket vetë personi, te arsimtarët dhe te drejtorët/bashkëpunëtorët profesionalë maqedonas. Numrat flasin se sa herë që bëhet fjalë për popujt e tjerë, ata mesatarisht pranojnë të jetojnë në fqinjësi të tyre, të punojnë bashkërisht dhe eventualisht të shoqërohen në kohën e lirë. Është indikative se një pjesë e arsimtarëve janë shmangur nga përgjigjja e kësaj pyetje.

Distanca sociale e arsimtarëve dhe drejtorëve/bashkëpunëtorëve profesionalë ndaj pjesëtarëve të popujve të tjerë është paraqitur në grafikun 30.


⁷ Distanca sociale paraqet shkallën e pranimit ose mospranimit të kontakteve sociale me personat që u takojnë grupeve të ndryshme sociale (racore, etnike, fetare...)



Grafiku 30: Distanca sociale te arsimtarët, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë

Për distancën sociale të prindërve dhe nxënësve, të matur me shkallën e distancës sociale, nuk janë arritur të dhëna relevante, sepse shumica e të anketuarve e kanë shënuar vetëm shkallën e pranimit të popullit të tyre. Kjo po ashtu mund të jetë një edhe tregues për shmangien e përgjigjes, për shkak të shkallës së lartë të mospranimit të tjerëve.

Distanca sociale e nxënësve është paraqitur përmes pyetjeve për atë se a kanë shokë të nacionaliteteve të tjera. Edhe prindërit ishin pyetur se a kanë fëmijët e tyre shokë të bashkësive të tjera etnike në shkollë dhe jashtë saj. Me këtë rast 72% e prindërve janë përgjigjur se fëmijët e tyre kanë shokë të bashkësive të tjera etnike në shkollë, ndërsa 58% e prindërve janë përgjigjur se kanë shokë edhe jashtë shkollës.




Grafiku 31: Shoqërimi me fëmijë të bashkësive të tjera etnike

Sipas përgjigjeve të prindërve, fëmijët e klasës VIII më shpesh kanë shokë të bashkësive të tjera etnike se fëmijët e klasës IV (75%, respektivisht 62%). Ky dallim është më i vogël kur bëhet fjalë për shokë jashtë shkollës (sipas njohurive të prindërve, 59%

e fëmijëve të klasës VIII dhe 51% të fëmijëve të klasës IV kanë shokë nga bashkësia tjetër etnike jashtë shkollës, por një pjesë e prindërve të nxënësve të klasës VIII nuk e dinë se me kë shoqërohet fëmija i tij jashtë shkollës).

Fëmijët që mësojnë në gjuhën mësimore turke më shpesh kanë shokë të bashkësive të tjera etnike se fëmijët që mësojnë në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe.

Nxënësit ishin pyetur se çka është më e rëndësishme për ata që dikush të jetë shoku/shoqja e tyre **më i/e mirë**. Për shumicën e nxënësve me mësim në të gjitha gjuhët mësimore që dikush të jetë shoku më i mirë për ata më është e rëndësishme që ai të jetë i mirë me ata. Megjithatë, është indikative se rreth 20% e nxënësve me mësim në gjuhën maqedonase dhe shqipe më të rëndësishme e kanë që ai të jetë i fesë së njëjtë, ndërsa po aq nxënës shqiptarë më të rëndësishme e theksojnë faktin e të qenit i nacionalitetit të njëjtë.




Grafiku 32: Çka është më e rëndësishme për nxënësit që dikush të jetë shoku/shoqja e tyre më i/e mirë

Tregues të distancës sociale te prindërit ishin përgjigjet e pyetjeve për nxënësit: *A kanë prindërit tu miq të nacionalitetit tjetër nga ajo që janë vetë?*

Sipas 54% të nxënësve të klasës IV dhe 72% të nxënësve të klasës VIII, prindërit e tyre kanë miq të nacionalitetit tjetër, rreth 7% të nxënësve (të të dyja klasave) kanë deklaruar se nuk kanë, ndërsa të tjerët kanë deklaruar se nuk e dinë.

Distanca sociale e prindërve mund të shihet edhe drejtpërdrejt përmes përgjigjes në pyetjen se a është ndonjë anëtar i familjes së tyre i/e martuar me ndonjë pjesëtar/e të bashkësisë tjetër etnike. Martesa të përziera ka më së paku te familjet maqedonase, ndërsa më shumë te familjet shqiptare (22%) dhe turke (31%), të cilët janë më të përgatitur për martesë të përziera nëse janë të religjionit të njëjtë.



Grafiku 33: Martesat e anëtarëve të afërt të familjes të martuar me pjesëtarë të bashkësive të tjera etnike

Përfundim

- ◇ Distanca sociale e kuadrit mësimor ndaj pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike është e madhe. Kur bëhet fjalë për pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike, ata pranojnë të jetojnë në fqinjësi me ta, të punojnë bashkë dhe eventualisht të shoqërohen në kohën e lirë, por jo edhe të jenë miq të mirë, bashkëshortë të anëtarëve të afërt të familjes, bashkëshortë të tyre ose të fëmijëve të tyre.
- ◇ Sipas njohurive të prindërve, fëmijët e tyre kanë shokë nga bashkësitë e tjera etnike në shkollë (72%) dhe jashtë shkollës (58%). Kur e zgjedhin shokun më të mirë, për shumicën e nxënësve më e rëndësishme është që ai të jetë i mirë me ata, por është i madh edhe numri i atyre nxënësve (30% të maqedonasit dhe 40% të shqiptarët) të cilët më me rëndësi e kanë që shoku i tyre të jetë i fesë ose nacionalitetit të njëjtë.
- ◇ Shumica e prindërve kanë miq të bashkësive të tjera etnike, por në familje nuk ka shumë martesat të përziera, veçmas të maqedonasit. Kjo si duket është pasojë e martesave të përziera të pjesëtarëve të nacionaliteteve të ndryshme, por që janë të fesë së njëjtë.

3. INICIATIVAT E KOMUNAVE QË KANË TË BËJNË ME ARSIMIN MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK NË SHKOLLA

Sipas hulumtimeve⁸, arsimi multietnik është proces, mënyrë e të menduarit, mënyrë e marrjes së vendimeve dhe mënyrë e vazhdueshme e sjelljes në mjedis arsimor. Inkuadrimi i ndryshimeve dhe qëndrueshmëria e tyre është e mundur nëse në aktivitetet e projektit inkuadrohen komunat, veçmas përgjegjësit e arsimit në pushtetin lokal.

Iniciativat e deritanishme për arsim multietnik dhe multikulturor në Republikën e Maqedonisë, por edhe projektet dhe aktivitetet zakonisht janë realizuar përmes sektorit joqeveritar. Në këtë hulumtim kemi dashur ta vërtetojmë se a ka dhe cilat janë iniciativat e komunave që kanë të bëjnë me arsimin multietnik në shkolla, si dhe cili është perceptimi për komunikimin multietnik në shkolla nga përfaqësuesit e komunave dhe organizatave joqeveritare. Të dhënat i kemi mbledhur përmes anketave, duke përdorë pyetësor gjysmë të strukturuar.

3.1. ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Anketa me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare i ka përfshirë shtatë organizata që punojnë në mënyrë aktive në pilot-qytete (nga tre në Strumicë dhe Tetovë dhe një në Shkup). Me këtë rast, duke përdorë pyetësor gjysmë të strukturuar, është anketuar nga një përfaqësues i secilës organizatë. Organizatat janë analizuar në aspekt të kapaciteteve të tyre për menaxhimin e projekteve, në aspekt të përvojës dhe profesionalizmit në fushat përkatëse dhe me grupet qëllimore që janë me interes për projektin. Për këtë qëllim janë hulumtuar edhe perceptimet e tyre në pikëpamje të gjendjes së marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet nxënësve në komunat e tyre, në pikëpamje të shkallës së bashkëpunimit me pushtetin lokal dhe shkollat në komunë, si dhe në bazë të distancës sociale ndaj pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike.

3.1.1. Kapacitetet e organizatave

Marrë në përgjithësi, të gjitha organizatat e inkuadruara i përmbushin principet themelore për themelimin dhe zhvillimin e punës së organizatës joqeveritare: janë themeluar në bazë të Ligjit për shoqata dhe fondacione, kanë llogari të tyre bankare, mbajnë kontabilitet sipas kërkesave ligjore të R.M.-së, kanë statut të tyre, bëjnë raporte vjetore për punën e tyre, kanë këshill ekzekutiv, bëjnë përshkrimin e vendeve të punës, bëjnë planifikime vjetore, i kanë përkufizuar qartë procedurat financiare dhe procesin e marrjes së vendimeve.

⁸ Shih kapitullin 2.

Në tri prej këtyre organizatave mungon një shkallë e caktuar e transparencës që mund të shihet nga të dhënat se nuk kanë praktikë të shpalljes së raporteve vjetore, ndërsa në tre organizata të tjera mungojnë raportet financiare.

Të gjithë kanë raportuar se kanë përvojë në menaxhimin e ciklit të projekteve dhe se praktikojnë inkuadrimitin e grupeve qëllimore në proceset e marrjes së vendimeve, por tre prej organizatave kanë vlerësuar se nuk kanë mjaft kapacitetet për menaxhimin financiar të projekteve, si dhe kapacitete për rritjen e mjeteve të disponueshme financiare.

3.1.2. Fushat e ekspertizës

Nga tabela e mëposhtme mund të shihet se pjesa më e madhe e organizatave kanë pasur përvojë në fushat që kanë të bëjnë me qëllimet e projektit, si dhe me grupet qëllimore që janë të rëndësishme për aktivitetet e projektit. Organizatat “Sumnal” dhe “Multikultura” kanë më së shumti përvojë të drejtpërdrejtë në punën me fushat e theksuara dhe grupet qëllimore. Sipas asaj, ato mund të inkuadrohen si bartëse të një pjese të madhe të aktiviteteve të parashikuara.

Më tej, të gjitha kanë punuar drejtpërdrejt me fëmijë dhe të rinj dhe kanë bashkëpunuar drejtpërdrejt ose tërthorazi me bashkësinë lokale.

Tabela 13: Përvojat e organizatave në fushat konkrete dhe në punën me grupe të ndryshme qëllimore

Organizatave joqeveritare	Përvoja në fushat:			Përvoja në punën me:			
	Arsimi interkulturore	Arsimi i fillor	Të drejtat e fëmijëve	Fëmijë dhe të rinj	Prindër	Arsimtarë	Bashkësia lokale
Organizata e grave – Strumicë	I	D	D	D	I	I	D
Porta – Strumicë	I	I	I	D	I	I	I
Planetum – Strumicë	N	D	N	D	D	D	D
Sumnal – Butel	D	D	D	D	D	D	D
Loja – Tetovë	D	I	N	D	I	D	D
Multikultura – Tetovë	D	D	D	D	D	I	I
IZHB – Tetovë	D	N	N	D	N	N	I

Legend: **D** – përvoja direkte; **I** – përvoja indirekte (përmes bashkëpunimit me organizatë tjetër); **N** – nuk ka.

Të gjithë të anketuarit kanë theksuar se organizata e tyre ka bashkëpunuar me organizata që kanë përbërje etnike përgjithësisht të ndryshme nga ajo e organizatës së tyre dhe theksojnë se janë të hapur për rrjetëzim të mëtejshëm me organizatat me përbërje të ndryshme/të përzier etnike.

3.1.3. Inkuadrimi në projekte për bashkëpunim ndëretnik

Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare ishin pyetur edhe për inkuadrimin e tyre në projekte që promovojnë bashkëpunim ndëretnik dhe ndërkulturor, si organizatorë të drejtpërdrejtë ose si pjesëmarrës në aktivitete të organizuara nga organizata të tjera. Përveç njëjës, të gjitha organizatat⁹ kanë marrë pjesë dhe kanë organizuar projekte ose aktivitete konkrete, që kanë pasur për qëllim bashkëpunimin/tolerancën ndëretnike. Projektet konkrete janë dhënë në tabelën më poshtë:

Tabela 14: Pjesëmarrja në projekte që promovojnë bashkëpunim/tolerancë ndëretnike

Organizata joqeveritare	Projekte
Organizata e grave – Strumicë	Aktivitetet për pakësimin e stereotipave etnike në shkolla me përbërje të përzier etnike në kuadër të projektit për zbatimin e ligjit të mosdiskriminimit.
Porta – Strumicë	Projektet: Nën diell të njëjtë dhe Stop diskriminimit.
Sumnal – Butel	Projekte për fuqizimin e kapaciteteve të arsimtarëve dhe pedagogëve të ardhshëm për punë në mjedise multietnike. Inkluzioni i fëmijëve romë në çerdhet e fëmijëve me përbërje tjetër etnike.
Loja – Tetovë	Pjesëmarrja në punëtori të ndryshme për zgjidhjen e konflikteve dhe mësimin interkulturalor. Organizator i trajnimeve nga fusha e konflikt-menaxhmentit; implementon kurs në Universitetin e Evropës Juglindore – Tetovë, i dedikuar për arsimtarët e ardhshëm, në të cilin ata kalojnë përmes trajnimit për konflikt-menaxhment dhe informohen për të drejtat e njeriut, multikulturalizmin dhe metodat mësimore për mësim multikulturalor.
Multikultura – Tetovë	Zgjidhje paqësore e konflikteve dhe stereotipave – i mbështetur nga NCBI Paqe dhe antidiskriminim – me përkrahje të ambasadës së Norvegjisë. Një hap para në arsimin e fëmijëve romë nga klasa e dytë deri në të katërtën. Dita e dallimeve.
IZHB – Tetovë	Projekte në kuadër të programit të OKB-së – Fuqizimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik ndërmjet bashkësive (Vizione të përbashkëta, klube multi-kulti etj.) Promovimi i vlerave humane (PVH) në organizatën e Kryqit të Kuq.

3.1.4. Bashkëpunimi me shkollat dhe pushtetin lokal

Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare në masë të madhe kanë qëndrime të ngjashme në pikëpamje të bashkëpunimit me shkollat. Bashkëpunimi kryesisht vlerësohet si i kënaqshëm, me atë që një pjesë e tyre theksojnë se iniciativat për bashkëpunim në përgjithësi vijnë nga organizata, ndërsa shkollat në masë të madhe i pranojnë ato me vullnet të mirë. Vetëm përfaqësuesi i IZHB-së konsideron se “shkollat nuk janë të interesuara për bashkëpunime të këtilla dhe për këtë ka shumë pak bashkëpunime të këtij tipi ndërmjet organizatave joqeveritare dhe shkollave (...) shkaku kryesor për bashkëpunimin e dobët është mungesa e mirëkuptimit nga udhëheqësit e shkollave për dobitë e kësaj, që buro-

⁹ Në misionin e organizatës Planetum të Strumicës nuk bien aktivitetet nga fusha e bashkëpunimit ndëretnik.

jnë nga bashkëpunimi ndërmjet shkollave dhe organizatave joqeveritare". Megjithatë, ekziston përshtypja se bashkëpunimi në masë të madhe është formal dhe nuk përfshin elemente të përkufizimit të përbashkët të përparësive dhe aktiviteteve, si dhe vendim-marrje të përbashkët. Projektet më shpesh zhvillohen nga organizatat qytetare, ndërsa shkollat (arsimtarët, nxënësit) janë konsumatorë të shërbimeve.

Shkalla e bashkëpunimit me administratën komunale vlerësohet ndryshe, varësisht nga komuna prej së cilës është organizata. Organizatat e komunës së Strumicës, si dhe vetë të punësuarit në komunë, kanë vlerësuar se bashkëpunimi i ndërsjellë është në nivelin më të lartë. Komuna ka nënshkruar memorandum për bashkëpunim me organizatat qytetare që veprojnë në territorin e saj; secilin vit në shkurt shpall konkurs për projektet; dhe të gjithë përfaqësuesit e sektorit qytetar kanë konfirmuar se komuna çdoherë u ka dalë në ndihmë gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit.

Dy organizatat e Tetovës e kanë vlerësuar bashkëpunimin me komunën si solide, veçmas në sektorin e veprimtarive publike, edhe pse nuk japin më shumë detaje dhe informacione rreth asaj se në çfarë mënyre zhvillohet bashkëpunimi, ndërsa nga organizata Loja theksojnë se nuk kanë pasur bashkëpunim të ndërsjellë me pushtetin lokal, porse rëndom bashkëpunojnë me njësinë rajonale të Ministrisë së Arsimit. Përfaqësuesi i organizatës "Sumnal" i komunës Butel ka theksuar se komuna në përgjithësi u del në ndihmë nëse ata kanë nevojë për shfrytëzimin e hapësirës, edhe pse nuk marrin ndihmë financiare ose ndihmë tjetër.

3.1.5. Qëndrimet në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike midis nxënësve në komunë

Qëndrimi i përgjithshëm i përfaqësuesve të sektorit civil është se nxënësit e përkatësive të ndryshme etnike nuk njihen sa duhet në komunën e tyre. Përfaqësuesit e katër organizatave konsiderojnë se ata aspak ose thujse aspak nuk njihen mes vete, ndërsa të tjerët mendojnë se nxënësit vetëm pjesërisht njihen mes vete. Si shkaqe për këtë gjendje, pa marrë parasysh komunën prej ku vijnë nxënësit, më shpesh përmenden:

- ◆ Mosnjohja e gjuhës së bashkësisë tjetër;
- ◆ Mësimi në ndërrime ose objekte të ndryshme;
- ◆ Mësimi për gjëra të ndryshme;
- ◆ Dalja në vende të ndryshme;
- ◆ Ekzistimi i paragjyqimeve të fuqishme për "tjetrin".

Ashtu siç thekson përfaqësuesi i organizatës "Loja" në Tetovë: *"...ekzistojnë dy bota paralele shkollore që thellohen edhe më shumë me ndarjen e nxënësve në ndërrime të ndryshme, ndërsa edhe më drastike dhe karakteristike është në Tetovë, ku mësojnë edhe në ndërtesa të ndryshme shkollore"*.

Edhe përkundër pajtueshmërisë së përgjithshme, se nxënësit njihen pak mes vete, qëndrimet rreth tensioneve etnike në shkollat fillore dhe të mesme janë të ndara, madje edhe në nivel të komunës së njëjtë. Më konkretisht, derisa dy organizatat e Strumicës konsiderojnë se nuk ka tensione, kurse për njërin prej tyre ekzistojnë, ndërmjet organizatave të Tetovës ekzistojnë më shumë mendime të ndara: njëra palë mendojnë se

tensione ka edhe në shkollat fillore edhe në shkollat e mesme, të tjerët konsiderojnë se ato ekzistojnë vetëm në shkollat e mesme, ndërsa pala e tretë vlerësojnë se tensione nuk ekzistojnë aspak. Ndonëse të anketuarit nuk janë unikë në pikëpamje të kësaj pyetjeje, vlerësimi i një pjese të tyre se ekzistojnë tensione, flet për situatën e dobët ndëretnike në shkolla.

Në bazë të kësaj, të gjithë janë të pajtimit se duhet të ndërmerren aktivitete për përmirësimin e njohjes së ndërsjellë të nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike, me ç'rast theksohen (potencohen) këto lloje të aktiviteteve:

- ◆ aktivitete jashtëmësimore (në bashkëpunim me komunën, organizatat jo-qeveritare, prindërit) dhe
- ◆ aktivitete të përbashkëta në shkolla.

Në këtë drejtim nga organizata “Loja” theksojnë se: edhe pse organizatat jo-qeveritare mund të ndihmojnë përmes punës së drejtpërdrejtë me arsimtarët dhe nxënësit, kapaciteti për mbulimin e plotë është i vogël; problem është fakti se aktivitetet e këtilla do të duhej të organizohen jashtë mësimi; institucionet do të duhej ta ndryshojnë praktikën aktuale me çka e mbështesin polarizimin e bashkësive.

3.1.6. Qëndrimet ndaj bashkësive të tjera etnike

Qëndrimet ndaj bashkësive të tjera etnike janë hulumtuar përmes Shkallës së distancës sociale. Rezultatet flasin se, edhe përkundër faktit se thuajse të gjithë të anketuarit kanë marrë pjesë në projekte, përkatësisht se kanë punuar në projekte për bashkëpunim multietnik, paragjykimet ndaj bashkësive të ndryshme prej tyre ekzistojnë ende. Më konkretisht, vetëm dy të anketuar janë përgjigjur se do t'i praninin të gjitha llojet e marrëdhënieve të ndërsjella me përfaqësuesit e bashkësive të tjera etnike. Për dy prej tyre, shumica e marrëdhënieve janë të pranueshme, por jo edhe martesat me një person të një përkatësie tjetër etnike. Tre të anketuarit e tjerë shprehin pakënaqësi për shtrirjen më të madhe të marrëdhënieve, përfshirë edhe një mik më të mirë të një nacionaliteti tjetër, pranim të një personi nga nacionaliteti tjetër për partner martese të një miku/farefisi të afërt etj.

3.2. PUSHTETI LOKAL – SEKTORI I ARSIMIT

Anketa me përfaqësues të komunave që janë përgjegjës për arsim ka përfshirë pesë persona (një prej Strumice dhe nga dy prej Tetove dhe Shkupi/Buteli). Me këtë rast ishte hulumtuar inkuadrimi i komunës në projekte për promovimin e bashkëpunimit ndëretnik, pastaj ishin hulumtuar qëndrimet e përfaqësuesve të komunës për praninë e tensioneve etnike ndërmjet nxënësve në komunë, shkalla e bashkëpunimit me shkollat dhe organizatat joqeveritare që janë aktive më komunë, si dhe qëndrimet (distanca sociale) ndaj bashkësive të tjera etnike.

3.2.1. Inkuadrimi në projekte për bashkëpunim ndëretnik

Nga tabela më poshtë mund të shihet se përgjegjësit e arsimit nga Strumica dhe Tetova kanë qenë më shumë të përfshirë në projekte që promovojnë bashkëpunim ndëretnik, kjo në krahasim me komunën e Butelit. Megjithatë, edhe pse ekziston interes për aktivitete të tillë, vëllimi i projekteve të këtij lloji, që janë të mbështetura, është i vogël, ndërsa mungojnë projektet e organizuara drejtpërdrejt nga komuna.

Tabela 15: Inkuadrimi në projekte për bashkëpunim ndëretnik dhe ndërkulturor

Komuna	Projektet
Strumica	Pjesëmarrje në: <ul style="list-style-type: none"> - arsimin e integruar dygjuhësh (qendra Nansen), - të drejta dhe mundësi të barabarta (UNICEF), - strategjia e romëve. Komuna ka mbështetur projekt për trashëgiminë kulturore.
Buteli	Pjesëmarrje në seminarin për multikulturalizëm (OSBE).
Tetova	Pjesëmarrje në: <ul style="list-style-type: none"> - përparimin e dialogut ndëretnik në komuna (QMEQ). Është mbështetur: <ul style="list-style-type: none"> - manifestimi “Tetova – qytet i paqes dhe mirëkuptimit të mirë ndëretnik” - Dita e dallimeve, projekt i OJQ “Multikultura”

Të gjithë përfaqësuesit komunalë pohojnë se komuna e ka përkufizuar politikën zyrtare të arsimit, ndërsa ata të Strumicës dhe Tetovës shtojnë se programi përfshin edhe aktivitete/prioritete konkrete për përmirësimin e bashkëpunimit/tolerancës ndëretnike, përmes “angazhimit për përfshirje të plotë të nxënësve nga nacionaliteti turk dhe sigurimi i literaturës në gjuhën turke” (Strumicë), si dhe përmes “rritjes së shkallës së tolerancës me qëllim të pakësimit të konflikteve ndëretnike ndërmjet nxënësve” (Tetovë).

3.2.2. Bashkëpunimi me shkollat dhe organizatat joqeveritare në komunë

Përfaqësuesit e komunave janë të ndarë rreth çështjes se në cilën shkallë janë të përfshirë ata në shqyrtimin e programeve vjetore të shkollave. Tre nga të anketuarit (nga një në secilën komunë) konsiderojnë se janë të inkuadruar në mënyrë aktive përmes aktiviteteve si: kujdesi i përfshirjes së nxënësve, formimi i profesioneve të reja, aktivitetet rreth e-ditarit dhe kujdesi për cilësinë dhe standardet. Dy të tjerët mendojnë se inkuadrimi është sipërfaqësor. Pa marrë parasysh shkallën e inkuadrimin, mund të vërehet mungesë e inkuadrimin në aktivitete që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet nxënësve.

Përfaqësuesit e anketuar të komunës së Butelit dhe Strumicës pajtohen se komuna ka bashkëpunim të mirë me shkollat që bien në territorin e saj, që manifestohet para së gjithash përmes takimeve më këshillat drejtues, këshillat e prindërve etj., ndërsa nga komuna e Strumicës theksojnë edhe se në shkollat e përziera etnike organizojnë ngjarje për festa, gara e aktivitete të ngjashme. Përfaqësuesit e komunës së Tetovës e

vlerësojnë bashkëpunimin si të kënaqshëm, ndonëse thonë se ka hapësirë për t'u përmirësuar. Për shembull, përmes planifikimit të përbashkët të aktiviteteve në programet vjetore për punën e Sektorit të Arsimit, si dhe në parashikimin e mjeteve për realizimin e tyre.

Marrë në përgjithësi, mund të përfundohet se bashkëpunimi me shkollat në komunën e Butelit dhe të Tetovës nuk e tejkalon shkallën e inkuadrimin në aktivitetet e shkollave, gjë që është parashikuar edhe me ligj. Vetëm komuna e Strumicës shfaq angazhim më të madh për inkuadrimin e nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike në aktivitete të përbashkëta.

Në pikëpamje të bashkëpunimit me sektorin joqeveritar, përgjegjësit e komunave të Tetovës dhe të Strumicës e vlerësojnë atë si shumë të suksesshëm dhe theksojnë se kanë nënshkruar memorandum për bashkëpunim me një pjesë të organizatave joqeveritare dhe deri tash kanë realizuar aktivitete të përbashkëta. Nga komuna e Butelit mendojnë se komunikimi është i dobët dhe se organizatat joqeveritare nuk kanë sa duhet iniciativa.

3.2.3. Qëndrimet për gjendjet ndëretnike në komunë

Të gjithë përfaqësuesit e anketuar të komunës kanë qëndrim të njëjtë rreth shkallës së njohjes së ndërsjellë të nxënësve të bashkësive të ndryshme etnike në komunë – mendojnë se nxënësit njihen pjesërisht. Megjithatë, njohja e paktë e ndërsjellë nuk është e lidhur patjetër me ekzistimin e tensioneve në shkolla. Prandaj, derisa përfaqësuesit e komunës së Butelit vlerësojnë se nuk ka tensione etnike ndërmjet nxënësve, nga komuna e Tetovës vlerësojnë se tensione ekzistojnë edhe në shkollat fillore edhe në ato të mesme, ndërsa nga komuna e Strumicës – vetëm në shkollat fillore. Propozimet për tejkalimin e tyre në masë të madhe përfshijnë:

- ◆ Shoqërim jashtë shkollës (4 përgjigje);
- ◆ Inkuadrim të prindërve (4 përgjigje);
- ◆ Aktivitete në nivel të komunës (3 përgjigje);
- ◆ Inkuadrim të nxënësve në përkufizimin e aktiviteteve (2 përgjigje);
- ◆ Aktivitete në shkollë (2 përgjigje).

Qëndrimi i përgjithshëm është se komuna mund të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet nxënësve në kuadër të shkollave (p.sh.: këshillimi me shërbimet pedagogjike-psikologjike për aktivitetet jashtëmësimore), si dhe jashtë shkollave (për aktivitete kulturore, manifestime sportive etj.).

3.2.4. Qëndrimet për bashkësitë e tjera etnike

Vetëm një pjesë e përfaqësuesve të anketuar të komunave do t'i pranonin të gjitha nivelet e marrëdhënieve me përfaqësuesit e bashkësive etnike që dallojnë nga ata. Të tjerët janë më të mbyllur, veçmas kur bëhet fjalë për themelimin e bashkësisë marte-

sore (personale ose të ndonjë miku/farefisi të afërt), ndërsa bashkësia etnike të cila shprehet distanca më e madhe është ajo rome.

Përfundim

- ◇ Përfaqësuesit e sektorit joqeveritar dhe të pushtetit lokal mendojnë se nxënësit e përkatësive të ndryshme etnike që mësojnë në gjuhë të ndryshme njihen pak mes vete.
- ◇ Sektori joqeveritar dhe pushteti lokal shihen si faktor i rëndësishëm në përmirësimin e tolerancës ndëretnike. Megjithatë një pjesë e komunave nuk kanë vendosur bashkëpunim të suksesshëm me organizatat joqeveritare (modeli më i suksesshëm i bashkëpunimit është vendosur në Strumicë, ndërsa më pak i suksesshëm është në Butel.
- ◇ Organizatat joqeveritare posedojnë kapacitete solide për menaxhimin e projekteve, shumica e tyre kanë përvojë në punën e aktiviteteve për bashkëpunim/tolerancë ndëretnike, ndërsa një pjesë e tyre kanë edhe përvojë përkatëse në fushat konkrete që kanë të bëjnë me qëllimet e projektit.
- ◇ Pjesa më e madhe e aktiviteteve të propozuara për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik ndërmjet nxënësve kanë të bëjnë me aktivitete jashtë shkollës, kjo si duket për shkak të faktit se organizatat qytetare dhe pushteti lokal mendojnë se jashtë shkollës kanë më shumë ndikim dhe liri të veprimit.
- ◇ Një pjesë e madhe e përfaqësuesve të komunave dhe të sektorit civil shfaqin shkallë të caktuar të mospranimit të (distancës sociale ndaj) bashkësive etnike të ndryshme nga ajo që janë vetë, që flet për nevojën e ndjeshmërisë më të madhe për punë me bashkësitë e tjera.
- ◇ Të gjitha organizatat civile shprehin gatishmëri për të punuar me organizata që kanë përbërje dominuese të ndryshme etnike nga organizata e tyre.

Pjesa III

KONSTATIME DHE REKOMANDIME

KONSTATIME DHE REKOMANDIME

Në këtë pjesë janë dhënë konstatimet dhe rekomandimet e bazuara në rezultatet e hulumtimit, të cilat duhet t'u shërbejnë realizuesve të projektit për *Fuqizimin e bashkëpunimit multi-etnik në komuna gjatë planifikimit të aktiviteteve për implementimin dhe evaluimin e aktiviteteve të projektit.*

Konstatimet janë grupuar në tre fusha, sipas kornizës konceptuale të hulumtimit, ndërsa rekomandimet janë grupuar sipas aktiviteteve të mundshme dhe bartësve të aktiviteteve të projektit.

KONSTATIMET

1. REALIZIMI I PËRMBAJTJEVE PËR ARSIM MULTIETNIK DHE MULTIKULTUROR

◆ Dituritë e nxënësve

- ◆ Nxënësit e klasës IV mesatarisht kanë qenë më të suksesshëm në zgjedhjen e përgjigjeve adekuate, përkatësisht reagimeve ndaj çështjeve të parashtruara. Në pyetjet që kishin të bëjnë drejtpërdrejt me nocione që mësohen në klasën e tretë (për shembull, toleranca, të drejtat e fëmijëve) kishte rezultate të pritura më të larta.
- ◆ Ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore për suksesin e nxënësve të klasës IV si për nga gjuha mësimore, ashtu edhe për nga qyteti në të cilin jetojnë/mësojnë.
- ◆ Shumica e nxënësve e zgjedhin si të drejtë qasjen autoritare në përmirësimin e tolerancës etnike, mbase për shkak se janë të mësuar në këtë mënyrë të zgjidhjes së mospajttimeve ndëretnike në shkollë.
- ◆ Shumica e nxënësve të klasës VIII kanë qenë mesatarisht më të suksesshëm në zgjedhjen e përgjigjeve adekuate, përkatësisht reagimeve që kishin të bëjnë drejtpërdrejt me nocione që mësohen deri në fund të klasës së shtatë dhe atë në disa raste, si: toleranca, të drejtat dhe detyrimet e njeriut, stereotipat etj., andaj kishte rezultate të pritura më të larta.
- ◆ Ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në suksesin e nxënësve të klasës VIII sipas gjuhës mësimore.
- ◆ Në përgjithësi kanë shprehur gatishmëri ndaj idesë për shkolla multietnike dhe aktivitete të përbashkëta ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme.

◆ Realizimi i përmbajtjeve

- ◆ Shumica e nxënësve nuk kujtohen se kanë mësuar ndonjë përmbajtje të caktuar, që vërehet në atë që ata nuk kanë përvetësuar dituri më afatgjate ose nuk i kanë dalluar si përmbajtje që kanë të bëjnë me tema përkatëse. Siç duket, mënyra në të cilën nxënësit janë mësuar dhe aktivitetet në të cilat ata janë përfshirë, kanë ndikimin ndaj gjendjes së këtyllë.
- ◆ Pjesa më e madhe e arsimtarëve konsiderojnë se deri në fund të shkollës fillore do të arrijnë më shumë qëllime që janë pjesë e arsimit multietnik, përkatësisht se nxënësit e tyre do të jenë tolerantë, të përgatitur për të zgjidhur konflikte etnike dhe do të jenë qytetarë lojalë të shtetit. Ato vlerësime në masë të madhe kanë të bëjnë me nxënësit e gjuhës mësimore në të cilën ata mbajnë mësim, ndërsa më pak për nxënësit që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore.

◆ **Gatishmëria e arsimtarëve për arsim multietnik**

- ◆ Qëndrimet e arsimtarëve për pranimin e dallimeve në arsim dhe puna në mjedise multietnike nuk mund të vlerësohen si bazë e mirë për arsimin multietnik.
- ◆ Qëndrimi ndaj pranimin të dallimeve në mjedis heterogjen etnik dhe kulturor, siç është Shkupi, është më pozitiv. Kjo shkon në favor të hipotezës se kontaktet ndikojnë në pranimin e dallimeve etnike dhe kulturore.
- ◆ Arsimtarët nuk kanë qenë shumë të suksesshëm në zgjedhjen e procedurave adekuate në situatat të ndjeshme etnike.
- ◆ Nuk ka dallime të theksuara statistikore në suksesin e arsimtarëve në testin e gatishmërisë metodike, kjo duke e pasur parasysh gjuhën ose qytetin në të cilin punojnë.
- ◆ Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollave të projektit kanë ndjekur trajnime dhe kanë përvojë për zhvillimin bashkëpunimit multietnik dhe ata janë të interesuar që edhe në të ardhmen të punojnë në projekte të tilla.
- ◆ Pjesa më e madhe e arsimtarëve gjatë studimeve nuk janë përgatitur ose janë përgatitur vetëm pjesërisht për punë në mjedise të përziera etnike. Po ashtu shumica e tyre nuk kanë ndjekur trajnime plotësuese e as nuk kanë marrë pjesë në projekte për bashkëpunim ndëretnik.
- ◆ Gjysma e arsimtarëve ndjehen të papërgatitur ose pjesërisht të përgatitur që të realizojnë përmbajtje për bashkëpunim ndëretnik dhe shumica e arsimtarëve vlerësojnë se vetëm pjesërisht janë aftësuar për shfrytëzimin e më shumë metodave që janë adekuate me arsimin multietnik.

◆ **Praktikat dhe mendimet për arsimin multietnik**

- ◆ Në të gjitha shkollat e përfshira në projekt janë planifikuara qëllime dhe/ose aktivitete për arsimin multietnik, por zakonisht ato nuk janë të koordinuara dhe nuk i përfshijnë të gjitha mundësitë për të. Në shkolla ekzistojnë modele të organizimit të mësimin sipas gjuhëve mësimore.
- ◆ Në shkollat e përfshira në projekt takimet formale dhe trajnimet rregullisht zhvillohen bashkërisht (në grupe të përziera etnike), ndërsa shpesh edhe aktivitetet që kanë të bëjnë me aktivitete jashtëmësimore dhe jashtëshkollore (sportive, kulturore, aktivitete artistike dhe ekskursione) janë të përbashkëta. Por, aktivitetet mësimore dhe puna në seksione më shpesh organizohen dhe realizohen sipas gjuhës mësimore.
- ◆ Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë e mbështesin mësimin në ndërrime të përziera etnike, mendimet e arsimtarëve janë të ndara, ndërsa shumica e prindërve e mbështesin mësimin në ndërrime të ndara etnike.

- ◆ Shumica e nxënësve janë të gatshëm për mësim në ndërrim të njëjtë me fëmijë të përkatësisë tjetër etnike (se dëshirojnë të mësojnë me të tjerët ose e kanë njësoj), si dhe për mësimin e gjuhës së bashkësive të tjera etnike.
- ◆ Rreth një e treta e arsimtarëve mendojnë se në masë të madhe mund të kontribuojnë për arsimin multietnik përmes mësimin në lëndën mësimore, si dhe duke qenë kujdestarë klasash, ndërsa më shumë se gjysma e tyre mendojnë se mund të kontribuojnë në masë të konsiderueshme.

2. KOMUNIKIMI DHE INTEGRIMI MULTIETNIK NË SHKOLLA

◆ Mendimi i kuadrit edukativo-arsimor për marrëdhëniet ndëretnike

- ◆ Tensione të dukshme në bazë etnike vërejnë një numër relativisht i vogël i arsimtarëve, ndërsa tensione të fshehta vërejnë rreth gjysma e arsimtarëve.
- ◆ Arsimtarët, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë konsiderojnë se më shumë aktivitete të përbashkëta do të kontribuojnë për pakësimin e tensioneve në baza etnike, por edhe për inkuadrim më të madh të prindërve në aktivitete dhe të nxënësve në planifikimin e tyre.
- ◆ Distanca sociale e kuadrit mësimor ndaj pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike është e madhe. Kur bëhet fjalë për pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike, ata pranojnë të jetojnë në fqinjësi me ta, të punojnë bashkë dhe eventualisht të shoqërohen në kohën e lirë, por jo edhe të jenë miq të mirë, bashkëshortë të anëtarëve të afërt të familjes, bashkëshortë të tyre ose të fëmijëve të tyre.
- ◆ Përveç shkollës, sipas mendimit të një numri të madh të arsimtarëve, drejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, për marrëdhënie të mira ndëretnike mund të kontribuojnë prindërit, familja dhe mediat.

◆ Perceptimi i nxënësve për marrëdhëniet e tyre me fëmijë të bashkësive të tjera etnike

- ◆ Shumica e nxënësve mendojnë se fëmijët e bashkësive të tjera etnike kanë sjellje miqësore ndaj tyre, secili i dhjeti ndjen se ata kanë sjellje armiqësore, ndërsa po aq kanë përjetuar ndonjëherë përqeshje për shkak të fesë dhe/ose nacionalitetit që i përkasin.
- ◆ Kur zgjedhin shokun më të mirë, për shumicën e nxënësve më e rëndësishme është që ai të jetë i mirë me ata, por po ashtu është e madhe përqindja e atyre nxënësve (30% të maqedonasit dhe 40% të shqiptarët) për të cilët më e rëndësishme është që shoku i tyre më i mirë të jetë i fesë ose i nacionalitetit të njëjtë.
- ◆ Shumica e nxënësve janë të gatshëm për të mësuar gjuhën mësimore të bashkësive të tjera etnike dhe ata do ta kishin zgjedhur gjuhën turke.

◆ **Mendimet e prindërve për arsimin multietnik**

- ◆ Shumica e prindërve nuk e dinë se në shkollën e tyre ka pasur ngjarje që kanë pasur për qëllim bashkëpunimin e nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike, e as se ekziston mundësi për mësimin e gjuhës së bashkësisë tjetër etnike.
- ◆ Tensione të dukshme ndërmjet nxënësve në baza etnike vërejnë relativisht pak prindër, ndërsa rreth 20% e prindërve vërejnë tensione të fshehta.
- ◆ Sipas njohurive të prindërve, fëmijët e tyre kanë shokë të bashkësive të tjera etnike në shkollë (72%) dhe jashtë shkollës (58%).
- ◆ Shumica e prindërve do t'i kishin nxitur fëmijët e tyre ta mësojnë gjuhën e ndonjë bashkësie tjetër etnike.
- ◆ Shumica e prindërve kanë shokë të bashkësive të tjera etnike, por në familje nuk kanë shumë martesë të përziera, veçmas maqedonasit.

3. INICIATIVAT E KOMUNAVE QË KANË TË BËJNË ME ARSIMIN MULTIETNIK NË SHKOLLË

- ◆ Sipas përfaqësuesve të sektorit joqeveritar dhe të pushtetit lokal, nxënësit e përkatësive të ndryshme etnike që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore njihen shumë pak mes vete.
- ◆ Organizatat joqeveritare dhe pushteti lokal e shohin veten si faktor të rëndësishëm në përmirësimin e tolerancës ndëretnike.
- ◆ Një pjesë e komunave nuk kanë vendosur bashkëpunim të suksesshëm me organizatat joqeveritare, veçmas në pikëpamje të aktiviteteve që kanë të bëjnë me jetën multietnike dhe multikulturore.
- ◆ Organizatat joqeveritare kanë kapacitete solide për menaxhimin e projekteve.
- ◆ Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesit e pushtetit lokal propozojnë aktivitete për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik ndërmjet nxënësve, por ato kryesisht kanë të bëjnë me aktivitete jashtë shkollës.
- ◆ Një pjesë e madhe e përfaqësuesve të komunave dhe të sektorit civil shfaqin shkallë të caktuar të mospranimit (distanca sociale) ndaj bashkësive etnike të ndryshme nga ajo që janë vetë.
- ◆ Të gjitha organizatat civile shprehin gatishmëri për të punuar me organizata që kanë përbërje dominuese të ndryshme etnike nga organizata e tyre.
- ◆ Për aktivitetet e organizatave joqeveritare, mediave dhe komunave si potenciale për tejkalimin e tensioneve në shkollë janë përcaktuar më pak se 20% e të gjitha kategorive të të anketuarve.

REKOMANDIME

- ◆ **Ndryshime në punën e shkollave në raport me arsimin multietnik dhe multikulturor**
 - ◇ E dhëna se nxënësit janë shumë më të ngarkuar në krahasim me arsimtarët dhe prindërit ndaj nxënësve që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore është një tregues i mirë që duhet të shfrytëzohet.
 - ◇ Përvojat e shkollave në arsimin multietnik dhe angazhimet dhe/ose aktivitetet e planifikuara për arsim multietnik duhet të shfrytëzohen gjatë planifikimit të aktiviteteve, veçmas në drejtim të qasjes më konsistente drejt arsimit multietnik dhe multikulturor.
 - ◇ Nëpër shkolla ekzistojnë modele të ndryshme të organizimit të mësimit sipas gjuhëve mësimore. Kjo është një bazë e mirë për pilotimin e qasjeve të ndryshme për arsimin multietnik.
 - ◇ Prindërit duhet të jenë të informuar më mirë dhe të inkuadruar me shumë në aktivitete për përparimin e komunikimit dhe mirëkuptimit ndëretnik.
 - ◇ Ndryshime duhet të bëhen edhe në punën e bashkësisë së klasës dhe në gjithë klimën shkollore, kjo në aspekt të promovimit të qasjes demokratike, e jo autokratike, në kuptimin dhe raportin ndaj kulturave dhe etnive të tjera.
 - ◇ Të shfrytëzohet interesi i sektorit joqeveritar dhe i pushtetit lokal për bashkëpunim, mbështetje dhe inkuadrim në aktivitete, të cilat do t'i planifikonin dhe realizonin shkollat.

- ◆ **Organizimi dhe realizimi i mësimit**
 - ◇ Duhet të bëhen ndryshime në mësimin e lëndëve në të cilat mësohen përmbajtje që kanë të bëjnë me dituritë dhe qëndrimet ndaj bashkësive të ndryshme etnike, ndaj përkatësisë fetare dhe kulturore (për shembull: toleranca, e drejta e fëmijëve). Gjatë planifikimit dhe realizimit të trajnimeve, që kanë të bëjnë me aktivitetet që duhet të zbatohen me nxënës, duhet të ketë pjesë që do të jenë specifike për gjuhë të ndryshme mësimore, si dhe për kultura të ndryshme, përkatësisht për qytetet/shkollat e ndryshme.
 - ◇ Nevojitet të bëhet ndryshimi i mënyrës së realizimit të përmbajtjeve, inkuadrimit të nxënësve në aktivitetet në orë (debate, diskutime, mini-projekte), të cilat do të ndihmojnë në përvetësimin e diturive më afatgjata të nocioneve dhe koncepteve të mësuara, si dhe njohje dhe zbatim të tyre.
 - ◇ Të fuqizohet inkuadrimi i nxënësve në më shumë aktivitete “multientike/aktivitete të realizuara nga ekipet multietnike – me mundësi që vetë nxënësit të vendosim për atë se cilin aktivitet ose projekti do ta realizojnë (mund të fillohet me aktivitete/projekte shkencore, sportive, hulumtuese etj.).

- ◇ Përveç aktiviteteve jashtëmësimore, më shumë duhet të shfrytëzohen potencialet e aktiviteteve mësimore, duke përfshirë edhe mësimin e gjuhëve të bashkësive të tjera etnike nga nxënësit dhe arsimtarët.

◆ **Trajnimet për arsimtarë**

- ◇ Duke e pasur parasysh se arsimtarët gjatë studimeve nuk janë përgatitur për të realizuar arsim multietnik dhe multikulturor dhe shumica e tyre nuk kanë ndjekur trajnime plotësuese gjatë punës dhe nuk ndjehen as në aspekt përmbajtjesor e as metodik të gatshëm, duhet të zhvillohet program adekuat i cili:
 - do të ketë pjesë të përgjithshme dhe specifike, në krijimin e së cilës do të merren parasysh edhe përgjigjet e arsimtarëve për gatishmërinë e tyre metodike;
 - do t'u referohet si përmbajtjeve, ashtu edhe metodave të punës;
 - do të nisët nga nevojat dhe gjendjet specifike në shkollë, në komunë dhe nga potencialet e sektorit joqeveritar.
- ◇ Në trajnime do të ishte e dobishme të diskutohen situatat reale dhe mënyrat përkatëse të reagimit të arsimtarëve në situata të ndjeshme etnike.
- ◇ Duke u nisur nga dallimet e theksuara statistikore në të arriturat e nxënësve, do të duhet që gjatë planifikimit dhe realizimit të trajnimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet që duhet të realizohen me nxënës, të ketë pjesë që do të jenë specifike për gjuhët e ndryshme mësimore.

◆ **Mbështetja në nivel lokal që ka të bëjë me arsimin multietnik**

- ◇ Do të duhet të shfrytëzohet vetëdija e sektorit të OJQ-ve dhe e pushtetit lokal si një faktor i rëndësishëm në përmirësimin e tolerancës ndëretnike, në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve në projekt.
- ◇ Duhet të fuqizohet pjesëmarrja e organizatave joqeveritare e mediave dhe komunave si faktorë potencialë për tejkalimin e tensioneve në shkollë (edhe pse për këtë janë përcaktuar më pak se 20% e të gjitha kategorive të të anketuarve), kjo përmes inkuadrimin të tyre direkt në aktivitetet dhe mbështetjen e shkollave, në mbështetjen e rrjetëzimit të shkollave, në shpalljen dhe theksimin e praktikave të mira etj.
- ◇ Duhet të ndihmohet në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe organizatave joqeveritare, veçmas të aktiviteteve në shkollat që kanë të bëjnë me çështje multietnike dhe multikulturore.
- ◇ Duhet të shfrytëzohet potencialet dhe kapacitetet e sektorit joqeveritar për menaxhimin e projekteve, veçmas përvoja në projekte me qëllime dhe të pritura të ngjashme si projekti *Fuqizimi i bashkëpunimit multietnik në komunë*. Informacionet e tyre për “gjendjen në terren” do të mund të

sigurojnë planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve që janë të orientuara drejt gjendjeve dhe nevojave specifike të shkollave.

- ◆ Pushteti lokal duhet ta shfrytëzojë në masë të madhe të drejtën e veprimit në shkolla (miratimi i raporteve vjetore për punë, planifikimet vjetore, pjesëmarrja në projekte, pjesëmarrja në punën e këshillave të shkollave etj.), para së gjithash në lidhje me aktivitetet që do ta përmirësonin dhe fuqizonin bashkëpunimin multi-etnik dhe multikulturor në dhe ndërmjet shkollave në komunë.

Të gjitha organizatat civile shfaqin gatishmëri të punojnë me organizatat që kanë përbërje dominuese të ndryshme etnike nga organizata e tyre. Kjo i mundëson implementuesit të projektit që përmes aktiviteteve specifike të orientuara kah të punësuarit në pushtetin lokal dhe organizatat joqeveritare të ndikojë në ndjeshmërinë e madhe për punë/bashkëpunim me të tjerët/bashkësitë e ndryshme në komunë.

LITERATURA

1. Петроска-Бешка В., Најчевска М., Кениг Н., Балажи С., Томовска А., *Мултикултурализмот и меѓуеџничкиџе односи во образованиеџо*, УНИЦЕФ, Скопје 2009.
2. Кржаловски А., *Дискриминацијата во Македонија џо основа на еџничка џриџагносиџ*, Македонски центар за меѓународна соработка, Скопје 2011.
3. Клековски С., *Меѓуеџничкиџе односи во Македонија*, Македонски центар за меѓународна соработка, Скопје 2011.
4. Биро за развој на образованието, Министерство за образование и наука (2007), Концепција за деветгодишно основно воспитание и образование
5. Министерство за образование и наука (2008), Чекори кон интегрирано образование во образовниот систем на Република Македонија http://edulaws.mk/images/pdf/strategy_ie_mac_final_13oct01.pdf.
6. OSCE. (2010), Возраст, Контакт, Перцепции, <http://www.osce.org/mk/skopje/41442?download=true>
7. Anger J., Van't Rood R. A., Gestakovska Z., (2010), Learning Study on the Achievements and Experiences of Projects on Inter-Ethnic Education and Youth Work in Macedonia <http://www.sida.se/Documents/Import/pdf/Learning-Study-on-the-Achievements-and-Experiences-of-Projects-on-Inter-Ethnic-Education-and-Youth-Work-in-Macedonia.pdf>.
8. Braddock II, J. H., (1980), "The Perpetuation of Segregation across Levels of Education: A Behavioral Assessment of the Contact-Hypothesis", *Sociology of Education*, 53 (July): pp.178-186.
9. Brown L. D., (2009), Preservice Teachers' Attitudes toward their Preparedness to Teach Culturally Diverse Student Populations, Submitted in partial fulfillment of the requirements for the degree of Doctor of Education, http://acumen.lib.ua.edu/content/u0015/0000001/0000150/u0015_0000001_0000150.pdf.
10. Dixon J., Durrheim K., Tredoux C., Tropp L., Clack B., Eaton L. (2010), A paradox of Integration? Interracial contact, Prejudice Reduction and Perception of Racial discrimination, *Journal of social Issues*, Vol. 66 pp. 401-416, <http://www.mendeley.com/research/paradox-integration-interracial-contact-prejudice-reduction-perceptions-racial-discrimination/#page-1>
11. Golubeva M., Powell S., Kazimzade E., Nedelcu A. (2009), Divided Education, Divided Citizens?, http://www.providus.lv/upload_file/Projekti/lzgl_proj/DEDC%20International%20Report.pdf.

12. Gorski P., (1999), A Brief History of Multicultural Education, Hamline University, http://www.edchange.org/multicultural/papers/edchange_history.html.
13. Henze R., Katz A., Norte E., Sather S., Walker E., (1999), Leading for Diversity: A Study of How School Leaders Achieve Racial and Ethnic Harmony, executive summary December 20, 1999, <http://www.arcassociates.org/files/L4DExecSumm.PDF>.
14. Jackman M. R., Crane M., (1986), "Some of my best friends are black...": Interracial Friendship and Whites' Racial Attitudes, *Public Opinion Quarterly*, vol. 50, pp. 459-486.
15. King-Calnek J. E., (2006), Education for Citizenship: Interethnic Pedagogy and Formal Education at Escola Criativa Olodum, *The Urban Review*, Vol. 38, No. 2, June 2006
<http://www.educadem.oas.org/administrador/investigaciones/docs/artigo%20education%20and%20citizenship%20-%20Brazil.pdf>.
16. Maleska M., (2010), Interethnic relations in Macedonia: People Centred Analyses, *New Balkan Politics*, 12, 2010, <http://www.newbalkanpolitics.org.mk/documents/pdf/NBP,Maleska%20M.pdf>
17. Morote E. S., Tatum S. L., A Reliable Survey to Measure Teachers Multicultural Awareness to their School Environment, http://wtfaculty.wtamu.edu/webres/File/Journals/MCJ/Volume5-1/morote_tatum_20100628.pdf.
18. Nijboer Y. L. (2011), The Ethnic Identity and Inter-Ethnic Relations of Primary and Secondary School Students in the Former Yugoslav Republic of Macedonia, <http://igitur-archive.library.uu.nl/student-theses/2011-0718-200656/Masterthesis%20Nijboer,%20YL-3188469.pdf>.
19. Padilla A. (2004), Quantitative Methods in Multicultural Education Banks A (ed) *Handbook of research in Multicultural Education*, (sec ed.) pp. 127-145
20. Pei Jian Zhou(2002), Students' Attitudes, Knowledge, and Commitment to Implementation of Multicultural Education in a Teacher Education Program, Dissertation Submitted to the College of Human Resources and Education at West Virginia University in Partial Fulfillment of Requirements for the Degree of Doctor of Education In Curriculum and Instruction, West Virginia University, Department of Educational Theory and Practice, Morgantown, West Virginia
21. Pfeifer J., Spears Brown C., Juvonen J., (2007), Prejudice Reduction in Schools - Teaching Tolerance in Schools: Lessons Learned Since Brown v. Board of Education, *Giving Child and Youth Development Knowledge Away*, Volume XXI, Number II 2007, http://www.srcd.org/index.php?option=com_docman&task=doc_download&gid=82.
22. Polat S, The Attitudes of School Directors to the Multicultural Education in Turkey. *Mediterranean Journal of Social Sciences* Vol. 2, No. 2, May 2011, http://www.mcser.org/images/stories/2_journal/mjssmay2011/36.pdf.

23. Powers D.l A., Ellison C. G., (1995), Interracial Contact and Black Racial Attitudes: The Contact Hypothesis and Selectivity Bias, *Social Forces* (1995), Volume: 74, Issue: 1, pp. 205-226.
24. UNDP (2010), Results of a Participatory Assessment National and Local Capacities for Strengthening Inter-Ethnic Dialogue and Collaboration *UN Programme to Enhance Inter - Ethnic Dialogue and Collaboration, Prepared by UNDP as part of the UN Programme to Enhance Inter-Ethnic Dialogue and Collaboration*, http://undp.org.mk/content/Publications/UNDP_Participatory_Report_Full_English.pdf
25. United Nation Alliance of Civilizations (2011), National Strategy of she Republic of Macedonia for the Alliance of Civilizations, <http://www.unaoc.org/wp-content/uploads/Republic-of-Macedonia-National-Strategy1.pdf>.
26. Zhou P. J, (2002), Students' Attitudes, Knowledge, and Commitment to Implementation of Multicultural Education in a Teacher Education Program, Dissertation Submitted to the College of Human Resources and Education at West Virginia University.

SHTOJCA:

TË DHËNA PËR ARSIMIN E PRINDËRVE/TUTORËVE TË NXËNËSVE TË KLASËS SË KATËRT DHE TË TETË PËR KOMUNA DHE PËR GJUHË MËSIMORE

1. ARSIMI I NËNAVE TË NXËNËSVE

Në gjuhën mësimore maqedonase						
Arsimi	Shkup (Butel)		Tetovë		Strumicë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkollë të pambaruar fillore	7	1.9	1	0.7	277	27.5
Shkollë fillore	22	5.8	8	5.4	370	36.8
Shkollë të mesme	274	72.6	99	66.9	341	33.9
Shkollë të lartë dhe arsim sipëror	74	19.7	40	27	18	1.8
Gjithsej	377	100	148	100	1006	100

Në gjuhën mësimore shqipe						
Arsimi	Shkup (Butel)		Tetovë		Strumicë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkollë të pambaruar fillore	18	2.6	3	1	0	0
Shkollë fillore	412	59.7	250	83.3	0	0
Shkollë të mesme	176	25.5	34	11.3	0	0
Shkollë të lartë dhe arsim sipëror	84	12.2	13	4.4	0	0
Gjithsej	690	100	300	100	0	100

Në gjuhën mësimore turke						
Arsimi	Shkup (Butel)		Tetovë		Strumicë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkollë të pambaruar fillore	0	0	0	0	337	89.4
Shkollë fillore	18	58.1	4	100	40	10.6
Shkollë të mesme	11	35.5	0	0	0	0
Shkollë të lartë dhe arsim sipëror	2	6.4	0	0	0	0
Gjithsej	31	100	4	100	377	100

2. ARSIMI I BABALLARËVE TË NXËNËSVE

Në gjuhën mësimore maqedonase						
Arsimi	Shkup (Butel)		Tetovë		Strumicë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkollë të pambaruar fillore	1	0.3	0	0	239	23.6
Shkollë fillore	10	2.6	8	5.4	426	42
Shkollë të mesme	294	76.1	111	75	333	32.8
Shkollë të lartë dhe arsim sipëror	81	21	29	19.6	16	1.6
Gjithsej	386	100	148	100	1014	100

Në gjuhën mësimore shqipe						
Arsimi	Shkup (Butel)		Tetovë		Strumicë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkollë të pambaruar fillore	1	0.1	3	1.1	0	0
Shkollë fillore	289	38	178	59.7	0	0
Shkollë të mesme	331	43.6	91	30.5	0	0
Shkollë të lartë dhe arsim sipëror	139	18.3	26	8.7	0	0
Gjithsej	760	100	298	100	0	100

Në gjuhën mësimore turke						
Arsimi	Shkup (Butel)		Tetovë		Strumicë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkollë të pambaruar fillore	0	0	0	0	301	79.4
Shkollë fillore	5	16.1	2	50	71	18.7
Shkollë të mesme	25	80.7	1	25	7	1.9
Shkollë të lartë dhe arsim sipëror	1	3.2	1	25	0	0
Gjithsej	31	100	4	100	379	100

